

TË BËHEMI MË TË MIRË



"Çdo njeri gabon, por më i miri prej atyre që gabojnë është ai që pendohet". Kjo thënie e të Dërguarit, paqja dhe lavdërimi qoftë për të, mes tjerash, na mëson dy gjëra të mëdha, të cilat duhet të theksohen edhe më shumë në këto ditë të bekuara të Ramazanit.

E para, është fakti se çdo krijesë që përkufizohet si njeri mund të gabojë, pavarësisht ka dije apo jo, ka pushtet apo jo, ka pasuri apo jo dhe gjithçka tjetër. Askujt nuk i lejohet të merr guximin dhe të thur për veten e tij lëvdatat më të bukura. Nëse duam të bëjmë një të mirë për veten, atëherë le të bëjmë atë që na udhëzoi pjesa e dytë e hadithit, pra, le të pendohemi për ato gabime që kemi bërë.

Nëse je duke bërë ndonjë mëkat të madh, nxito e përulu para Allahut, nënshtroju Atij, thuaji hallin tënd, qaj për mëkatën e bërë dhe kërko falje nga Ai që faljen e do, nga Ai që mëshira e Tij ka tejkaluar zemërimin e Tij. Pastaj, të siguroj se do të ndjesh një flladitje të shpirtit dhe kënaqësi të zemrës. Po si jo, nuk ka lumturi më të madhe sesa të kesh raporte aq të afërta dhe të sinqerta me Allahun, Krijuesin e gjithësisë, i cili ka në dorë lumturinë dhe dëshpërimin dhe ka në dorë xhenetin dhe Zjarrin.

Në faqet e mëpastajme do të keni mundësi të lexoni për shumë gjëra dhe mënyra të përfitimit gjatë Ramazanit, do të lexoni sesi mund të arrijmë një gradë më të lartë të devotshmërisë dhe si të mbetemi të atillë.

Që tani, merre lapsin dhe shkruaj për veten tënde. Jo biografi, as CV për të konkurruar diku, por shkruaj për gjërat negative që i sheh ti ose të tjerët i kanë thënë për ty. Shkruaj: 1. Nuk e fali namazin e sabahut në xhami, 2. Gjuha ime është e pamatur, 3. Kam zili për të mirat e të tjerëve, 4. Nuk di të lexoj Kuranin, 5. Nuk besoj bindshëm se Allahu ma do të mirën, 6. Kam supozime të këqija për miqtë e mi, 7. Nuk e respektoj nënën...

Pasi t'i shënosh këto, hedhja një sy dhe shikoji a korrespondojnë me ty këto gjëra ose jo?! Nëse po, atëherë zgjedh ca prej tyre dhe harto një strategji sesi në këtë muaj do të japësh tërë mundin tënd për tu liruar nga ato mëkate ose vese. Tani ke shansin më të përshtatshëm, tani kur të gjithë flasin për të mira, të gjithë mundohen sadopak të largohen nga të këqijat, kur shumica e njerëzve u janë drejtuar xhamive dhe ligjëratave, kur shejtanët prangosen dhe besimi yt ka një vendosmëri të paparë për të respektuar Allahun. Fillimisht lexo sa të shëmtuara janë ato mëkate dhe vese, çfarë ka thënë Allahu i Madhërishëm, Muhamedi paqja dhe lavdërimi qoftë për të, dijetarët, njerëzit e mençur etj. Medito sa herë je nënçmuar, sa shanse të kanë ikur, sa miq ke humbur për shkak të ndonjë vesi të keq.

Nëse i bën këto, atëherë do të ngjallet një urrejtje ndaj këtyre gjërave dhe do të fillosh të paramendosh sesa i bukur dhe sa besimtar i mirë do të ishe pa ato mëkate dhe vese. Kërko që Allahu të të ndihmojë dhe mos u dëshpëro, sepse ai që është nën kujdesin e Tij, nuk ka nevojë për përkujdesje tjetër dhe ai që fiton përkrahjen e Allahut është fitimtar gjithsesi.

Nëse ia arrijmë kësaj, atëherë ne jemi bërë mbretër të vetvetes dhe kemi fituar pushtetin. Ky është një përfitim, madje përparim shumë i madh, krahas begative dhe shpërblimeve që Allahu i ka përgatitur për agjëruesit.

Na fal, o Allahu ynë dhe na përmirëso gjendjen tonë!

Amin

**Në emër të redaksisë:
Omer BERISHA**

AKTUALETerrorizmi në shifra **3-6**Lufta në BFI? **7-9**Iraku dhe ardhmëria e luftës mediatike **9-11****KËNDI IM**Ramazani, kjo kohë e bekuar **12-15**Prishja e të rinjve dhe problemet e tyre **15-16**Ku janë burrat shqiptarë! **17-18****AKIDE**Ramazani, një muaj i volitshëm për të
ripërtërirë imanin **19-23****FIKH**Gjëra që duhet t'i dish për agjërimin **24-27****SPECIALE**Intervistë me dietarin e mirënjohur
botërisht, shqiptarin shejh Shuajb Arnauti:
“Historia i njohu shqiptarët vetëm
pasi përqaftuan islamin” **28-31****FAMILJA**Zonja e kuzhinës në ramazan **32-35**Agjërimi i fëmijëve midis provës dhe
vazhdimësisë **36-39****TEFSIR**Vlera e namazit të natës **40-42****HADITH**PROFETI, salallahu alejhi ue selem,
DHE RAMAZANI **43-46****LIBRI**“Rrugët e njerëzve të devotshëm” **46-47****BOTA ISLAME**Arabia Saudite **48-50**Shtojcë ekskluzive për Ramazan: Përjetimi i
momentit të iftarit në Medinë **51-52****FETVA DHE KONSULTIME**“Rreth çështjeve mjekësore
të ramazanit” **53-56****HISTORI**Në ramazan ngjau... **57-60****REDAKSIA**

Omer BERISHA – kryeredaktor

Anëtarë të redaksisë:

Ahmed KALAJA, Bekir HALIMI, Agim BEKIRI, Driton LEKAJ, Ali SHABANI, Ismail BARDHOSHI,
Talha KURTISHI, Bledar HAXHIU, Sedat SHABANI, Agron TERZIQI, Lulzim SUSURI, Genc PLUMBI, Zeki ÇERKEZI,
Enver AZIZI, Bashkim BAJRAMI, Bilal TEQJA.

Bashkëpunëtorë: Ekrem AVDIU dhe ENIS RAMA

Roald HYSA – redaktor gjuhësor

Halil BERISHA – redaktor teknik

Dorlir KRAJA (ENSARTDESIGN Studio) - ballina

Sedat RAMADANI - shpërndarje dhe marketing

Boton: Albislam

Adresa: rr: 110 nr: 5 | Çarshia e vjetër | Shkup 1000

email: revista@albislam.com

sms: +389 75 436 718 | fax&tel: +389 2 3230 827

Revista është e regjistruar pranë Agjencisë për

Informata të Maqedonisë nr. 02-124/2

ISSN: 1409-6250

Tirazhi: 2000

ABONIMI NJË VJEÇAR

Për Maqedoni: 600 den, Jashtë vendit: 20 euro
(në çmim janë të përfshira edhe harxhimet postare)e-mail: albislam.abonues@gmail.com

ALBISLAM DOOEL

Xhirollogaria: 300000002770453

Komercijalna Banka A. D. – Skopje

Numri tatimor: 4030008038784

Abonimet me euro mund t'i bëni online nëpërmjet shërbimit
PAYPAL. Të dhënat mund t'i gjeni në www.albislam.com

TERRORIZMI NË SHIFRA



Për momentin terrorizmi ka marrë ngjyrë, ose është bërë me mbiemër, ose mund të themi se i është gjetur sinonimi; ai është Islamik, ai është arab

ABDUSSELAM BELAXHI

Dikur poeti thoshte:

*Shpata më e mprehte në lajm se shkrimet
Dallon mes shakasë dhe seriozitetit.*

Mirëpo sot më mirë mund të themi;

*Statistikat më të mprehta në lajm se
shkrimet*

*Dallojnë mes të singertit dhe
mashtruesit.*

Për kohën që jetojmë statistikën zënë tashmë një vend të padiskutueshëm në argumentimin e vërtetësisë të pretendimeve të ndryshme. Madje nëse them të shenjtë s'e teproj, si dhe mosparaqitja e tyre përbën një hije dyshimi te çdo individ, megjithatë nuk është kjo tema për të cilën dua të diskutoj.

Për momentin terrorizmi ka marrë ngjyrë, ose është bërë me mbiemër, ose mund të themi se i është gjetur sinonimi; ai është Islamik, ai është arab, ai është nga Lindja e Mesme. Çdo ngjarje terroriste në të katër anët e botës paraqitet, ngjyrosset nga mediet dhe politika, si e tillë, derisa të vërtetohet e kundërta. Ndërkohë që ajo vërtetohet tashmë është ngulitur në mendjet e njerëzve dhe është tepër e vështirë të fshihet ajo që është ngulitur dhe e gjithë kjo paraqitet sikur të ekzistonte dëshira e mirë e medias për të përgënjeshtuar atë që e kishte ngulitur më parë në mendjet e njerëzve. A thua vallë të ekzistojë një dëshirë e tillë?

“8% e burimeve njerëzore xhihadiste vijnë nga shkollat fetare, ndërkohë që 78% e tyre i janë bashkangjitur xhihadit nëpërmjet

rrjetit xhihadist në vendet evropiane apo perëndimore, për shkak të presioneve të ndryshme psikike, sociale, ekonomike, shoqërore, raciale, mediatike nën të cilat ndodhen vazhdimisht”.

Islami nuk nxit terrorizmin.

Dr. Nicole ARCO, hulumtuese amerikane pranë Institutit për Teknologji dhe Zhvillim të Masaçusets (Massachusetts Institute of Technology), njëkohësisht mban gradën shkencore të doktorit në shkencat politike, ajo pasi jetoi për dy vjet në Izrael dhe në Daffa el Garbijeh (Territori Perëndimor Palestinez) dhe në Gaza paraqiti një studim shkencor me titull: “Human bombs: Rethinking religion and terrorism”, “Bombat njerëzore: Një rishikim mbi fenë dhe terrorizmin”. Ajo në studimin e saj paraqet disa rezultate me gjuhën e shifrave, si p.sh., që “Pakistani sot numëron më shumë se 10,000 shkolla fetare, mirëpo prej tyre kanë bërë akte vetëfljimi vetëm dy raste, njëri në Afganistan dhe tjetri në Irak”.

Sigurisht kjo bie ndesh me atë që propagandohet sot në mediet, ku çdo mysliman shihet si një vetëfljues i mundshëm.

Kështu kemi rastin e **Oriana Falacit**, e cila në një nga librat e saj “Fuqia e logjikës” shprehet: “Arabët, myslimanët në rastin më të mirë janë ekstremistë dhe në rastin më të keq një grumbull njerëzish si Osama b. Laden. Për këtë arsye duhet t’iu shpallet luftë në tërësi pa bërë dallim nga njëri apo tjetri, sepse ata të gjithë janë ekstremistë, vrasës, të prapambetur dhe analfabetë”.

Apo si rasti i shkrimtarit francez me origjinë libaneze **Antuan Sager** në librin e tij “Networks of Islam” “Rrjetet e Islamit” shprehet: “Muslimani është islamik në natyrën e tij e çdo islamik do të përfundojë në terrorist doemos”.

Studimi, të cilit iu referuam pak më lart

“...Nuk ka asnjë lidhje ndërmjet shkollave të fesë dhe sulmeve vetëfljuese, pa trajtuar këtu ligjshmërinë e tyre fetare...”

nxjerr në pah në bazë të një testimi në terren se në 172 raste të burimeve xhihadiste vërtetoi se vetëm 8% e tyre vijnë nga shkollat fetare, ndërkohë që 78% e tyre i janë bashkangjitur xhihadit nëpërmjet rrjetit xhihadist në vendet evropiane apo perëndimore, për shkak të presioneve të ndryshme psikike, sociale, ekonomike, shoqërore, raciale, mediatike nën të cilat ndodhen vazhdimisht individët”.

Siç konstaton ajo në përmbledhjen e studimit të saj, se “Islami nuk e nxit terrorizmin, por i vishet atij dhe se në shumë raste disa njerëz e legjitimojnë atë me ngjyrimet fetare”. Ajo herë pas here thekson faktin se shkaktari kryesor i terrorizmit është ndjesia e poshtërimit, nënçmimit dhe kurrën e kurrës Islami.

Legjimiteti i një akti dhune nuk ka nevojë patjetër për tekst, mund të përdoren terma fetare dhe terma revolucionare, religjioze ose jo-religjioze, siç ka ndodhur në të kaluarën, apo siç ndodh në shumë lëvizje majtiste apo djathtiste në të katër anët e botës. Përfundimisht nuk mund të thuhet: “Se çdolloj inspirimi në të shprehur apo keqinterpretimi i teksteve i bën me faj”.

Shkaqet e terrorizmit janë nga më të ndryshmet dhe pavarësisht nga inspirimi, apo indoktrinimi, i cili mund të jetë ideologjik, intelektual, ndoshta edhe nën pretekstin e rezistencës ndaj pushtuesit. Gjithashtu edhe dhuna mund të jetë e

shumëllojshme, pavarësisht se ajo në përgjithësi është lokale. Inspirimi i ka bazat, për këdo që e lexon historinë, në nxitjen, grumbullimin dhe bindjet e njerëzve në një ideologji, mendim apo nacionalizëm. Kështu ka ndodhur me lëvizjet revolucionare, të cilat inspirohen nga besimet e njerëzve dhe ndërmarrin pastaj përgjegjësinë e zgjidhjes së problemeve të tyre dhe jo e kundërta.

Al Kaeda për shembull nuk është se ka ndikuar te muslimanët, siç pretendojnë shumë intelektualë perëndimorë, apo ligjvënës, porse kjo organizatë ka trajtuar çështjet që i prekin muslimanët dita-ditës pavarësisht nga zgjidhja e duhur apo e gabuar.

Me të drejtë shumë studiues të fenomenit “dhunë” dalin në përfundimin se: aktet e dhunës mbi “kundërshtarin”, të cilat kryhen mbi referencat dhe udhëheqjet fetare nuk janë thjesht për shkak të ideologjisë që ata mbartin apo praktikojnë, se sa më tepër për qëndrimet e tyre politike apo publike.

“Fushata aktuale kundër “terrorizmit” është në fakt një fushatë ideologjike, ideore e posaçme dhe tepër e suksesshme deri tashti me bazë armikun e saj numër një, Islamin dhe muslimanët, dhe disa organizime ideologjike dhe sociale.

Sulm ideologjik dhe ideor i posaçëm

Aktet e dhunës dhe të terrorizmit nuk kanë ngjyrë fetare, racore apo ideologjike të përcaktuar, përkundrazi mund të jenë ato që i luftojnë më shumë të akuzuarit, siç e ka dëshmuar dhe vërtetuar koha. Për më tepër mund të shihni hulumtimin shkencor të **Muhamed b. Abdullah Selumiut** në librin e tij: “Charitable sector and actions of terrorism” “Lëmi i bamirësisë dhe veprimet terroriste”, i cili flet gjithashtu me gjuhën e shifrave- ku ai vërteton se pas shumë akteve terroriste në botë ka qenë vetë organizmi më i madh i shërbimeve sekrete amerikane CIA, që i ka ndërmarrë vetë, apo i ka përgatitur duke i

stërvitur, apo duke i ndihmuar financiarisht direkt apo indirekt, apo duke i ndihmuar ideologjikisht direkt apo indirekt, sidomos dhe veçanërisht në botën arabe. Si në rastet e mëposhtme:

-Në një atentat me makinë të mbushur me eksplozivë në Bejrutin perëndimor i ndërmarrë nga Forcat Speciale në mars të 1985, ku mbetën të vdekur 92 persona dhe u plagosën 200 të tjerë.

- Një atentat tjetër në Siri në vitin 1986, si pasojë e të cilit mbetën të vrarë 150 civilë.

- CIA qëndron pas skandalit të organizatës “**Contras**” në Nikaragua, duke mos përmendur këtu një numër tepër të konsiderueshëm grushtesh ushtarake, akte të ndryshme dhune në vende të ndryshme të botës, veçanërisht në Amerikën Latine, Afrikë dhe Azi.

Një numër i konsiderueshëm hulumtuesish aktualë e konsiderojnë sulmin aktual kundër “terrorizmit”, një sulm më shumë ideologjik, psikologjik posaçërisht të shkëlqyeshëm dhe tepër të suksesshëm për të justifikuar qëllimet e tyre, ku armiku numër një renditet Islami dhe muslimanët, si dhe shumë prej institucioneve ideologjike apo sociale islame.

Studiuesi dhe hulumtuesi amerikan **Uilliam Fisher** në librin e tij “In the war on terrorism ahead of each roll”, “Në luftën kundër terrorizmit të të gjitha emërtimeve” thekson se qëllimi pas fenomenit të islamofobisë që tashmë ka pushtuar Shtetet e Bashkuara qysh prej 11 shtatorit ka si qëllim kryesor frikësimin e muslimanëve amerikanë dhe shtyrjen e tyre për të bojkotuar një prej shtyllave më të rëndësishme të Islamit, që është dhënia e zekatit të varfërve”.

“Arrestimet e çrregullta, raciale, diskriminuese përfshijnë me mijëra burra dhe gra të pafajshëm, jo pse ishin të dyshimtë, po ngaqë ngjasonin në pamje me njerëzit e Lindjes së Mesme, e si pasojë pati

burgosjen e tyre pa asnjë akuzë të ngritur kundër tyre për krime terroriste dhe pa iu dhënë mundësinë e mbrojtjes me ligj”.

Për t'i pasqyruar më mirë përfundimet e nxjerra nga Uilliam Fisher, unë do t'ju flas me gjuhën e shifrave, duke u argumentuar me statistikën e dhëna nga Middle East e 23 Nëntorit 2002, ku thuhet se ambasadori amerikan në Egjipt i kërkoi Qeverisë së atjeshme të mbyllën njëzet e pesë shoqata e organizma fetare me pretekstin e lidhjeve të tyre me organizatën e Al Kaedës! Me të vërtetë kjo ndikoi padyshim dukshëm në fushatën ndaj embargos së prodhimeve amerikane në këtë vend.

Terrorizmi islamik apo perëndimor?

Pikësnyimi i masmedias perëndimore është fryrja dhe vënia nën shënjestër e të ashtuquajturit **Terrorizëm Islamik**, mirëpo për fatin e tyre të keq shifrat tregojnë të kundërtën, duke iu referuar sigurisht forumeve më me zë dhe më prestigjiozë, të cilët vërtetojnë se ky fenomen është i qëllimshëm, aq sa dhe i pavërtetë. Në mars të vitit 2007 në raportin e **European Police Organization** mbi paraqitjen shifrave të dhunës dhe terrorit në BE, ne vërejmë se në vitin 2006 janë realizuar gjithsej 498 sulme terroriste në shtetet e BE, ku 424 prej tyre janë bërë nga organizata rebele separatiste, 55 majtiste, 18 terroriste të ndryshme dhe një prej këtyre është realizuar nga një musliman në Gjermani.

Ndërkohe që numri i të arrestuarve muslimanë me akuza terrorizmi ka qenë 257 prej 706 të arrestuarve në total për këto akte, që do të thotë 36,4%, ndërkohë që prej rebelëve separatistë u arrestuan vetëm 226, që do të thotë vetëm 32%, megjithëse aktet e tyre arrinin siç u përmend më lart 85,1% të totalit. Ky raport mbyllet me deklaratën se: “Përballja me terrorizmin islamik përbën prioritet” për vendet e BE-së.”

Gjuha ose e vërteta e shifrave nuk e konsideron terrorizmin islamik si një kërcënim serioz për Evropën, megjithatë gjuha e medias dhe e politikës nuk po tregon fare ndonjë ndryshim. Kjo gjë padyshim që po hedh një hije dyshimi mbi objektivitetin dhe racionalizmin që mbahet me të madh Bashkimi Evropian, apo laicitetin, gjëra me të cilat mburren. Ndërsa në lidhje me pikësnyimin e “terrorizmit” mbi bazat amerikane në zonën e Lindjes së Mesme, d.m.th., tek arabët dhe muslimanët gjuha e shifrave gjithashtu e ka hedhur poshtë këtë lloj pretendimi.

Statistikat e Ministrisë së Jashtme Amerikane në raportin e saj për terrorizmin ndërmjet viteve 1997 - 2002 i ka cilësuar 77 sulme si terroriste kundër bazave amerikane, 46 prej tyre në Amerikën Latine dhe 16 në Lindjen e Mesme dhe se nga 355 sulme në vitin 2001, që është konsideruar dhe si viti i terrorit pa kufi, vetëm 29 prej tyre janë në Lindjen e Mesme dhe 201 prej tyre në Amerikën Latine. Megjithatë s'kemi dëgjuar për terrorizëm latin apo katolik, po vetëm për terrorizëm arab, ose i Lindjes së Mesme, ose islamik.

Shkaqet që çojnë në terrorizëm

Gjuha e shifrave që paraqitëm më sipër, pavarësisht se nga burime të ndryshme dhe të padiskutueshme për ata që na i kanë servirur, mendoj se dilet me këto përfundime:

Terrori dhe dhuna mund të ketë shkaqe nga më të ndryshmet, mirëpo ideologjitë dhe fetë në përgjithësi nuk janë shkak i vërtetë apo i drejtpërdrejtë, edhe nëse mund të përdoren si lëndë për inspirimin e tyre, apo si referencë, apo duke marrë përsipër zgjidhjen e çështjeve të mëdha në emër të tyre.

Nuk ka asnjë lidhje ndërmjet shkollave të fesë dhe sulmeve vetëflijuese, pa trajtuar këtu ligjshmërinë e tyre fetare, apo jo; ku na

duhet të bëjmë dallimin e duhur mes rezistencës, luftës kundër armikut dhe terrorizmit.

Sigurisht ekziston diçka që mund të quhet “Trashëgimia Botërore e Terrorizmit” prej së cilës janë furnizuar shumë organizata perëndimore dhe evropiane të ndryshme në të shkuarën dhe në të tashmen e pjesa tjetër e mbetur ka marrë vetëm një pikë nga oqeani i tyre.

Disa vende, veçanërisht Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë vënë në shënjestër të sulmeve terroriste në vende të ndryshme të botës e më pak në Lindjen e Mesme, besoj se e gjitha kjo ndodh për shkak të rolit dhe pozicionit të tyre botëror, ashtu siç kërkon ajo prej tyre t'i kushtojnë rëndësi parimeve të drejtësisë dhe të barazisë dhe jo të ngjallin nëpër popuj e raca ndjenjën e përçmimit dhe të padrejtësisë.

Ibën Halduni në Mukadimanë e tij e thekson qartë: “Padrejtësia është fillimi i shkatërrimit”. Allahu i Lartmadhëruar ia ka ndaluar Vetes së Tij padrejtësinë dhe ka gjykuar që ajo në mesin e krijesave të ketë të njëjtin ligj: E NDALUAR. Kështu padrejtësi është të lihen pas dore të vërtetat shifrore, që paraqet gjuha e numrave dhe ta akuzosh Islamin apo muslimanët padrejtësisht dhe armiqësisht, si pasojë e disa sjelljeve njerëzore jo të drejta në gjykimin e tyre, që bien ndesh me logjikën e pastër dhe deklaratat e njerëzve të drejtë, pavarësisht se ku jetojnë ose veprojnë. ■

Përktheu: Ahmed KALAJA



LUFTA NË BFI?

Me krejt këto veprime u pa se kriza në BFI është reale, dhe se do të vazhdojë më tej, dhe se stabiliteti ka qenë virtual e i paqëndrueshëm.

SHKRUAN: RAMADAN RAMADANI

Lista e shembujve dhe anekdotave që të do mund të tregoheshin për të përshkruar krejt ngjarjet dhe ndodhitë që bëhen në dhe rreth Bashkësisë Fetare Islame në Republikën e Maqedonisë është shumë e gjatë. Ajo që më duket më e përshtatshme për të shpjeguar shkurtimisht janë disa aspekte të këtij historiku të dhembshëm të muslimanëve të Maqedonisë, sidomos pas pavarësimit të këtij shteti e këndej është kënga e moçme e nizamëve. Ajo këngë

e dhimbshme ku shqiptarët sunitë përcillen si ushtarë për shtatë vjet në luftë kundër shiitëve në Jemen që kanë ngritur krye kundër hilafetit. Ashtu edhe shqiptarët e Maqedonisë, në emër të krejt muslimanëve të këtushëm bëjnë një luftë shumë legjitime, në këtë rast shtatëmbëdhjetë vjeçare, për të vendosur legalitetin dhe legjitimitetin në këtë institucion. Por pse të dyja luftërat, edhe kjo e muslimanëve të Maqedonisë, edhe e nizamëve sunitë kundër shiitëve të Jemenit, edhe pse janë të drejta janë dhe ishin aq të dhimbshme. Pse sa herë që dëgjon këngën e nizamëve të përshkon dhimbja dhe pse sa herë që nisin përplasjet për dhe rreth BFI-së shqiptarët e këtushëm i kap një mërzi dhe dhimbje? Ka shumë aspekte nga mund të jepet përgjigje për këtë dilemë dhe kësaj pyetje, por kryesorja është se, as Jemeni, as Maqedonia nuk janë vendi ku shqiptarët do të marrin përgjigjet e tyre fetare për pyetjet kombëtare. Ashtu shiitët është dashur të luftohen në Iranin safevit, ose misionarët e tyre brenda Perandorisë Osmane; dhe nuk kanë qenë shqiptarët e pakët ata që do të mund të mbronin hilafetin sunit nga shiitët, por atë duhej ta kishin bërë të tërë sunitët e bashkuar. Ashtu edhe shqiptarët e Maqedonisë janë të dobët në një shtet jo dhe aq funksional dhe janë vetëm dhjetë përqindëshi i krejt shqiptarëve dhe si të tillë nuk mundin të japin zgjidhjen e duhur për krejt popullin shumë milionësh shqiptarë. Por le t'ia fillojmë këngës dhe ngjarjeve prej fillimit për të shpjeguar ngjarjet për dhe rreth BFI-së në Maqedoni.

O vijnë pampurat oj nanë rrethit detit, o dil e kshyri oj nanë asqert e mbretit

Disa qajshin oj nano, disa knojshin o nga një letër oj nanë n'bilad e çojshin

Ashtu kriza këtë herë në BFI filloi pas ndryshimeve që si duket kreu i këtij institucioni i bëri natën dhe pa kurrfarë njoftimi ose prononcimi paraprak. Por gabimi i tyre ishte se këtë e bënë duke kapërcyer

“Pas ndërrimit të Sulejman Rexhepit askush nuk do të mund ta keqpërdorë BFI-në si dyqan ose kështjellë...”

procedurat dhe sidomos Kuvendin e BFI-së, që është i vetmi institucion që mund të ndryshojë Kushtetutën e BFI-së. Ndryshimi më i madh ishte se është marrë autonomia e xhamisë që mund të sjellë pasoja afatgjate në funksionimin e organizimit të jetës fetare në Maqedoni. Pas këtyre ndryshimeve filluan këngët dhe qarjet dhe letrat që dërgoheshin. Ashtu për këto ndryshime nuk ishin gati tri muftini nga gjithsej trembëdhjetë me në krye muftininë më të mëmadhe, atë të Shkupit, kurse imamë, zyrtarë dhe kuvendarë të muftinive të Tetovës dhe Gostivarit iu dhanë isharete publike muftive të tyre, që të tërhiqen nga këto ndryshime jolegjitime të kushtetutës. Me krejt këto veprime u pa se kriza në BFI është reale, dhe se do të vazhdojë më tej, dhe se stabiliteti ka qenë virtual e i paqëndrueshëm. Por më problematike në krejt këto ngjarje është se mjerisht në vend që BFI të shkojë nga komunizmi në ndonjë lloj demokratizimi, ajo po shkon më tej në stalinizëm, duke mos dashur që askush të komentojë, as ditën një kushtetutë që është ndryshuar natën! Përveç kësaj shihet se në BFI kanë probleme edhe me opinionin, por edhe me vetë diksionin, që ata e shfaqin në opinion. Kështu njëri prej komenteve më të sakta, që u bënë rreth ngjarjeve në BFI nga ana e ish-dekanit të FSHI dr. Ismail Bardhit u prit si me thikë në faqen zyrtare të këtij institucioni. Ky është vetëm turpi i radhës që bëjnë disa njerëz nga kreu i BFI-së dhe që me këtë ia shtojnë mërzinë besimtarëve, por edhe vrullin njerëzve për nevojshmërinë e ndryshimeve të kreut të BFI-së, ku më në

fund duhet të vijjnë njerëz të ndershëm, të cilët do të mund të përfaqësojnë denjësisht muslimanët e Maqedonisë.

...o ishalla vjen oj nano naj devër tjetër...

Sigurisht që do të vijjnë kohë më të mira për përfaqësimin e muslimanëve të Maqedonisë, që është edhe lutja që vjen në fund të kësaj kënge të moçme të nizamëve. Ato kohë në këtë rast, tani dhe këtu vijjnë duke u vetëdijësuar muftitë nëpër muftinitë e BFI-së, se këto ndryshime nuk do të mund të kalojnë te hoxhallarët dhe aq më pak nëpër xhamitë dhe xhematet. Nëse kjo nuk kuptohet mirë nga ana e muftive, atëherë e njëjta gjë do t'u kthehet atyre në bumerang pasi me problemet që dalin nga marrja e autonomisë të xhemateve dhe ndryshimet e tjera do t'u dalë punë muftive dhe jo kreut të BFI-së në Shkup. Pra, me hapin e parë që është tërheqja e muftijve nga këto ndryshime jolegjitime dhe konsolidimin e organeve të vjetra në krye me kuvendin e BFI-së do të mund të sillët një rend, i cili do të mundësojë konsolidimin dhe instalimin e sërishëm të legalitetit dhe legjitimitetit në BFI. Pas ndërrimit të Sulejman Rexhepit askush nuk do të mund ta keqpërdorë BFI-në si dyqan ose kështjellë, ku do të mund të qëndrojnë për t'u fshehur nga dosjet, që së shpejti do të duhet të hapen patjetër në Maqedoni, si pasojë e ligjit për lustracion dhe proceseve të tjera që do të ndodhin këtu. Kështu që devri tjetër do të vijë inshaAllah, e deri atëherë për hair na qoftë muaji i Ramazanit. ■

IRAKU DHE ARDHMËRIA E LUFTËS MEDIATIKE

Konfliktet e ndryshme në të ardhmen do të kenë tendencën e inskenimit dhe dramatizimit të rregullave të masmediave, që do të thotë se edhe për mediet do të bëhet shumë më e vështirë për të zbuluar arsyet reale të konfliktit apo luftës.

SHKRUAN: AGRON KURTISHI

Luftërat dhe konfliktet e armatosura kanë qenë gjithmonë një betejë propagande tek të cilat format e komunikimit dhe të dezinformimit, si dhe të ndikimit të mendimit (opinionit) kanë luajtur rolin më të rëndësishëm. Të gjitha gjërat që ne shohim për momentin na tregojnë se në kohën e rrjeteve globale të komunikimit, të transmetimeve satelitore dhe raportimit në kohë reale, ne do të kemi mundësinë të përjetojmë luftëra të tjera, të cilat do të jenë të udhëhequra jo nga diçka tjetër, por vetëm nga Media.

Lufta e Irakut nga kjo pikëpamje ka arritur një kualitet të ri. Edhe kjo luftë ishte me bomba dhe granata, por konceptet për udhëheqjen mediatike të luftës kanë qenë pjesë përbërëse e integruar dhe shumë e rëndësishme e planeve ushtarake. E njëjta gjë vlen edhe për sigurimin e një fushate, e cila do të mund të "arsyetonte" (të fajësonte

diktatorin irakian dhe ta nxirrte Amerikën shpëtimtare të popullit irakian) përballë botës. Me këtë gjë, kjo luftë na ofron shijen se si do të duken luftërat e komunikimit në shekullin që jetojmë. Po përmend disa pika të rëndësishme nga ky aspekt:

Koncepti i **Public Diplomacy** na tregon një profesionalizim të propagandës shtetërore. Konfliktet e ndryshme në të ardhmen do të kenë tendencën e inskenimit dhe dramatizimit të rregullave të masmediave, që do të thotë se edhe për mediet do të bëhet shumë më e vështirë për të zbuluar arsytet reale të konfliktit apo luftës. Së pari vendoset një temë në agjendë dhe kjo temë problematizohet në të gjitha fushat dhe sferat, dhe dikur si bazë të kësaj kemi fillimin e një lufte.

Termi i informacionit mbi betejën është i plotë në pretendimin e tij. I plotë ngaqë ai së pari nuk ka si qëllim popullin e shtetit që bën luftën (pra, popullin amerikan), as popullin e shtetit ku bëhet lufta (popullin irakian), ose aleatët e ndryshëm, por si për çudi ka si qëllim popullatën e të gjithë botës dhe së dyti me termin Informacion nuk mendohet vetëm njoftimet e përhapura nga masmediat, por strukturën totale dhe gjithëpërfshirëse të komunikimit të kundërshtarit, që do të thotë rrjete të dhënash, si për civilë ashtu edhe për ushtarakë, të gjitha infrastrukturat e komunikimit si dhe masmediat.

Propaganduesit konfrontohen sot me një publik global dhe me një gazetari të lidhur në rrjet me të gjithë globin. Një kontroll i plotë i fotove dhe i mesazheve, që qarkullojnë nëpër rrjetin global nuk është e mundur dhe kjo vlen edhe për raportimin nga vendet e ndryshme, për ngjarje të ndryshme. Nga ky aspekt të gjitha strategjitë duhet të kthehen dhe të aktivizohen nëpër media dhe qëllimi kryesor është që mediet të jenë partnerët më të mirë të bashkëpunimit. Në qoftë se kjo gjë është e suksesshme, nga pikëpamja ushtarake krijohen potenciale të reja ngaqë atëherë

“Siç po shikohet kohët e fundit (fatkeqësisht me vonesë), që të gjitha arsytet se përse Amerika ka filluar luftën nëpër vende të ndryshme janë gënjeshtër të pastra...”

mediet mund të përdoren në mënyrë të qëllimshme për qëllime të ndryshme ushtarake.

Mediet dhe publiku në të ardhmen me tendencë në rritje do të jenë pjesë e manipulimeve dhe instrumentalizimeve ushtarake e politike. Këtu shtrohet pyetja se: a ka mundësi që në të ardhmen të kundërshtohet dhe t'i kundërvihet e gjithë bota këtij “agjenti të ideve dhe mendimeve” dhe: a do të ketë mundësi dhe a do të ketë një shans real që një problem qoftë ai i vogël apo i madh të përpunohet dhe të trajtohet në një diskurs të lirë?

Fakti është se mediet mësojnë nga çdo manovër mashtruese, të cilën e kanë kaluar njëherë, por problemi qëndron te taktikat e reja, të cilat i përdor ushtria dhe ekipet e ndryshme që punojnë natë e ditë vetëm e vetëm për të gjetur strategji të reja me të cilat mundet të manipulojnë me forma të reja jo vetëm mediet, por edhe popullin nëpër të gjithë botën. Siç po shikohet kohët e fundit (fatkeqësisht me vonesë), që të gjitha arsytet se përse Amerika ka filluar luftën nëpër vende të ndryshme janë gënjeshtër të pastra. Deri tani akoma nuk është vërtetuar me saktësi asnjë lidhje ndërmjet Saddam Huseinit dhe Al Kaedës dhe as nuk janë gjetur fakte për një program bërthamor të Irakut dhe as nuk u gjetën



bomba biologjike me rrezikshmëri shumë të lartë të ashtuquajturat B dhe C.

Për nga besueshmëria, politika e informimit në Amerikë ka filluar të ketë pasoja. Ka mjaft persona, të cilët kanë reaguar lidhur me politikën amerikane nëpër shtetet e tjera, mirëpo këto persona si zakonisht nga mediet e ndryshme nuk publikohen, për shkak të kritikave të tyre. Po përmend vetëm 2 nga personat, që kanë reaguar në lidhje me politikën amerikane të informimit: **Hans Ulrich Wehler** thotë se: “inskenimi i luftës në Irak ishte një gënjeshtëri”¹ dhe gjithashtu thotë që në qoftë se do të kishte ndonjë fjalë që e përshkruan më mirë gënjeshtren, ai do ta kishte përdorur pa e menduar. Gjithashtu diplomati amerikan **Joseph Wilson** ka reaguar

në lidhje me luftën në Irak dhe ka thënë: “Në qoftë se qeveria amerikane falsifikon fakte dhe i paraqet ato në mënyrë të gabuar vetëm për të justifikuar luftën e gabuar, atëherë nuk dua të mendoj se për çfarë po na gënjën ajo më?”² Kjo do të thotë se qeveria nuk duhet të besohet më asses. Statistikat e fundit që janë nxjerrë nga sondazhet me popullin tregojnë se besueshmëria e qeverisë amerikane ka rënë shumë. Kjo tregon se qeveria duhet të riorganizohet dhe të mendojë diçka tjetër. Me këtë gjë ka mundësi që riorganizimi i ardhshëm i aparatit propagandues nuk do të jetë më nën idenë e përmirësimit të efektivitetit, por qëllimi duhet të jetë përmirësimi dhe kthimi i besueshmërisë. ■

(autori është ligjërues në UEJL)

¹ Citim nga gazeta gjermane Der Tagesspiegel datë 19.7. 2003, fq. 2.

² Citim nga gazeta gjermane Die Zeit, Nr. 29 e datës 10.7. 2003, fq. 6.



Me këtë shkrim
u drejtohem
asgjësuesve të kohës
si dhe atyre në mes.
Atyre tek të cilët
gjejmë shfrytëzim të
mirëfilltë të kohës,
por edhe shumë kohë
të harxhuar pa
përfitim.

RAMAZANI, KJO KOHË¹ E BEKUAR

SHKRUAN: TALHA KURTISHI

Ramazani është një pjesë e bekuar e asaj kohe që kemi në dispozicion.

I falënderuar qoftë Ai që ndërrimin e ditës dhe natës, e moteve dhe sezoneve të hairit e bëri argument për ata që logjikojnë, për ata që të menduarit e tyre e shfrytëzojnë në vepra të mira në përditshmërinë e tyre... ata janë të mençurit e vërtetë.

Prej kalimit të kohës, argumentit më bindës për përkohshmërinë tonë në këtë botë përfiton vetëm një numër i vogël i njerëzish. Koha, në të cilën fillon, vazhdon dhe përfundon jeta jonë, harxhohet ose thënë ndryshe asgjësohet, duke e shndërruar në një të kaluar, së cilës shpeshherë i referohemi si

diçka, që patëm mundësi ta shfrytëzojmë më mirë. Përfashtim nga ky fenomen i “armiçësisë” ndaj kohës, i cili tanimë ka arritur përmasat e një pandemie janë besimtarët e vëmendshëm dhe vigilentë, e sa të pakët që janë ata! Për ta, shtyrja e veprave të mira për një kohë të caktuar ose të papërcaktuar është jologjike dhe e papranueshme. Angazhimin me vepra të dobishme ata e kanë vendosur në krye të listës me titull “**Shtyrja e këtyre veprave nuk vjen në konsideratë**”. Këta e kanë kuptuar më së miri realitetin e kohës.

Me këtë shkrim u drejtohem asgjësuesve të kohës si dhe atyre në mes. Atyre tek të cilët gjejmë shfrytëzim të mirëfilltë të kohës, por edhe shumë kohë të harxhuar pa përfitim. U drejtohem duke shpresuar se në muajin e

¹ Koha është: Vazhdim e kalim i pandërprerë i minutave, i orëve, i ditëve, i muajve, i viteve, nga e shkuara në të ardhshmen dhe pa kthim prapa (Fjalori i Shqipes së Sotme).

Ramazanit, i cili sapo ka filluar, muajin në të cilin shumica e muslimanëve zgjohen disi nga amullia, ta përjetojnë duke e ripërtëritur nocionin e adhurimit ndaj Allahut në jetën e tyre. Vlerat e Ramazanit janë të shumta: agjërimi dhe falja në të me iman dhe shpresë për shpërblim i fshijnë mëkatet, në të prangosen shejtanët, hapen dyert e xhenetit dhe mbyllen dyert e Zjarrit, në të është nata e Kadrit, e cila është më e vlefshme se njëmijë muaj, gjatë Ramazanit në natën e Kadrit është shpallur Kurani, libri më i rëndësishëm në jetën e muslimanit, në këtë muaj gëzimi i agjëruarit është i dyfishtë, kur bën iftar dhe kur do të takohet me Krijuesin e tij dhe kështu me radhë...

Përpos vetëdijesimit të pjesshëm për orarin e ushqimit dhe namazit të teravisë, shumica nuk përfiton nga këto vlera të shumta që ka më i zgjedhuri i muajve të vitit. Këtë realitet e shohim kudo përreth nesh. Në vijim do të përmend disa aspekte, që aktualizohen gjatë Ramazanit dhe që i shoh të domosdoshme për ripërtëritjen e kuptimit të adhurimit, detyrës tonë në këtë jetë.

Imani. Nëse shumicën e agjëruarëve i pyesim të tregojnë pse agjërojnë, ne do të shohim se shumica prej tyre agjërojnë, sepse besojnë që agjërimi është detyrë me të cilën i ka urdhëruar Allahu në Librin e tij dhe i Dërguari i Allahut në hadithet e tij. Nuk është qëllimi ynë të vërtetojmë saktësinë e një pohimi të tillë apo ta mohojmë. Atë që duam të theksojmë është se zbatimi i urdhrave të Allahut dhe të Dërguarit janë vërtetim i besimit/imanit, që ka agjëruari. Vetëm agjërimi i motivuar me këtë iman është i dobishëm dhe i pranueshëm. Nëse agjërimi dhe çdo adhurim tjetër bazohet në diçka tjetër e jo në iman, atëherë është i padobishëm madje edhe i dëmshëm. Këtë konceptim të imanit, si themel i çdo adhurimi duhet ta kemi në konsideratë në Ramazan dhe jashtë Ramazanit.

“Atë që duam të theksojmë është se zbatimi i urdhrave të Allahut dhe të Dërguarit janë vërtetim i besimit/imanit, që ka agjëruari...”

Vendosmëria. Të gjithë e dimë se sa rëndësi ka vendosmëria për plotësimin e agjërimin, se sa të vendosur duhet të jemi e të privojmë vetën nga ushqimi, pijet dhe marrëdhëniet seksuale nga agimi deri në kohën e perëndimit të diellit, në veçanti kur duhet agjëruar në një ditë të gjatë dhe të nxehtë. Në të njëjtën kohë parashtrohet dilema sa jemi të vendosur në zbatimin e parimeve të fesë në situata të ndryshme. Sa të vendosur jemi që të realizojmë misionin tonë në këtë dynja, të bëhemi robër të vërtetë të Allahut në çdo kohë dhe vend.

Vazhdimësia. Në Ramazan shohim se si në vazhdimësi, prej fillimit të muajit e deri në fund, të gjithë muslimanët agjërojnë. Kështu ata praktikisht e vërtetojnë mundësinë e zbatimit të parimit të vazhdimësisë në adhurime, gjë kjo e cila nga shumë skeptikë vihet nën pikëpyetje. Mbetet që vazhdimësia në adhurime të mbetet tipar i yni edhe pas Ramazanit.

Allahu të sheh. Me siguri që na ka ndodhur, që në ndonjë pjesë të ditës kur agjërimi na është vështirësuar t'i dëgjojmë cytjet e shejtanit, 'tani je i vetmuar askush nuk të sheh', 'asgjë nuk do të ndodhë nëse freskohesh pak', 'janë shumë ata që fshehurazi hanë dhe pinë'... Qëndrimi refuzues ndaj këtyre cytjeve në shumicën rasteve është rezultat i vetëdijes për mbikëqyrjen Hyjnore. E largojmë duke ia kujtuar vetes faktin se Allahu na sheh në çdo

vend. Sa bukur do të ishte që cytjeve të shejtanit për ta lënë ndonjë adhurim, ose për të bërë ndonjë mëkat t'i përgjigjemi me bindjen e thellë të shprehur me fjalët: **Allahu na sheh.**

Edukimi me përjetim. Asnjëherë nuk do ta kuptojmë plotësisht hallin e ndonjërit derisa të mos e përjetojmë atë që ai ka përjetuar ose është duke e përjetuar. Përshkrimi i urisë dhe etjes, që janë hallet më të mëdha të varfërve, me fjalë sado bukur të thurura, zbehen para realitetit, i cili del në pah me përjetimin praktik të urisë dhe të etjes. Agjërimi të ndihmon praktikisht ta kuptosh gjendjen e tyre dhe të nxit praktikisht të marrësh pjesë në zgjidhjen e problemit të tyre. Ky është vetëm një aspekt i edukimit me përjetim, i cili është i dobishëm edhe në vlerësimin e gjendjeve, por edhe në nxitjen për angazhimin e duhur që shumë probleme të tejkalohen.

Kurani. Ramazani është muaji i Kuranit dhe të gjithë mundohen, që numri i hatmeve në këtë muaj të jetë sa më i madh. Por çfarë ndodh me të pas Ramazanit. A thua vallë se pas tij nuk kemi nevojë për librin që ndan të vërtetën nga e pavërteta, për librin udhërrëfyes drejt çdo të mire, për fjalët me të cilat i Gjithëmëshirshmi i drejtohet kësaj krijese të dobët që bën çrregullime në tokë. Një problem tjetër është leximi i Kuranit pa menduar thellë rreth kuptimeve që ka. Nëse në Ramazan kemi mundur të ndajmë kohë për fjalët e Zotit të gjithësisë, duke e vendosur atë në planin ditor e njëjta gjë ndoshta në mënyrë akoma më të përpiktë duhet të vazhdojë edhe pas Ramazanit. Kuptohet flasin për leximin të zbukuruar me mësim dhe zbatim praktik.

Namazi i natës. Këtë adhurim të falënderuesve, e praktikojnë shumë njerëz në Ramazan, që të njëjtin ta vendosin në arkiv pas tij. Në pjesën e fundit të natës ata në namaz i drejtohen Allahut, që zbret në qiellin

e dynjasë dhe i thërret kërkuesit të faljes, lutësit... me shpresë që t'i përfshijë mëshira e Tij. Askush që me të vërtetë e ka shijuar kënaqësinë e namazit të natës, nuk ka për të hequr aq lehtë dorë prej tij. Hasan Basriu thotë: Ai që e lë namazin e natës nuk e ka bërë atë veprim përpos për shkak të ndonjë mëkati të tij. Bëhu falënderues dhe ndihmoje veten me këtë adhurim të veçantë në kohën kur Ai që u përgjigjet lutjeve zbret në qiellin e tokës.

Duaja. Duanë, të cilës i kemi kushtuar aq vëmendje në kohën e iftarit dhe në namazin e natës nuk duhet ta anashkalojmë pas Ramazanit. I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: Duaja është adhurim. Në një hadith tjetër ka treguar se Allahu hidhërohet me njeriun që nuk i drejtohet me lutje. Me dua ne shprehim nevojën e madhe që kemi për Allahun dhe për ndihmën e Tij, gjë kjo e cila është baza e adhurimit. Ngelet që edhe pas Ramazanit duaja të mbetet arma jonë e fuqishme në ballafaqimin me problemet e jetës.

Farefisi dhe uniteti i muslimanëve në sofrën e iftarit. Ruajtja e lidhjeve farefisnore është detyrim dhe ndërprerja e tyre është mëkat i madh. E njëjta gjë vlen edhe për ruajtjen e bashkimit të muslimanëve dhe përçarjen, e cila dobëson umetin islam. Sofra në të cilën agjëruesi i ofrohet iftar është mjet i mirë për forcimin dhe thellimin e lidhjeve mes farefisit, si dhe mes muslimanëve në përgjithësi. Nëse gjatë Ramazanit në sofrën tonë, në vendin ku janë afruar zemrat dhe janë forcuar lidhjet, ka pasur vend për të afërmin dhe atë më pak të afërt e njëjta gjë le të vazhdojë edhe pas Ramazanit. Kohët janë të vështira dhe kemi nevojë për mjete, që i bashkojnë dhe i afrojnë adhuruesit e Allahut.

Namazi i sabahut me xhemat. Sa e bukur është xhamia përplot me xhemat në namazin e sabahut. Nga begatitë e Ramazanit është xhamia e mbushur me xhemat në namazin e sabahut, në namazin më të vështirë për

mynafikët. Ah, sikur të ishin xhamitë ashtu të mbushura në namazin e sabahut, edhe pas Ramazanit me siguri që numri i problemeve me të cilët ballafaqohemi do të ishte dukshëm më i vogël. U drejtohem zemrave në të cilat akoma ka gjallëri, që faljen e namazit të sabahut në xhami ta vendosin në listën e

detyrave më emergjente. Çfarë bereqeti pret ummeti, i cili namazin e sabahut nuk e fal në xhami, umeti për të cilin i Dërguari i Allahut ka thënë: *“Bereqeti i umetit tim është në zgjimin herët (në mëngjes)”*.

Allahu është dhuruesi i suksesit ■

PRISHJA E TË RINJVE DHE PROBLEMET E TYRE

Të shumta janë rastet kur një person del larg familjes dhe ftohet prej tyre dhe do Allahu që ai të udhëzohet dhe pas kësaj bëhet pishtar udhëzimi dhe reformator, jo vetëm në familje, por edhe në shoqëri

www.islamweb.net

Ka shkaqe të ndryshme për prishjen e të rinjve dhe problemet e tyre. Të rinjtë kalojnë përmes zhvillimeve shumë të shpejta fizike, mendore dhe intelektuale. Kështu që lind një nevojë e madhe që ata të pajisen me mjetet e vetë-kontrollit dhe të mbajnë nën fre sfidat e tyre, si dhe kanë nevojë për një udhëheqës të mençur që mund t'i drejtojë ata në rrugën e duhur.

Prishja e të rinjve mund t'i atribuohet shumë faktorëve, ku më të njohurit midis tyre janë:

1. Papunësia:

Papunësia është një sëmundje që vret aftësitë mendore, intelektuale dhe fizike. Në fakt është diçka e ditur që qeniet njerëzore punojnë; dhe nëse ato privohen nga puna e lëvizja, truri iu bllokohet, intelekti i tyre dobësohet dhe mendja dobësohet nga ngasjet djallëzore dhe mendimet keqdashëse marrin kontrollin e zemrave të tyre.

E keqja dhe qëllimet e liga mund të ndodhin tek ata si rezultat i depresionit, që zakonisht vjen nga të qenit i papunë.

Në mënyrë që të kurohen nga kjo sëmundje, të rinjtë e prekur nga ky fenomen duhet të merren me aktivitete të tilla, si leximi, të shkruarit, tregtia ose ndonjë aktivitet tjetër që mund të qëndrojë midis tyre dhe papunësisë, e cila mund t'i bëjë ata anëtarë të dobishëm dhe të fortë të komunitetit.

2. Ftohja (ndarja) midis të rinjve dhe të vjetërve

Ky problem shfaqet në një situatë, ku disa të vjetër shohin prishje tek të rinjtë e tyre dhe ata qëndrojnë vetëm të përmbajtur (të ftohtë), pa bërë ndonjë përpjekje që t'i korrigjojnë ata dhe për pasojë i kanë humbur shpresat për rregullimin e tyre.

Ky problem sidoqoftë mund të zgjidhet nëse të vjetrit dhe të rinjtë i heqin ndasitë, kundërshtitë dhe ftohjen, që është e pranishme midis tyre.

Të dyja palët duhet të sjellin ndërmend,

se shoqëria me të vjetrit dhe të rinjtë e saj duhet të jetë si një trup i vetëm, dhe nëse një pjesë e saj prishet, dekadencia do të preki të tërë trupin.

Të vjetrit gjithashtu kërkohet të kenë ndjenjën e përgjegjësisë kundrejt të rinjve të tyre dhe të ndryshojnë qëndrimin lidhur me mendimin për mungesën e respektit të të rinjve ndaj tyre, sepse Allahu është i aftë të bëjë gjithçka.

Të shumta janë rastet kur një person del larg familjes dhe ftohet prej tyre dhe do Allahu që ai të udhëzohet dhe pas kësaj bëhet pishtar udhëzimi dhe reformator, jo vetëm në familje, por edhe në shoqëri.

Të rinjtë në pjesën e tyre më të madhe duhet t'i nderojnë të vjetrit. Ata duhet të respektojnë mendimet dhe t'i pranojnë urdhrat e tyre, sepse ata kanë mençuri dhe përvojë më të madhe se sa të rinjtë. Prandaj kur mençuria e të vjetërve i shtohet energjisë së të rinjve, shoqëria begatohet, me lejen e Allahut.

3. Mbajtja e shoqërisë me njerëz te prishur

Shoqëria e keqe ka një ndikim të madh psikologjik, mendor dhe moral tek të rinjtë. Kjo është arsyeja përse i Dërguari i Zotit, paqja qoftë për të, ka thënë: *“Njeriu është në fenë e shokut të tij, kështu që shikoni se me kë po miqësoheni”*. E shënon Ahmedi dhe Ebu Davudi.

Prandaj rinia duhet të zgjedhë njerëz të drejtë, të mirë dhe inteligjentë për t'u shoqëruar, në mënyrë që të përfitojë nga mirësia, drejtësia dhe intelijenca e tyre. Para se të shoqërohen me të tjerët, ata duhet të shikojnë rrethin dhe gjendjen e tyre. Nëse ata që konsiderohen se janë njerëz me karakter fisnik, të drejtë, fetarë dhe të mirë, ata ngjajnë me një ushqim të gjatë dhe të pasosur për mendjet dhe shpirtrat e tyre, prandaj edhe ata duhet të qëndrojnë më afër këtyre njerëzve.

Nëse, në anën tjetër, janë njerëz me karakter të keq, atëherë ata duhet t'i mbajnë larg dhe të mos shoqërohen, për shkak të bisedave të ëmbla dhe dukjes së mirë të jashtme, sepse këtë e bëjnë për të maskuar brendinë e tyre dhe kështu duhet të tregojnë kujdes nga tipa të tillë.

4. Leximi i librave, revistave dhe gazetave të dëmshme

Ky lloj literature ka në vetvete një rrezik të madh për t'i larguar njerëzit nga feja, besimi, nga morali i përkryer drejt humnerës së degjenerimit, që natyrisht të çojnë në 'kufër' (mosbesim).

Zgjidhja e këtij problemi është që të ndërrohet menjëherë leximi i një literature të tillë me materiale që rrënjësin dhe kultivojnë dashurinë për Allahun dhe të Dërguarin e Zotit, paqja qoftë për të, në zemrat e tyre dhe materiale të tjera që ndihmojnë në aktualizimin e besimit dhe veprave të mira.

Gjithashtu, leximi i literaturës së dëmshme i mënjanon të rinjtë nga ngritja shpirtërore, sepse ajo pengon prirjet natyrore për të bërë mirë. Ata duhet të vazhdojnë me durim leximin ose dëgjimin e materialeve të tilla, sepse shpirti do t'i nxisë ata, në mënyrë që t'i detyrojë në moskushtimin e vëmendjes, nga ajo që ata janë mësuar si zakonisht dhe do t'i bëjë të ndihen të mërzhitur dhe të irrituar nga librat e dobishëm dhe burimet e sigurta e pozitive.

Gjithashtu ka shumë libra që mund të shtojnë ngritjen shpirtërore dhe praktikën, ato janë Kurani, hadithet e sakta dhe shkrimet e shumta të dijetarëve, jeta e të Dërguarit të Allahut, bekimet qofshin mbi të, shokëve të tij dhe figurave heroike të historisë islame. ■

Përshtati nga anglishtja: Fitim NUHIU

KU JANË BURRAT SHQIPTARË!

Vazhdon “epidemia” e të këqijave në vendin tonë

SHKRUAN: HAJRUSH MANI

Deshe apo jo, duke lexuar te përditshmet informative dhe duke dëgjuar lajmet (rrallë herë dëgjon të mira), inspirohesh të shkruash atë që nuk e dëshiron të jetë e pranishme në popullin tënd. Jo rastësisht ka dalë proverbi popullor “Aty ku të dhemb dhëmbi, shkon dhe gjuha”. Kishte kohë që në lajme nuk kisha dëgjuar për abuzime seksuale, prostitucion dhe keqtrajtime të të miturve. Edhe ato lajme që i kisha dëgjuar kishin të bëjnë me rajone të tjera, të cilat janë shumë larg vendit tonë dhe nuk kishin të bëjnë me popullin tim dhe as me fenë së cilës i përkas edhe unë. Por nga dita në ditë, nga muaji në muaj lajmet sa vinin e afroheshin edhe në vendin tim. Shembuj dhunimi në familje dhe tani së fundmi prostitucion me vajza të mitura. Të gjitha rastet e regjistruara nga ana MPB-së janë në lokalet e natës që janë në pronësi të shqiptarëve.

Dy tituj mjaft prekës më detyruan të shkruaj, njëri titullohej “Një 15 vjeçare prostituohet në Zhelinë” dhe tjetri “Paraburgim për prostituimin e të miturës”. Në të dy rastet protagonistët kryesorë ishin shqiptarë, ndërsa lokalet e tyre ishin në vendbanime shqiptare, fshati Zhelinë i



Tetovës dhe tjetri në qytetin e Tetovës.

Vallë harruan këta “BURRA” shqiptarë se historikisht trojet shqiptare (të banuara me muslimanë) kanë ditur të përballen me sfida të natyrave të ndryshme, meqë shumë herë u ka rënë për hise të bashkëjetojnë me kultura dhe civilizime të ndryshme. Mirëpo çdo dukuri negative është kundërshtuar dhe nuk e kanë përvetësuar, kur nuk ka qenë e denjë për moralin dhe edukatën që kanë trashëguar e mësuar, qoftë nga bindjet fetare por dhe ato kombëtare. Pavarësisht nga pabarazia në të drejtat e grave shqiptare, kundrejt burrave, apo pavarësisht padrejtësive në trajtimin e tyre, gruaja (muslimane) shqiptare kurrë nuk është konsideruar si mall që mund të shitet e rishitet, apo blihet e riblihet, njësoj ka qenë edhe me gratë e përkatësive të tjera etnike dhe fetare. Pra, trafikimi për qëllime prostitucioni “nuk ka histori”, të paktën ai nuk është kurrësi një fenomen tipik shqiptar. Nuk rezulton që ky fenomen të ketë pasur përhapje të krahaseshme me shumë vende të tjera evropiane, siç është Bullgaria, Greqia apo Italia, vende të tjera mesdhetare, Anglia etj., në të cilat prostitucioni dhe trafikimi i femrave ka lulëzuar në çdo fazë të qytetërimit të tyre.


Unë për sa vite që kam lexuar nuk mbaj mend që trafikimi të jetë përmendur në librat mbi historinë e Shqipërisë dhe shqiptarëve, në vise ku ata jetojnë, në të drejtën zakonore shqiptare, në libra kronikash, gjeografësh, albanologësh, në folklorin shqiptar etj. Pohimi se trafikimi “nuk ka histori” duhet kuptuar si një fakt: shqiptarët në përgjithësi, nuk kanë prodhuar dukuri të tilla. Prostitucioni është një ndër dukuritë më të dhimbshme e më tragjike të tranzicionit tek ne. Nuk duhet harruar se Pejgamberi, salallahu alejhi ue selem, na e ka tërhequr vërejtjen nga ky rrezik duke thënë: “*Keni drojë dynjanë dhe*

“... gruaja (muslimane) shqiptare kurrë nuk është konsideruar si mall që mund të shitet e rishitet, apo blihet e riblihet...”

gratë, se sprova e parë e israilëve kanë qenë gratë”. (Muslimi). Do të përmend këtu rastin e një të riu, i cili kur ka shkuar te Pejgamberi, salallahu alejhi ue selem, i ka thënë atij: “Më lejo të bëj zina”. Pejgamberi, salallahu alejhi ue selem, i ka thënë: “*A e dëshiron të njëjtën gjë për nënën tënde, bijën, bashkëshorten, hallën dhe tezën tënde?*” Ai ka thënë: “Jo, o i Dërguari i Allahut”. Pejgamberi, salallahu alejhi ue selem, pastaj i tha: “*As të tjerët nuk e duan këtë për bijat, motrat, hallat dhe tezet e tyre*”. (Ahmedi nga Ebu Umame). Nëse të bie të zgjedhësh vdekjen apo cenimin e nderit, si do të kishe vepruar? Atëherë si i lejon vetes të marrësh nderin e huaj nëpër këmbë? Pejgamberi, salallahu alejhi ue selem, thotë: “*Kush vritet duke mbrojtur familjen e tij, është dëshmor*”. (Ahmedi, Ebu Davudi, Nesaiu, sahih). Ndërsa sot çfarë po ndodh me shqiptarët, a po i zbatojnë ata urdhrat e Allahut, subhanehu ue teala, dhe Pejgamberit, salallahu alejhi ue selem.

Kam dëgjuar një fjalë të urtë që thotë: “**Shpërblimi apo dënimi është i lidhur me llojin e punës**”, e ti a je i gatshëm që të sprovohesh në nderin tënd, qoftë tashti apo më vonë për t’i kënaqur epshet e tua? Allahu, subhanehu ue teala, thotë: “**Ndëshkimi i të keqes, bëhet me një të keqe në të njëjtën masë**” (Esh-Shura 40). Mos harro se edhe ti ke nënë, motër, bashkëshorte, bijë, vajzë... pra, ruaju dhe ki kujdes! ■

RAMAZANI, NJË MUAJ I VOLITSHËM PËR TË RIPËRTËRIRË IMANIN



Zemra luan rolin thelbësor për sa i përket imanit, ndaj dhe çështja e zemrës është një çështje shumë delikate dhe shumë e rëndësishme. Bindja dhe ndjenjat shpirtërore të njeriut, që sipas civateve fetare e kanë vendin në zemër, ndryshojnë shumë shpejt

SHKRUAN: ISMAIL BARDHOSHI

I Dërguari i Allahut salallahu alejhi ue selem, thotë: “Vërtet, besimi vjetrohet në brendësinë e zemrës së ndonjërit prej jush, ashtu siç vjetrohet rroba, prandaj luteni Allahun që ta ripërtërijë besimin në zemrat tuaja”.

Dobësia e besimit është një dukuri që ka marrë përmasa të gjera tek muslimanët dhe sidomos tek rinia islame. Një numër i konsiderueshëm njerëzish ankohen nga ashpërsia dhe pandjeshmëria e zemrës. Në

gojët e tyre qarkullojnë shprehje të tilla si: ‘ndej ashpërsi në zemër’, ‘nuk ndiej kënaqësinë e ibadeteve’, ‘ndej se imanin e kam shumë poshtë’, ‘nuk ndikohem nga leximi i Kuranit’. Në fakt, tek shumë njerëz, që dikur mund të merreshin shembull për gjallërinë, zellin dhe përkushtimin e tyre janë shfaqur simptomat e kësaj sëmundje të rrezikshme. Kjo sëmundje është themeli i çdo fatkeqësie dhe shkak i çdo mangësie e belaje.

Rrënjët e kësaj sëmundje gjenden në zemër, pasi siç dihet rrënjët e besimit, si bindja, dashuria për Allahun, mbështetja tek

Ai, frika prej Tij, shpresa për të mirat e tij, përmallimi për takimin me Të etj., janë në zemër, kështu që në qoftë se çrrënjohet ose dobësohet imani në zemër, një gjë e tillë reflektohet edhe në fjalët dhe veprat e njeriut. Zemra luan rolin thelbësor për sa i përket imanit, ndaj dhe çështja e zemrës është një çështje shumë delikate dhe shumë e rëndësishme. Bindja dhe ndjenjat shpirtërore të njeriut, që sipas citeve fetare e kanë vendin në zemër, ndryshojnë shumë shpejt. Pikërisht, për këtë arsye në arabisht zemra quhet ‘kalb – që do të thotë: ‘përmbysje, rrotullim, ndryshim’. Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, ka thënë: *“Zemra ka marrë emrin ‘kalb’ për shkak se përmbysët, rrotullohet. Zemra është si shembulli i një pende të varur në një pemë të cilën e rrotullon era lart e poshtë, sa nga njëra anë në anën tjetër”*. E shënon Ahmedi. Sipas një varianti tjetër, Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, thotë: *“Zemra është si shembulli i një pende në një tokë të shkretë, të cilën e përmbys era lart e poshtë”*. Në një hadith tjetër duke përshkruar shpejtësinë e rrotullimit të zemrës Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, thotë: *“Zemra e birit të Ademit rrotullohet më shpejt se sa tenxherja kur mbushet me valë”*. E shënon Ahmedi. Faktikisht, rrotullimin e zemrave e bën vetëm Allahu i Lartësuar. Abdullah b. Amër b. Asi tregon se ka dëgjuar Pejgamberin salallahu alejhi ue selem, duke thënë: *“Të gjitha zemrat e bijve të Ademit janë midis dy gishtërinjve të Allahut, si një zemër e vetme të cilën Ai e rrotullon si të dëshirojë”*. Më pas Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, tha: *“O Allah! O Rrotullues i zemrave, drejtoje zemrën time që të të bëjë ibadet Ty”*. Shënon Muslimi.

Megenëse Allahu ndërhyt **“ndërmjet njeriut dhe zemrës së tij”**, meqë në Ditën e Gjykimit shpëton **“veçse ai që vjen me zemër të pastër tek Allahu”**, meqë mjerimi është për

“ata që e kanë zemrën ta pandjeshme, kur përmendet Allahu” dhe meqë në xhenet do hyjë **“ai që e ka pasur frikë të Gjithëmëshirshmin, edhe atëherë kur nuk e shihte kush, e që ka ardhur me zemër të kthyer nga Allahu”**, doemos besimtari duhet t’i kushtojë vëmendje zemrës dhe të njohë se ku qëndron sëmundja dhe pa humbur kohë le të fillojë ta trajtojë problemin para se ligësia t’ia mbulojë zemrën e për pasojë të shkatërrohet.

Në zemrën e njeriut zhvillohet një betejë e ashpër mes melekut që nxit për mirë dhe shejtanit që nxit për ligësi, mes prirjeve, ndjenjave e dëshirave të mira dhe mes dëshirave të liga, mes arsyes dhe mes epshit. Për të fituar këtë betejë besimtari duhet të ndërmarrë të gjitha shkaqet, që do ta ndihmonin për të mposhtur shejtanin dhe prirjet e dëshirat e liga të nefsit të tij, shkaqe këto të cilat do të krijonin kushtet për rritjen e besimit. Fitorja e kësaj beteje nga ana e besimtarit është kusht i domosdoshëm për të arritur mirësinë dhe lumturinë si në këtë botë edhe në botën tjetër.

Duke theksuar faktin që imani ka nevojë për ripërtëritje Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, në një hadith që e shënon Hakimi dhe Taberani, ka thënë: *“Vërtet, besimi vjetrohet në brendinë e zemrës së ndonjërit prej jush ashtu siç vjetrohet rroba, prandaj luteni Allahun, që ta ripërtërijë besimin në zemrat tuaja”*. Ndonjëherë zemrën e besimtarit e mbulon ndonjë re gjynahu e për pasojë ajo errësohet. Ky është një sqarim që e bën për ne Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, në një hadith të saktë, duke thënë: *“Çdo zemër mbulohet nga një re si reja që errëson hënën. Ndërkohë që hëna reflekton dritë, e mbulon një re dhe për pasojë ajo errësohet, ndërsa kur kthjellohet qielli, hëna ndriçon”*. E shënon Ebu Nuajmi në Hilje. Si puna e reve që mbulojnë dritën e hënës janë edhe retë errësuese të gjynaheve, të cilat mbulojnë

zemrën e njeriut dhe ia pengojnë dritën. Në këtë mënyrë njeriu mbetet në errësirë e në vetmi. Por nëse angazhohet për shtimin e besimit duke i kërkuar ndihmë Allahut, ato re do të zhduken dhe zemra do të ndrisë si më parë.

Një parim i rëndësishëm për të konceptuar mënyrën se si trajtohet problemi i dobësisë së besimit është edhe njohja e faktit se imani shtohet dhe pakësohet, gjë e cila është çështje thelbësore në besimin e **Ehli Sune uel Xhemaah**, pasi ata thonë se imani përbëhet nga besim me zemër, shprehje me gojë dhe veprime me gjymtyrë dhe se ai shtohet me ibadete dhe pakësohet nga gjynahet. Për këtë parim dëshmojnë argumentet e Kuranit dhe të Sunetit. Allahu i Lartësuar thotë: **“Është Ai, që zbriti qetësi në zemrat e besimtarëve, për t’ua shtuar besimin, krahas besimit që patën”**. Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, thotë: *“Kush shikon prej jush ndonjë të keqe, le ta ndryshojë me dorë, nëse nuk mundet, le ta ndryshojë me gojë, dhe nëse nuk mundet, le ta dënojë me zemër, por ky është besimi më i dobët”*. E përcjell Muslimi. Ndikimi i ibadetit në ngritjen e besimit dhe i gjynaheve në pakësimin e besimit është i njohur, i ndjeshëm dhe i provuar. Fjala vjen, po sikur një person të ecte në treg duke shikuar femrat e zhveshura, duke dëgjuar zhurmën e njerëzve të pazarit dhe bisedat e tyre të kota e pastaj të dilte nga pazari dhe të shkonte në varreza, ku të përsiaste e t’i zbutej zemra, ai do të konstatonte një ndryshim të qartë ndërmjet dy gjendjeve. Kështu, pra zemra ndryshon me shpejtësi.

Të parët e këtij umeti thoshin: Një shenjë që tregon për mençurinë dhe diturinë e njeriut është të dijë se a i shtohet besimi apo i pakësohet dhe të dijë se nga i vijnë tundimet e shejtanit.

Ndër gjërat që duhet të vihen në dukje është fakti se në qoftë se pakësimi i besimit

shpie në moskryerjen e një detyre, ose veprimin e një harami, kjo është një ligështi e rrezikshme, për të cilën lypset teube dhe trajtim i menjëhershëm, ndërsa në qoftë se dobësimi nuk shpie në moskryerjen e ndonjë detyre, ose veprimin e ndonjë harami, por në neglizhimin e disa gjërave të pëlqyeshme, në këtë rast besimtari duhet ta mbajë veten nën kontroll dhe të bëjë përpjekje derisa të kthehet në zellshmërinë e mëparshme. Kjo që u tha bazohet në thënien e Muhamedit salallahu alejhi ue selem: *“Çdo punë ka një fazë zellshmërie dhe çdo zellshmëri pasohet nga një plogështi, por atë që nuk e nxjerr plogështia nga rruga ime, ai shpëton, ndërsa atë që e nxjerr nga rruga ime, shkatërrohet”*.

Një kohë mjaft e volitshme për përmirësimin e zemrës dhe rritjen e imanit është muaji i begatshëm i Ramazanit, pasi nga njëra anë në këtë muaj lidhen shejtanët dhe nga ana tjetër agjërimi i dobëson dëshirat e nefsit, kështu që njeriu është më i predispozuar për t’i bërë ibadet Allahut dhe e ka më të lehtë që të heqë dorë nga gjynahet. Siç u tha më lart, kryerja e ibadeteve dhe largimi nga haramet sjellin ngritjen e imanit. Në vijim do të përmend disa gjëra, të cilat ndikojnë në ngritjen e besimit, sidomos gjatë muajit të agjëritimit:

1- Të lexosh Kuranin e Madhërishëm, të cilin Allahu e ka shpallur si sqarim për çdo gjë dhe si dritë me të cilën udhëzon kë të dojë prej robërve të Tij, duke medituar mbi domethëniet e tij. Nuk ka dyshim që Kurani është ilaçi më i efektshëm për shërimin e kësaj sëmundjeje. Allahu i Lartmadhëruar thotë: **“Kurani që Ne shpallim është shërim dhe mëshirë për besimtarët”**. Mënyra e trajtimit dhe shërimit të kësaj sëmundjeje me anë të Kuranit është mendimi mbi ajetet e Kuranit dhe thellimi në to. Dihet që muaji i Ramazanit ndryshe quhet dhe muaji i Kuranit, pasi në këtë muaj është shpallur Kurani. Allahu i Lartësuar thotë: **“Muaji i**

Ramazanit është ai, në të cilin ka zbritur Kurani, që është udhërrëfyes për njerëzit, plot me shenja të qarta për rrugën e drejtë dhe dallues i së mirës nga e keqja”.

Muhamedi salallahu alejhi ue selem, gjatë muajit të Ramazanit siç përmendet në një hadith të saktë e dëgjonte të gjithë Kuranin nga Xhibrili dhe ia lexonte atij. Mbi vlerën e leximit të Kuranit Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, thotë: *“Kushdo që lexon një shkronjë nga libri i Allahut do të marrë një të mirë dhe kjo e mirë i shumëfishohet në dhjetë të mira: nuk po ju them ‘elif-lam-mim’ është një shkronjë, por elifi është një shkronjë, lami është një shkronjë dhe mimi është një shkronjë.”* E shënon Tirmidhiu. Osmani radijallahu anhu tregon se Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, ka thënë: *“Më i miri prej jush është ai që e lexon Kuranin dhe ua mëson edhe të tjerëve”.* E shënon Buhariu. Ebu Umame përcjell se Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, ka thënë: *“Lexojeni Kuranin sepse ai do të vijë si ndërmjetësues për njerëzit në botën tjetër”.* E shënon Muslimi. Në një hadith tjetër që e sjell Nevas b. Seman, Muhamedi salallahu alejhi ue selem, ka thënë: *“Do të sillet në botën tjetër Kurani dhe lexuesit e tij, të cilët e kanë vënë në zbatim. Atë ditë Kuranit do t’i paraprijë surja Bekare dhe surja Ali Imran, të cilat do të ndërmjetësojnë për ata që i kanë lexuar dhe që i kanë zbatuar”.* E shënon: Muslimi. Abdullah b. Amër b. As rrëfen se Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, ka thënë: *“Njeriut të Kuranit (lexuesit dhe zbatuesit të Kuranit) do t’i thuhet në Ditën e Gjykimit: lexo edhe ngjitu, këndoje Kuranin siç e pate kënduar në dynja, se grada jote do të arrijë deri tek ajeti i fundit që do të lexosh”.* Zemra e një njeriu që nuk lexon Kuran, pa dyshim zvetënohet, pasi Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, thotë: *“Vërtet, ai që nuk ka aspak Kuran në zemër është si shtëpia e rrënuar”.* Shumë nga

“Në zemrën e njeriut zhvillohet një betejë e ashpër mes melekut që nxit për mirë dhe shejtanit që nxit për ligësi..”

dijetarët e parë të këtij umeti e linin mësimin dhe raportimin e haditheve në këtë muaj të shenjtë dhe merreshin me leximin e Kuranit. Përderisa leximi i Kuranit në këtë muaj të begatshëm paska përparësi ndaj dëgjimit dhe transmetimit të haditheve, atëherë lënia e punëve të tjera për t’u marrë me Kuranin është më me përparësi. Qëllimi është që leximi i Kuranit gjatë kohës së lirë që disponon besimtari në këtë muaj të begatshëm është më me vlerë se ndonjë punë tjetër. Muaji i Ramazanit duhet të shërbejë në jetën e besimtarit si një muaj në të cilin kalitet, mësohet me kryerjen e ibadeteve dhe furnizohet me energji e zell për të gjithë vitin. Pikërisht kjo është ngritja e besimit dhe në këtë mënyrë del në pah edhe lidhja mes muajit të Ramazanit dhe ngritjes së imanit. Të parët e këtij umeti përgatiteshin gjashtë muaj përpara për pritjen e muajit të Ramazanit dhe gjatë gjithë kësaj kohe i luteshin Allahut, që t’ua mundësonte ta arrinin muajin e Ramazanit. Kur vinte muaji i Ramazanit e shfrytëzonin atë në maksimum, duke marrë kështu furnizim për të gjithë vitin. Pas muajit të Ramazanit i luteshin Allahut gjashtë muaj rresht, që ta pranonte prej tyre. Në këtë mënyrë ata e jetonin të gjithë vitin me muajin e Ramazanit.

Duke ngjallur interesin e njeriut që të përsiasë mbi ajetet e Kuranit, Allahu thotë: *“Kurani është një libër i bekuar, që Ne ta kemi zbritur ty (Muhamed), për të përsiatuar mbi vargjet e tij dhe për t’u këshilluar me të ata që kanë mend”.* Pejgamberi salallahu

alejhi ue selem, përsiaste mbi ajetet e Kuranit dhe i përsëriste ato duke falur namaz natën. Një natë, ai duke u falur lexoi ajetin: ***“Nëse Ti i dënon ata – robërit e Tu janë, e nëse i fal ata, me të vërtetë, vetëm Ti je i Plotfuqishëm dhe i Urtë”***, dhe vazhdoi ta përsëriste gjersa u gdhi. Kurani flet për teuhidin, premtën për mirësi, paralajmëron për ndëshkim, përmban ligje, lajme, tregime dhe norma sjellje e morali. Të gjitha këto kanë ndikim në shpirtin e njeriut.

2- Të ndjesh madhërinë e Allahut, të njohësh emrat dhe cilësitë e Allahut, si dhe të meditosh mbi ndikimet dhe gjurmët që rrjedhin nga emrat e bukur të Allahut dhe cilësitë e Tij të larta. Ajetet dhe hadithet që flasin për madhërinë e Allahut janë të shumta. Nëse muslimani mendon mbi to, do t'i zbutet zemra dhe do të përulet para më të Lartit, të Madhërishmit. Krijesat me bukurinë, shumëllojshmërinë dhe ligjësitë e tyre pasqyrojnë madhërinë, bukurinë, fuqinë dhe dijen e Allahut të Lartësuar, pasi ato janë rrjedhojë e emrave të bukur të Allahut dhe e cilësive të Tij të larta. Kështu që duke medituar mbi krijesat do të ndjesh madhështinë e Allahut dhe do ta duash Atë më fort.

3- Të kërkosht dijen fetare, sepse dija të bën t'i frikësohesh Allahut dhe ta shton besimin tek Allahu. Allahu thotë: ***“Në të vërtetë, nga robërit e Tij, Allahut i frikësohen vetëm dijetarët”***.

4- Të marrësh pjesë rregullisht në kuvendet e dhikrit.

5- Të bësh sa më shumë punë të mira dhe të përpiqesh të jesh i vazhdueshëm në to.

6- Të kesh frikë nga përfundimi i keq, të kujtosh shpesh vdekjen, të vizitosh varrezat dhe të kujtosh gjërat që do të ndodhin në Ditën e Gjykimit.

7- Të reflektosh mbi dënimet që kanë vuajtur dhe vuajnë të tjerët, si dhe nga katastrofat natyrore me të cilat Allahu i

“Një shenjë që tregon për mençurinë dhe diturinë e njeriut është të dijë se a i shtohet besimi apo i pakësohet dhe të dijë se nga i vijnë tundimet e shejtanit...”

dënon disa njerëz dhe të cilat i bën mësim për të tjerët, siç janë stuhitë, përmytjet, tërmetet, vullkanet etj.

8- Të përmendësh Allahun.

9- Të shfaqësh dhe të shprehësh nevojën që ke për Allahun, duke falur namaz dhe duke bërë lutje në sexhde.

10- Të mos ëndërrosh gjatë për kënaqësitë e kësaj bote, por të mendosh mbi pavlefshmërinë e dynjasë, në mënyrë që të mos e kesh zemrën të lidhur me të.

11- Të duash dhe të urresh për hir të Allahut.

12- Të tregosh thjeshtësi në të folur, në veprime dhe në paraqitje, pasi këto gjëra tregojnë për përluljen e zemrës ndaj Allahut.

13- Të ripërtërisht, të rigjallërosh dhe të zhvillosh punët e zemrës, si dashuria për Allahun, frika prej Tij, shpresa e të mirave të Tij, mbështetja tek Ai etj.

14- T'i kërkosht llogari nefsit rregullisht.

15- T'i lutesht Allahut që të ta ripërtërijë besimin, pasi Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, thotë: ***“Vërtet, besimi vjetrohet në brendinë e zemrës së ndonjërit prej jush ashtu siç vjetrohet rroba, andaj luteni Allahun që ta ripërtërijë besimin në zemrat tuaja”***.

Dhe më në fund, nëse nuk i shton punët e mira në Ramazan, kur do t'i shtosh!? Nëse nuk punon për ngritjen e besimit në Ramazan, kur do të punosh!? ■

GJËRA QË DUHET T'I DISH PËR AGJËRIMIN

“Çdo rob i Allahut që agjëron një ditë për hir të Allahut, për atë ditë Allahu do ta largojë fytyrën e tij nga xhehenemi shtatëdhjetë vjet

ABDULLAH B. AHMED EL-GAMIDI

Allahu, subhanehu ue teala, thotë: *“O besimtarë! Ju është urdhëruar agjërimi, ashtu si u ishte urdhëruar atyre para jush, që të mund të ruheni nga të këqijat”*. (Bekare 183).

I Dërguari, salallahu alejhi ue selem, na rrëfen se Allahu ka thënë: *“Çdo punë e birit të Ademit është për të, përveç agjërimit. Ai është për Mua dhe Unë shpërblej për të. Agjërimi është mbrojtje e kur të agjërojnë ndonjëri prej jush, le të mos bëjë punë të ndyra dhe të mos grindet. Por, nëse dikush e fyen ose dëshiron të rrihet le të thotë: Unë agjëroj, unë agjëroj. Pasha Atë, në dorën e Kujt është shpirti i Muhamedit, era e gojës së agjëruarit tek Allahu është më e mirë, sesa era e parfumit. Agjëruesi ka dy gëzime, të cilave u ngazëlleshet: Kur të hajë iftar – gëzohet për të dhe kur të takojë Zotin – gëzohet për agjërimin që ka bërë”*.¹

Resulullahu, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: *“Në xhenet ka një derë, e cila quhet Rejjan, nga ajo derë në Ditën e Kiametit do të hyjnë agjëruarit, por askush tjetër përpos tyre. Pasi të hynë ata, mbyllet ajo derë dhe nuk do të hyjë asnjëri”*.

Gjithashtu ka thënë: *“Çdo rob i Allahut që agjëron një ditë për hir të Allahut, për atë ditë*

Allahu do ta largojë fytyrën e tij nga xhehenemi shtatëdhjetë vjet”.²

Po ashtu ka thënë: *“Ai që nuk braktis fjalët dhe punët e këqija, le ta dijë se Allahu nuk ka nevojë që ky të braktisë hajen dhe pijen”*.³

Ramazani është emri i muajit të nëntë nga muajt hënorë dhe është i vetmi që është i theksuar me emrin e tij në Kur'anin Fisnik.

Urtësia e ligjërit të këtij adhurimi është ngritja dhe pastrimi i shpirtit, arritja e devotshmërisë, si dhe përgatitja për të shijuar mirësitë dhe lumturinë e ahiretit.

Rregulla të detyrueshme:

1. Përpikëria në të gjitha adhurimet veprorë ose gojorë,
2. Largimi nga të gjitha haramet veprorë ose gojorë, që shihen ose dëgjohen.

Rregulla të pëlqyeshme:

Vonimi i syfyrit, shpejtimi i iftarit, leximi i Kuranit, dhikri i shtuar, lutjet e shpeshta dhe sadakatë e shumta.

Veçoritë e Ramazanit:

1. Në këtë muaj zbriti Kurani. Allahu i Madhëruar ka thënë: **“Muaji i Ramazanit që në të zbriti Kurani...”**
2. Falja e mëkateve. I Dërguari, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: *“Kush e agjëron*

¹ Buhariu dhe Muslimi

² Buhariu dhe Muslimi

³ Buhariu

Ramazanin me besim dhe shpresë, do t'i falen mëkatet që i ka bërë më herët".⁴

3. Pranimi i lutjeve. I Dërguari, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: *"Tre personave nuk iu kthehet lutja: agjëruesit deri në iftar, udhëheqësit të drejtë dhe atij që i është bërë zullum"*.

4. Në këtë muaj është edhe Nata e Kadrit.

5. Në Ramazan prangosen shejtanët.

6. Një umre në Ramazan është e barabartë me një haxhillëk. Resulullahu, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: *"Një umre në Ramazan është sa një haxhillëk"*.⁵

Agjërimi:

Agjërimi është heqja dorë me nijet nga haja, pija, marrëdhëniet intime dhe nga çdo gjë që e prish agjërimin, nga agimi i dytë deri në perëndim të diellit.

Agjërimi është një nga Shtyllat e Islamit.

Çdo besimtar, i rritur, i mençur, i aftë dhe vendas është **i detyruar të agjërojë**.

Agjërimi i Ramazanit fillon kur e shohim hënën e re të Ramazanit, e nëse jo, kur muaji Shaban t'i ketë plotësuar tridhjetë ditë. Për këtë Resulullahu, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: *"Fillojeni agjërimin kur ta shihni hënën dhe ndërpriteni kur ta shihni. E nëse nuk mund ta shihni, atëherë plotësojeni muajin Shaban me tridhjetë ditë"*.

Çfarë i lejohe agjëruesit:

1. Përdorimi i misvakut gjatë gjithë ditës. Po ashtu edhe larja e dhëmbëve.

2. Udhëtimi për ndonjë nevojë të lejuar.

3. Flladitja me ujë për shkak të të nxehtit.

4. Mjekimi me gjëra të lejuara, sikurse gjilpërat që nuk janë ushqyese.

5. Parfumimi.

6. Lyerja e syve.

Gjërat që e prishin agjërimin:

1. Marrëdhëniet intime.

2. Haja, pija dhe gjërat e ngjashme, sikurse gjilpërat ushqyese.

3. Nxjerrja e gjakut me hixhame, e njëjta gjë vlen edhe për dhënien e gjakut.

4. Vjellja e qëllimtë.

5. Menstruacionet ose lehonja.

Përveç menstruacioneve dhe lehonisë, gjërat që e prishin agjërimin duhet të plotësojnë këto kushte:

1. Ta dijë se këto gjëra e prishin agjërimin.

2. Të mos i bëjë nga harresa.

3. Të jetë i lirë dhe jo i detyruar.

Llojet e njerëzve në agjërimit:

Së pari: Ata që në thelb nuk janë të detyruar të agjërojnë:

Lloji i parë: Jobesimtari.

Lloji i dytë: Fëmija, ky nuk e ka detyrë të agjërojë derisa të arrijë pubertetin. Mashkulli quhet se e arrin pubertetin me njërin nga këto tre elemente: dalja e spermës, qoftë në ëndërr apo ndryshe; dalja e qimeve në vendet e turpshme; dhe pasi mbush pesëmbëdhjetë vjeç. Ndërsa vajza, përveç këtyre gjërave mund të arrijë pubertetin edhe me menstruacionet e para.

Lloji i tretë: I çmenduri.

Lloji i katërt: I shtyri në moshë, saqë ka hyrë në kllapi dhe ka humbur aftësinë e dallimit të gjërave (matufosur).

Lloji i pestë: I paafti për agjërimit me një paaftësi të vazhdueshme, e cila nuk shpresohet se do të largohet, sikurse i shtyri në moshë, ose i sëmuri që nuk shpreson shërimin. Mirëpo detyrohet për çdo ditë që nuk ka agjëruar, të ushqejë një të varfër.

Së dyti: Ata që nuk janë të detyruar të agjërojnë, por të kompensojnë:

Lloji i gjashtë: Udhëtari, por me kusht të mos e bëjë këtë, që t'i shpëtojë agjërimit.

Lloji i shtatë: I sëmuri që shpreson shërimin, dhe ai ka tre gjendje:

a. të mos i vijë rëndë agjërimit dhe as që ta

⁴ Buhariu 1910

⁵ Sahihul Xhamië 4097

dëmtojë. Ky detyrohet të agjërojë.

b. të dëmtohet nga agjërimi. Në këtë rast duhet të hajë dhe nuk i lejohet të agjërojë.

c. t'i vijë rëndë agjërimi, por të mos e dëmtojë. Ky duhet të hajë.

Lloji i tetë: Ajo që është në hajz (menstruacione). Agjërimi për të është i ndaluar.

(Nëse i paraqitet hajzi gjatë ditës duke agjëruar, qoftë edhe një çast para iftarit, agjërimi i saj prishet.

Nëse pastrohet nga hajzi gjatë ditës, në pjesën e mbetur të ditës nuk duhet të agjërojë, sepse ai agjërim është i pavlefshëm.

Nëse pastrohet nga hajzi gjatë natës, qoftë edhe një çast para agimit, ajo detyrohet të agjërojë ditën që vijon.)

Edhe për lehoninë vlejné të njëjtat gjëra që u thanë për hajzin.

Lloji i nëntë: Gruaja me barrë ose ajo mëndeshë, të cilat kanë frikë për shëndetin e tyre ose të fëmijës, këto duhet të hanë.

Lloji i dhjetë: Ai që ka nevojë të hajë për të mbrojtur diçka të domosdoshme, sikurse shpëtimi i një personi që rrezikon të fundoset, të digjet etj.

Iftar

Kur agjëruesi të vërtetojë perëndimin e diellit dhe fillon të hajë këtë e quajmë iftar.

Ai duhet të shpejtojë ta hajë iftarin, sepse Resulullahu, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: *“Njerëzit do të jenë në mirësi, përderisa e shpejtojnë iftarin”*. (Buhariu dhe Muslimi).

Me çka duhet të çelë iftar?

Enesi, radijallahu anhu, ka thënë: Resulullahu, salallahu alejhi ue selem, para se të falte akshamin çelte iftarin me hurma të freskëta, nëse s'kishte atëherë me hurma të thata, e nëse s'kishte edhe nga këto, atëherë me disa glënjka ujë.⁶

⁶ Sahihu Tirmidhi 560

⁷ Sahih Ebu Davud 2066.

Duaja e iftarit:

Ibën Omeri, radijallahu anhu, rrëfen se Resulullahu, salallahu alejhi ue selem, kur çelte iftarin thoshte: *“DHEHEBE DHAMEU, UEBTELETIL URUKU, UE THEBETEL EXHRU INSHAALLAH – Kaloj etja, u lagën venet dhe u fitua shpërblimi me lejen e Zotit”*⁷

Në kohë të iftarit edhe lutjet e tjera pranohen. Resulullahu, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: *“Tre personave nuk iu kthehet lutja: agjëruesit deri në iftar...”*

Shpërblimi i atij që u jep iftare të tjerëve:

Resulullahu, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: *“Kush i jep iftar një agjëruesi, ai do të marrë edhe sa shpërblimi i atij agjëruesit, por duke mos iu pakësuar aspak shpërblimi i agjëruesit”*.

Disa hadithe që nuk janë të vërteta:

1. “Agjëroni, nëse doni të jeni të shëndoshë”⁸.

2. “Gjatë agjërit, përdorni misvakun paradite por mos e përdorni pasdite, sepse atij agjëruesi që i thahen buzët, kjo do të jetë dritë për të në Ditën e Kiametit”.

3. “Muaji i Ramazanit mbetet pezull mes qiellit dhe tokës dhe nuk pranohet tek Allahu derisa të jepet sadakatul fitri”⁹.

Teravitë

Ato janë gjallërim i netëve të Ramazanit me namaz dhe lexim të gjatë në të. Emri Teravîh në përkthim nënkupton pushimin, ndërsa ky namaz u quajt kështu, sepse ata pushonin pas çdo dy rekateve.

Ky namaz është sunet dhe i ka njëmbëdhjetë rekate, sepse Ajsha radijallahu anha, na tregon se Resulullahu, salallahu alejhi ue selem, nuk falte gjatë natës më shumë se njëmbëdhjetë rekate, pa dallim a është në Ramazan apo jashtë tij.

Por, ka dijetarë që thonë se lejohet të falen

⁸ Silsile Daife 253.

⁹ Silsile Daife 43.

edhe më shumë rekate dhe shumica e tyre mbështeten në një rast ku Omeri, radijallahu anhu, i ka tubuar besimtarët që t'i falin së bashku njëzet rekate. Por, krahas asaj se për vërtetësinë e kësaj ngjarje ka mospajtim të shkencëtarët e hadithit shtojmë edhe atë se: t'i përmbahemi Sunetit të Dërguarit, salallahu alejhi ue selem, është më e mirë dhe më e shpërblyer.

Dhjetë ditët e fundit

Aishja, radijallahu anha, na tregon se: *“kur fillonin dhjetë ditët e fundit të Ramazanit, i Dërguari, salallahu alejhi ue selem, e gjallëronte natën, zgjonte familjen dhe shtrëngonte rripin”*,¹⁰ d.m.th. nuk flinte me gratë e tij.

Syfyri

Haja dhe pija që bëjmë në fund të natës me njet agjërimi quhen syfyri.

Resulullahu, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: *“Dallimi mes agjëritit tonë dhe agjëritit të krishterëve dhe çifutëve është ngrënia e syfyrit”*.¹¹ Gjithashtu ka thënë: *“Hani syfyri, sepse ajo kohë është e begatshme”*.¹²

Agjërimet tjera të pëlqyera

1. Agjërimi i gjashtë ditëve të muajit Sheval që vijon menjëherë pas Ramazanit, për të marrë shpërblimin sikurse të kesh agjëruar tërë jetën.

2. Agjërimi i ditës së hënë dhe të enjtes, gjatë gjithë vitit, sepse ato janë dy ditë kur Allahut i shfaqen veprat e njerëzve.

3. Agjërimi i tre ditëve nga çdo muaj hënor, që kështu të fitosh shpërblimin sikur të kesh agjëruar tërë jetën. Si ashtu? Një e mirë shpërblehet me dhjetë dhe kur ti agjëron tre ditë nga çdo muaj shpërblehesh sikur të kesh agjëruar tridhjetë ditë. Më e

mira është që këto tre ditë të jenë dita e 13, 14 dhe 15 e çdo muaji hënor.

4. Agjërimi i nëntë ditëve të para të muajit Dhul Hixhe, e prej tyre dita e nëntë në veçanti d.m.th. dita e Arafatit.

5. Agjërimi në muajin Muharrem, e prej tyre dita e nëntë dhe e dhjeta në veçanti.

Kur është i ndaluar agjërimi

1. Agjërimi i “ditës së dyshimtë” d.m.th. ditës së tridhjetë të muajit Shaban.

2. Agjërimi i ditës së Bajramit, qoftë Fitër Bajrami apo Kurban Bajrami.

3. Agjërimi i tre ditëve që vijnë menjëherë pas Kurban Bajramit, d.m.th. dita 11, 12 dhe 13 nga muaji Dhul Hixhe. Një gjë e tillë i lejohet vetëm atij që është në haxhillëk dhe nuk ka pasur mjetet financiare të thërë kurban.

4. Veçimi i ditës së xhuma për ta agjëruar.

5. Agjërimi vullnetar i një gruaje, pa lejen e bashkëshortit.

Itikafi

Itikafi është një adhurim dhe është sunet. Më e mira është që kjo të bëhet gjatë Ramazanit në cilëndo xhami ku falet namazi me xhemat. Çdo mashkull apo femër mund të hyjë në itikaf, në cilëndo xhami, nëse me këtë nuk i pengon dhe as nuk i dëmton të tjerët. Ai që hyn në itikaf duhet të rrijë aty, të angazhohet me përkujtimin e Allahut dhe ibadet. Ai nuk duhet të dali nga xhamia, përveçse për nevoja fiziologjike apo për ushqim, nëse nuk ka njeri që t'ia sjellë ushqimin. Veprimi më i mirë do të ishte që të flasë sa më pak me njerëzit e tjerë dhe të angazhohet me lutje dhe adhurim, por nëse e vizitojnë shokët, nuk prish punë, sepse edhe Resulullahun, salallahu alejhi ue selem, e vizitonin gratë e tij, kur ishte në itikaf, bisedonin dhe pastaj ato shkonin në shtëpi. ■


Përshtati: Omer BERISHA

¹⁰ Buhariu 1920, Muslimi 1174

¹¹ Muslimi 1096

¹² Muslimi 1095

INTERVISTË ME DIJETARIN E MIRËNJOHUR BOTËRISHT, SHQIPTARIN SHEJH SHUAJB ARNAUTI.



“HISTORIA I NJOHU SHQIPTARËT VETËM PASI PËRQAFUAN ISLAMIN”

INTERVISTOI: OMER BERISHA

AlbIslam: Dijetar i nderuar, personaliteti juaj është i njohur ndërmjet nxënësve të dijes sidomos, ndërsa sot duam të na tregosh diçka për veten për lexuesit e revistës “AlbIslam”. Pra, çfarë mund të na thoni për babanë tuaj dhe kush ishte shkaku që ai mori rrugën drejt Shamit?

Sh. Arnauti: Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit. I gjithë lavdi dhe falënderimi i takon Allahut, ndërsa paqja, bekimi e lavdërimi qofshin mbi të Dërguarin, familjen e tij dhe shokët e tij. Babai

im, Allahu e mëshiroftë jetonte në Shkodër. Shkodra, atëbotë, kur ishte nën qeverisjen e turqve ishte kryeqyteti i Shqipërisë. Aty kishte dijetarë dhe si duket baba i shpeshtonte ndejat tek ata. Edhe pse ishte nga njerëzit e rëndomtë, ai e donte dijen dhe dijetarët. Çdoherë përpiqej të mësojë duke u bërë pyetje atyre, i pyeste ata që nëse degjenerohet ky vend, i cili është i rrethuar me njerëz jobesimtarë apo me njerëz të huaj për Islamin, cila do të ishte zgjidhja jonë? Në cilin vend do të strehoheshim dhe do të mundnim të jetojmë një jetë të mirëfilltë islame? Kështu që ata i sugjeronin dhe parapëlqenin Shamin. Kështu më rrëfente ai mua.

Prandaj ai së bashku me familjen e vet mori udhën e shpërnguljes për në Damask dhe me të ishte edhe haxhi Nuhiu, babai i shejh Albanit. U vendos atje, ndërsa unë linda pasi ai kishte ardhur në Sham, në vitin 1928, ndërsa ai ishte vendosur atje në vitin 1926.

Ai ishte një njeri i mirë dhe kishte mësuar shumë çështje të shkencës së fikhut, mirëpo nuk ishte dijetar. Dijetarët, me të cilët rrinte shpesh – më tregonte – se i thoshin: Allahu do ta bëjë ndonjërin prej fëmijëve të tu dijetar, sepse ti me të vërtetë i do dijetarët. Ai vazhdimisht ma rrëfente këtë, edhe pse – normalisht – kishte edhe shkaqe tjera që më shtynë të kërkoj dijen, por kjo ishte një nxitës goxha i madh për të realizuar dëshirën e babës tim, Allahu e mëshiroftë.

AlbIslam: Pasi shkua atje, si ju pritën arabët, duke marrë parasysh se ishit të huaj në një vend të huaj?

Sh. Arnauti: Po, gjë normale. Pritja e banorëve të Shamit ishte me të vërtetë e bukur dhe e mirë, ata na donin neve shqiptarëve sidomos, sepse ishim besimtarë të drejtë dhe kishim një ndershmëri të plotë në fe, në punë dhe në sjellje. Shumë njerëz që u shpërngulën atje nga Shqipëria, Kosova si dhe Maqedonia, ku nga Tetova kishte katër apo më shumë familje ishin të lumtur dhe ndiheshin krenarë, edhe pse ndoshta nuk zotëronin më shumë se një kafshatë bukë dhe kripë, por asnjëherë nuk zgjatën dorën e lypjes. Kështu u bindën edhe arabët, se shqiptarët janë një popull me nder dhe krenari, kënaqen me pak dhe nuk e lëshojnë rrugën, e cila të çon në mirësjelljen e njohur Islame. Kështu pra, njiheshin dhe dalloheshin. Unë e mbaj mend mirë se banorët e Shamit vërtet na donin së tepërmi, madje shumë prej tyre na çmonin edhe më shumë se bashkëkombësit e tyre.

AlbIslam: Na përmendët një prej shkaqeve pse kërkuat dijen, por a kishte edhe shkaqe të tjera që ju nxitën të kërkonit pikërisht dijen fetare?

Sh. Arnauti: Sikur të thashë, prindi im ngulte në shpirtrat tanë dëshirën për të kërkuar dijet islame, për t'u afruar tek Allahu me punë të mira. Ai zgjohej para namazit të sabahut dhe kur hynte koha e namazit na zgjonte për namaz dhe pastaj na këshillonte me fjalë, që i kishte mësuar prej dijetarëve. Ky ishte nxitësi i parë pse kërkoja dijen fetare. Por ka edhe gjëra të tjera që më nxitën të kërkoj dije. E ndieja se kërkimi i dijes do të rriste peshën time, sepse qëndrimi në vend të huaj e bën të harruar një njeri. Kur gjendesh në një vend të huaj dhe nuk të njeh asnjëri, do të jesh i parëndësishëm, por kur të mësosh, madje bëhesh dhe mësues i tyre, atëherë do të gësh respekt dhe nderim nga secili. Këto ishin prej nxitësve të përgjithshëm për të kërkuar dijen.

Ndërsa, shkaku i tretë pse kërkoja dijen është ai se që në vegjëli e doja shkencën, e doja Islamin dhe si duket, leximi i disa librave ka ndikuar tek unë, sepse aty gjeja kënaqësi shpirtërore dhe kjo më nxiste të lexoj edhe më shumë. Kam lexuar libra nga Gazaliu dhe fillova ta braktis dynjanë dhe të jem një asket, mirëpo pasi kërkoja dijen, kjo ma bëri të dashur mesataren dhe të drejtën dhe të mos anoj nga sufizmi. Po ashtu, më udhëzonin disa mësues të mirë nga hairi dhe mesatarja. Kështu edhe u formova më pas, me këtë metodologji, prandaj nëse e kundërshtoj dikë, e respektoj fillimisht dhe them fjalë të mira për të e pastaj ia bëj të qartë mendimin tim, të cilin e besoj si të vërtetë dhe i tregoj se mendimi i tij është i gabuar. Ky është shkaku pse unë s'kam armiq të lapsit, të gjithë më respektojnë.

AlbIslam: Me se po merreni tani, po ashtu a mund të na tregoni se çfarë keni realizuar nga punimet tuaja, duke filluar nga përpilimet, recensimet e të tjera?

Sh. Arnauti: Të them të drejtën, që pesëdhjetë vjet unë merrem me libra. Librin e parë që botova ishte “Musnedi i Ebu Bekër

Sidikut” i përpiluar nga Ahmed b. Seid el-Meruezi, një nga bashkëkohësit e Ahmed b. Hanbelit. Ky libër ishte një dorëshkrim i rrallë, që askush deri atëherë s’kishte punuar me të. Për mua ky ishte një provim që ma bënë disa bashkëkohës dhe këtë provim e përfundova me sukses të lartë, pas të cilit ata më nxisnin që të vazhdoj me një punë të tillë. Gjithashtu kam libra edhe në shkencën e fikut, hadithit, sikurse librat “Sherhus Sune”, “Musnedi i Imam Ahmedit”, “Sahih Ibën Hiban”, “Sherh Mushkilil Athar”, “Sijer Alami Nubela” etj., dhe që të gjitha janë voluminoze, nga 10 vëllime, nga 17, musnedi i Imam Ahmedit 50 vëllime. Pra, që prej pesëdhjetë vjetësh punoj në këtë drejtim, po edhe sot.

AlbIslam: Çfarë jeni duke punuar konkretisht në këto çaste?

Sh. Arnauti: Para se të përpunoj një libër, nuk e filloj punën përderisa të gjej dorëshkrimet më të rralla. Pastaj, i recensoj dhe i komentoj. Momentalisht i kam bërë gati për botim Sunenin e Ebu Davudit, Sunenin e Ibën Maxhes dhe librin e Tirmidhiut, ky i fundit do të jetë pesë vëllime, Suneni i Ebu Davudit tetë vëllime dhe Suneni i Ibën Maxhes do të jetë katër ose pesë vëllime. Gjithashtu kam recensuar librin “el-Ihtijar”¹ prej dy dorëshkrimeve, i kam përmirësuar aty shumë gabime, ndërsa ky libër është në plan-programin e të gjitha universiteteve. Të gjitha hadithet e këtij libri, të cilat janë 2000 të tilla, i kam nxjerr dhe adresuar në librat bazë, dhe kam shkruar një hyrje të gjatë, dhe kjo është gati për botim gjithashtu. Si dhe shumë libra tjerë.

AlbIslam: Çfarë i ka dhënë apo sa i ka shërbyer populli shqiptar Islamit dhe muslimanëve?

Sh. Arnauti: Unë fillimisht dua ta bëj të qartë se shqiptarët u bënë të njohur në histori vetëm pasi pranuan Islamin. Para Islamit, ata

“Kështu u bindën edhe arabët, se shqiptarët janë një popull me nder dhe krenari, kënaqen me pak dhe nuk e lëshojnë rrugën, e cila të çon në mirësjelljen e njohur Islame...”

nuk ishin diçka që vlenin të përmenden. Ata, vërtet banonin në këto vende, por sa për shkencë, përparim, jetesë të organizuar dhe shërbim të fesë u bënë të njohur vetëm pasi hynë në Islam. Hyrja e tyre në Islam është një ndër veprat e mira të osmanllive dhe këtë gjë dëshiroj ta theksoj këtu. Kur ata çlironin vende të ndryshme, askujt nuk i thoshin me dhunë që ta pranojnë këtë fe, përkundrazi u linin si mundësi që të pranojnë Fenë Islame, ose të mbesin në fenë që kishin. Prandaj shumica e shqiptarëve e përqafuan këtë Fe dhe vetëm një pakicë vazhdoi në fenë që kishte. Ky fakt është argument se nuk pati asnjë dhunë që shqiptarët medoemos të hynin në Fenë Islame. Ata e pranuan Islamin me kënaqësi dhe besim, prandaj një numër i madh prej tyre arriti të fitojë poste të larta në shtetin osman. Mjafton të përmendim se kishte mbi tridhjetë **sadriazema** (kryeministra), me post menjëherë pas sulltanit, shqiptarë. Prej tyre ishte familja e **Qypriive**, të gjithë ata e pranuan Islamin dhe i shërbyen Islamit. Nga familja e tyre pati shumë njerëz të mëdhenj, komandantë, dijetarë... prandaj sulltan Abdulhamidi shërbehej vazhdimisht me ta dhe kërkonte ndihmën e tyre.

Unë kërkoj nga shqiptarët që të kthehen në krenarinë e mëparshme, le të kujtojnë se ata kishin fuqi vendimmarrëse në shtetin osman. Nuk dua prej tyre që të zgjedhin punët e ulëta, nuk dua që ata të shkojnë në Zvicër, Itali etj., dhe të angazhohen me

¹ Ky është një libër i hadithit që përmban fikhun e medhhebit hanefij.

ndërtesa dhe ndërtime dhe gjithçka tjetër. Dua që të mësojnë dhe të arsimohen, që të bëhen zotërinj dhe pastaj të kenë poste të larta në vendin ku jetojnë.

Gjithashtu, dua që të kthehen tek Allahu, sepse nuk mundemi të fitojmë në dynja dhe as në ahiret, nëse nuk e kemi frikë Allahun. Pra, t'i besojmë këtij dini dhe le t'i nënshtrohemi ligjeve të tij. Dua që një shqiptar të jetë musliman i vërtetë dhe t'i dojë të gjithë muslimanët që jetojnë në lindje e perëndim.

AlbIslam: Si do ta kishit vlerësuar punën që bëjnë shqiptarët e sotshëm në vendet e tyre?

Sh. Arnauti: Unë vërej një zgjim të mirë në përgjithësi, qoftë në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni apo Mal të Zi. Shoh se shumë nga nxënësit e dijes e njohin mirë Sheriatin Islam, kanë krijuar pozitën e tyre dhe janë duke shkuar drejt hairit. Ndoshta ngadalë, por do të kenë një ndikim të lëndueshëm në të ardhmen. E lus Allahun që t'i kthehen krenarisë së mëparshme, kur mbronin Islamin nga nëpërkëmbja e të këqijve.

Dua prej rinisë Islame, që ta paraqesin Islamin të bukur dhe të lehtë ashtu si është, me fjalë të mira dhe butësi. Nuk kemi nevojë për grindje, vrasje dhe dëmtim. Metodologjia e bukur është rrugë që duhet ndjekur. Allahu na ka mësuar në Kuran: ***"Thirr në rrugën e Zotit tënd me urtësi dhe këshillë të bukur dhe debato me ta në mënyrën më të mirë"***. ***"Shkoni ju të dy (Musa dhe Harun) te faraoni dhe i thoni atij fjalë të buta, ndoshta do të kujtohet dhe do të ketë frikë"***. Djaloshi shqiptar duhet të pajiset me dije dhe njohuri dhe t'i përdorë këto gjëra për t'i bindur njerëzit në Islam. Ai ka për detyrë të jetë i stolisur me mirësjelljen islame, gjë e cila do t'ia bënte të dashur Islamin të tjerëve, duke parë ata sjelljen dhe veprat e mira të këtij besimtari. Allahu ju dhëntë sukses.

AlbIslam: Para se t'ju falënderoj për këto fjalë të mira, dëshiroj që në këto ditë, kur jemi

duke e pritur Ramazanin, të na jepni një këshillë për të.

Sh. Arnauti: Në Islam e kemi të qartë se ka dallime midis njerëzve, vendeve dhe kohëve. P.sh., zotëria ynë, Muhamedi, salallahu alejhi ue selem, është krijesa më e mirë – kjo sa i përket njerëzve. Ndërsa midis kohëve, e dimë se muaji i Ramazanit nuk është si muajt e tjerë. Zoti e ka theksuar se në këtë muaj të bekuar ka zbritur Kurani. Për këtë muaj, Resulullahu, salallahu alejhi ue selem, ka thënë tre hadithe, dhe që të gjitha janë të vërteta: ***"Kush punon gjatë Ramazanit me besim dhe shpresë, do t'i falen mëkatet që ka bërë"***, ***"Kush e agjëron Ramazanin me besim dhe shpresë, do t'i falen mëkatet që ka bërë"***, ***"Kush gjallëron natën e Kadrit me besim dhe shpresë, do t'i falen mëkatet që ka bërë"***.

Ky është një nder i madh, pra, nëse njeriu dëshiron ta pastrojë veten nga mëkatet, le ta mirëpresë këtë muaj me një mikpritje të dalluar dhe le ta mbushë atë me adhurime dhe punë të mira në përgjithësi.

Elhamdu lillah, tani edhe mjetet janë bërë të mundshme, që njeriu të shpenzojë një kohë të gjatë me Allahun dhe me ata hoxhallarë, që e shpjegojnë Fenë kudo. Sidomos nëpër media dhe unë dua që njerëzit të shikojnë ato emisione ku shpjegohet Feja, sepse aty ka dobi. Gjithashtu, le të lexojnë Kuranin, le të japin sadaka dhe le t'i nderojnë njerëzit. Muaji i Ramazanit është muaj i sezonit ku mund të furnizohet dhe me lejen e Allahut kjo do të jetë zahireja e tij për të tërë vitin.

E lus Allahun që të na japi sukses të gjithë muslimanëve dhe t'i ndihmojë që të bashkohen dhe ta adhurojnë Allahun siç e meriton. Besimtari edhe jashtë Ramazanit duhet të vazhdojë me adhurimet, me abstenimin e tij prej mëkateve dhe nuk lejohet që pas Ramazanit të kthehet në gjendje tjetër.

AlbIslam: Allahu ju shpërbleftë me çdo të mirë në dynja dhe ahiret. ■

ZONJA E KUZHINËS NË RAMAZAN

Përgatitja e ushqimit në çastet e hershme të mëngjesit është më mirë, sesa përgatitja e ushqimit në mesditë. Një numër i madh grash e përgatisin ushqimin në kohën e mesditës, apo në kohën e namazit të drekës, apo të ikindisë

UMU LEJTH

Oj zonja e shtëpisë, hapi veshët e tu dhe më dëgjo:

E di fort mirë se do të mundohesh shumë gjatë përgatitjes së ushqimit, që të shihet zotësia jote në shumëllojshmërinë e ushqimeve, mos u fajëso për këtë, sepse kjo është nga natyra e pastër, e cila është pjesë e natyrës femërore.

Mirëpo mjerë për ty, nëse e bën këtë gjë të jetë qëllimi yt kryesor, por ngrije qëllimin, le të jetë qëllimi yt më i lartë dhe më i ngritur, a e di ti se ai që i jep ushqim një agjëruesi, atij i takon shpërblimi duke mos iu pakësuar nga shpërblimi i agjëruesit aspak, atëherë le të jetë ky qëllimi yt dhe llogarite kohën që e kalon gjatë përgatitjes së ushqimit, për Allahun, se do të shpërblehesh.

Për ty kam një program të mrekullueshëm:

1- Fillon para fjetjes: të thuash Subhannallah 33 herë, elhamdulilah 33 herë, Allahu Ekber 34 herë, sikurse ka ardhur në Sahihët e Buhari dhe të

Muslimit, se Fatimeja –Allahu qoftë i kënaqur me te- ka shkuar tek i Dërguari –paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të- për të kërkuar një shërbëtor. Ai i tha: *A të tregoj për një gjë që është më e mirë se kjo, ta lartësosh Allahun (Subhanallah) para fjetjes tridhjetë e tre herë, ta falënderosh (Elhamdulilah) tridhjetë e tre herë dhe ta madhërosh (Allahu Ekber) tridhjetë e katër herë.* Nga ky hadith përfitojmë se ai që e thotë këtë para fjetjes do të ketë forcë për punë gjatë ditës.

2- **Syfyri:** është i bereqetshëm, ki kujdes të mos tregohesh e pakujdesshme për te, sepse na përcillet nga i Dërguari –paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të- të ketë thënë: *“Bëni syfyr, sepse në të ka bereqet”* gjithashtu edhe në Musnedin e Imam Ahmedit nga i Dërguari –paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të: *“Me të vërtetë Allahu i Lartësuar dhe melekët e Tij i bekojnë ata që ngrihen në syfyr.”*

3- Falja e namazit të sabahut në kohën e tij.

4- Ndenja në xhami deri në kohën pasi është ngritur dielli mirë- duke lexuar Kuran, duke e lartësuar dhe përmendur



Allahun... pastaj fal më së paku dy rekate namaz... ka thënë i Dërguari –paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të-: *“Kush e fal namazin e sabahut me xhemat, pastaj ulet dhe e përmend Allahun deri sa të lindi dielli, pastaj i fal dy rekate, e ka shpërblimin e haxhit dhe umres të plotë, të plotë, të plotë.”* E përcjell Taberaniu.

5- Përgatitja e ushqimit në çastet e hershme të mëngjesit është më mirë, sesa përgatitja e ushqimit në mesditë. Një numër i madh grash e përgatisin ushqimin në kohën e mesditës, apo në kohën e namazit të drekës, apo të ikindisë. Kjo gjë sjell, ose nuk e fal namazin në kohë, ose i bashkon të dy namazet, dhe kur i fal ato e ke mendjen të preokupuar me përgatitjen e ushqimit, e fal namazin pa frikërespektin e duhur, sunetet i le pas dore për kohën e shkurtër që të ka mbetur. Dhe e kundërta ndodh, në qoftë se

“Mos qëndro shumë në përgatitjen e ushqimit, sepse Ramazani është muaji i agjërit e jo i ushqimit...”

do ta fillosh punën herët në mëngjes, ti do të kesh kohë më shumë dhe në namazin tënd me lejen e Allahut nuk do të kesh ngatërresat e përgatitjes së ushqimit.

6- Të porosis që të kotesh para dreke: më e sakta është pak para namazit të drekës, që të pushosh pak e të mbledhësh forcat.

7-Ta falësh namazin në kohën e tij dhe mos i harro namazet vullnetare.

8-Elhamdulillah e kompletton ushqimin herët dhe çastet e fundit kanë mbetur për ta zbukuruar tryezën, si dhe sahanët para

ushqimit. Mos harro ta ndërrosh veshjen tënde para rregullimit të tryezës, sepse ti ke më të drejtë për t'u zbukuruar, veçanërisht nëse je e martuar dhe ki kujdes të mos i afrosh me erën e qepës, hudhrës dhe yndyrës...

Sikurse edhe e përmenda më sipër të mundohesh me përgatitjen e ushqimit paradite të ndihmon në fitimin e kohës shtesë, e mos e neglizho veten.

9-Kur të thirret ezani mos harro të thuash duanë: "Kaloj etja, u lagën venat dhe u realizua shpërblimi insha-Allah." (Suneni i Ebu Davudit)

10- Mos harro të fillosh me atë që ka filluar i Dërguari ynë -salallahu alejhi ue selem- sepse ai është shëmbëlltyra jonë, e ai bënte iftar me hurma të njoma, e nëse nuk kishte të njoma atëherë me hurma të thata, e nëse nuk i kishte as këto, atëherë me pak ujë.

11- Fale namazin e akshamit në kohën e tij dhe mos e harro sunetin e tij.

12- Pastaj namazin e jaxisë dhe teravitë.

13- Nëse ke mundësi të lexosh Kuran natën, mashaAllah, por nëse je e lodhur dhe nuk ke mundësi të lexosh shumë, atëherë lexo më së paku një xhuz dhe bjer të flesh, sepse edhe trupi yt ka hak.

Disa porosi të veçanta për ty, motra ime:

1- Mos qëndro shumë në përgatitjen e ushqimit, sepse Ramazani është muaji i agjërimit e jo i ushqimit.

2- Ki kujdes e mos e tepro me ushqim e pije, sepse jemi ndaluar nga kjo, Allahu i Madhëruar në suren Araf thotë: **"Hani e pini dhe mos e teproni."**

3- Le të ketë në gatimet e tua ushqim të shëndetshëm, sepse kjo e ndihmon njeriun në kryerjen e ibadeteve.

4- Nuk prish punë nëse e shijon ushqimin duke qenë agjëruese për ndonjë

nevojë, mirëpo mos gëlltit asgjë prej tij, kështu nuk e prish agjërimin nëse e provon.

5- Të kesh si nijet gjatë përgatitjes së ushqimit hadithin: *"Kush i jep iftar një agjëruesi e ka shpërblimin e atij agjëruesi, duke mos iu pakësuar asgjë nga shpërblimi i tij."* Tirmidhiu dhe të tjerët.

6- Shpeshtojë përmendjen e Allahut, Lartësimin e Tij dhe kërkimin e faljes gjatë përgatitjes së ushqimit, që gjuha jote ta përmendi vazhdimisht Allahun.

7- Dëgjo Kuran dhe ligjëratat nëpërmjet radios.

8- Pakëso shpenzimin e të hollave, bëhu kursimtare në shpenzimin e pasurisë.

9- Përpiqu që të përgatisësh lloje të ndryshme ushqimesh e pijesh dhe largohu nga të përsëriturit një pas një.

10- Përmbaju leximit të Kuranit çdo ditë, veçanërisht natën, sepse Ramazani është muaji i Kuranit.

11- Ftoji fqinjët të hanë; i Dërguari -paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të- ka thënë: *"Nuk është besimtar ai që e ngop veten, kurse fqinji i vet është i uritur."* Buhariu në librin e tij El-Edeb.

12- Jepu ushqim të ngratëve, jetimëve dhe udhëtarëve.

13- Nxit familjen dhe bamirësit.

14- Mbaji lidhjet farefisnore dhe do të kishte qenë mirë, që kur të shkosh për vizitë të marrësh me vete diçka që e ke përgatitur vetë, ose t'i ndihmosh ato në përgatitjen e ushqimit.

15- Thirr në rrugën e Allahut, të afrosh tek Allahu në këtë muaj madhështor me thirrjen e të afërmve, fqinjëve, dashamirëve nëpërmjet librave, apo kasetave, këshillave apo udhëzimeve... i Dërguari -paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të- ka thënë: *"Kush udhëzon në të mirë e ka*

shpërblimin e vepruesit...” Muslimi.

16- Ki kujdes nga ndejat e kota, ruaje gjuhën tënde nga gibeti, mbartja e fjalëve, thëniet e fëlliqura, dhe ruaje veten me thënie të mira e të bukura dhe të jesh e lidhur me përmendjen e Allahut.

17- Shpeshtoj dhënien e sadakasë, i Dërguari –paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të- ka thënë: *“Shtatë njerëz do t’i strehojë Allahu nën hijen e Tij, atë ditë kur nuk do të ketë hije tjetër pos hijes së Tij...”* prej tyre ka përmendur: *“një njeri, i cili ka dhënë sadaka dhe e ka fshehur, saqë nuk e di dora e majtë çfarë jep e djathta.”* Mutefekun alejhi. Po ashtu ka thënë: *“O ju gra jepni sadaka, kërkonin falje shumë, sepse unë ju kam parë se jeni prej shumicës së banorëve të xhehenemit.”* Muslimi.

18- Garo në punë mira, përpiku që të mos ta kalojë kush në këtë, Allahu i Lartësuar thotë: ***“E për një shpërblim të tillë le të garojnë ata që lakmojnë të mirën.”*** Në punë të hairit dhe të mira, sepse xheneti është me grada.

19- Bëhu bujare, në Dy Sahihët nga Ibën Abasi –Allahu qoftë i kënaqur me te – përcillet se ka thënë: *“I Dërguari –paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të- ishte njeriu më bujar, edhe më bujar ishte në muajin e Ramazanit, kur e takonte melekun Xhibril, e Xhibrili –alejhi selam- e takonte çdo natë në Ramazan dhe ia mësonte Kuranin e i Dërguari i Allahut, kur e takonte Xhibrilin ishte edhe më bujar sesa era e fortë”.*

20- Shpejto në iftar menjëherë pas përdimit të diellit, sepse në hadithin e Sehël b. Sadit nga i Dërguari – salallahu alejhi ue selem- thuhet: *“Njerëzit do të jenë në hair ërderisa shpejtojnë për të bërë iftar dhe e vonojnë syfyryn.”* E përcjell Buhariu dhe Muslimi.

21- Gjatë iftarit mos harro duanë, sepse

i Dërguari ka thënë –paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të-: *“Tre lutje janë të pranuara, lutja e agjëruesit, lutja e atij që i është bërë padrejtësi dhe lutja e udhëtarit.”*

22- Mos haj shumë, se e rëndon trupin dhe e dembelos për adhurimet, si namazi i teravisë dhe namazi i natës.

23- Zgjohe natën, se Ramazani është muaj i ibadetit, i Dërguari –paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të- ka thënë: *“Kush bën ibadet në Ramazan me besim dhe shpresë do t’i falen gjynahet e mëparshme.”* Mutefekun alejhi.

24- Mos fle shumë, se Ramazani është një muaj dhe kalon, kurse ai që fle shumë është humbës i kohës së tij... dhe kujto se thirrësi do të thërrasë: *“O lakmues i së mirës prano dhe o lakmues i së keqes shmangu.”*

E lus Allahu e Madhëruar, Zotin e Arshit Fisnik, që të na e pranojë agjërimit tonë, ibadetet tona dhe veprat e mira, të na bëjë prej atyre që janë të mbrojtur nga zjarri, e mos të na bëjë këtë vit, takimin e fundit me muajin e Ramazanit. O Allah pranoje.

Lutja jonë e fundit është falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve.

I Lartësuar je ti, o Allah, falënderimi të takon Ty, nuk ka të adhuruar që meriton të adhurohet pos Teje, kërkoj falje nga Ti dhe tek Ti pendothem.

Nëna e nevojshme për faljen e Zotit të saj, Umu Lejthi ■

Përktheu: Shpend ZENELI

AGJËRIMI I FËMIJËVE MIDIS PROVËS DHE VAZHDIMËSISË



Disa nëna mund të ndihen të shqetësuara në lidhje me shëndetin e fëmijëve të tyre, të cilët këmbëngulin në vazhdimin e agjërimit. Por a ndikon agjërimi negativisht në shëndetin e fëmijës?

FEUZIJE SALIH

Inkurajim dhe imitim

Ja Ramazani që valëvit krahët e tij në mesin tonë. Por, a i ke ofruar fëmijëve të ty qoftë edhe një pjesëz të vogël nga begatia e këtij muaji të madhëruar? Sa fëmijë të vegjël ke stërvitur për agjërim? Dhe sa prej tyre kanë agjëruar? Sa prej tyre ua ke mësuar veçoritë e këtij muaji për t'i nxitur ata, që të mësohen me detyrimet fetare, që kur të rriten kjo të jetë kthyer në një pjesë të jetës së tyre?! Bashkimi i familjes muslimane rreth tryezës nxit shumë fëmijë që të agjërojnë me dëshirën për ta provuar, ose me dëshirën për të imituar të mëdhenjtë, ose për të treguar se janë rritur tashmë. Ky studim hedh dritë mbi përvojën e agjërimit nga fëmijët.

Në fillim kaluam disa çaste me disa nxënëse, duke diskutuar rreth shkaqeve që i nxitën ato për të provuar agjërimin. Lemisa, Sara, Abiri, Anudi dhe Meha janë disa nxënëse në klasën e pestë, që e kanë filluar agjërimin që në moshën 8 vjeçare, të nxitura nga familja e tyre. Mamatë e tyre përdorën mënyra të ndryshme për t'i joshur dhe për t'i inkurajuar, që të agjëronin dhe prova e tyre filloi me agjërimin e tri ditëve në javë, pastaj katër e kështu me radhë, derisa plotësuan një javë të tërë në fund të Muajit të Madhërueshëm. Vitin tjetër, ato e vazhduan agjërimin e tyre të gjithë javën, pa ndjerë lodhje apo ndonjë shqetësim.

Ndërsa Nura, Rimi, Hejfa dhe Selma, që mësojnë në klasën e katërt, na bënë me



dije se ato e ndërmorën provën e agjërimit, me qëllim që të imitojnë të mëdhenjtë në familje. Ato e filluan agjërimit në klasën e dytë dhe fillimi i tyre u bë i përshkallëzuar. Ato filluan me agjërimitin e një gjysmë dite dhe e përfunduan me një javë të vetme nga muaji i Ramazanit. Prova u përsërit sërish vitin tjetër dhe ato e vazhduan agjërimitin gjatë gjithë muajit në vazhdimësi, pa ndjerë lodhje, edhe pse shkonin në shkollë çdo ditë dhe kryenin detyrat shkollore me regjim të plotë. Ato na siguruan se rezultatet e tyre ishin më të mira gjatë muajit të Ramazanit.

Nënat luajnë një rol të rëndësishëm

Shpejtua për të mësuar rreth pozitës së familjes dhe rolit të saj në agjërimitin e fëmijëve. Kështu, u takuam me nënën e Zijadit, Muhamedit dhe Fehdit, të cilat më

“...duhet që familja ta inkurajojë dhe ta kontrollojë ushqimin e tij, sidomos vaktin e syfyrit, i cili duhet të përmbajë sasi të mjaftueshme sheqernash...”

treguan për frikën e tyre në fillimet e provës së agjërimit të vajzave të tyre në një moshë të njomë, sidomos kur Ramazani vjen në sezonin shkollor, gjë e cila mund të ndikojë në të kuptuarin e mësimave. Në fillim ato u përpoqën që t'i ndalonin vajzat e tyre që të agjëronin, por nuk arritën ta bënë një gjë tillë. Ato u tërhoqën para këmbënguljes së vajzave të

tyre dhe ato e filluan provën e tyre, nën kontrollin e përditshëm të nënave të tyre. Kështu, ato arritën që të kalonin shqetësimin dhe lodhjen që buronte nga agjërimi, duke e plotësuar atë. Kjo rezultoi një përpjekje e suksesshme.

Ndryshe nga qëndrimi i nënave të mëparshme, pozicioni i nënës së Fejsalit, Sulltanit dhe Halidit ishte inkurajimi i vajzave të tyre me çdo formë dhe nxitja e tyre për të agjëruar dhe të mësuarit me të që në moshë të vogël. Ato pohuan faktin se kjo është një detyrë e të gjitha nënave muslimane, që kanë si objektiv rritjen e vajzave të tyre me parimet dhe vlerat islame që në vogëli, me qëllim që ato të kuptojnë se si t'i kryejnë detyrimet e tyre në mënyrën më të mirë. Ato na treguan se inkurajimi dhe kujdesi i tyre ishte më se i mjaftueshëm që vajzat e tyre të kalonin me sukses provën e agjëritimit.

Shëndeti i fëmijës agjërues

Disa nëna mund të ndihen të shqetësuara në lidhje me shëndetin e fëmijëve të tyre, të cilët këmbëngulin në vazhdimin e agjëritimit. Por a ndikon agjërimi negativisht në shëndetin e fëmijës? A ka mundësi fëmija që ta përballojë agjërimin?

Mjeku Abdulla Ali Es-Sejid, specialist i fëmijëve në Spitalin Universitar të Mbretit Fehd, jep këtë përgjigje dhe thotë: “Fëmijët nën moshën 12 vjeçare nuk janë në gjendje që të përballojnë agjërimin ashtu siç e përballon një njeri i pjekur, por nëse struktura e tyre trupore është e fortë dhe formimi fizik ua jep këtë mundësi, atëherë ata mund të nxiten që të agjërojnë në mënyrë të përshtatshme, në mënyrë që të mos i drejtohen mashtrimit me justifikimin se mund ta vërtetojnë më së miri përballimin e

agjëritimit, duke e privuar vetveten nga të ngrënët dhe të pirët vetëm para njerëzve. Si rrjedhojë, nuk ka asnjë dëm nëse fëmija agjëron për aq kohë sa gëzon shëndet të plotë, por lind si detyrë e prindërve që t'i kontrollojnë vazhdimisht ata.” Mjeku bën me dije se agjërimi ul nivelin e sheqernave në trup dhe fëmija ka nevojë për më shumë sheqerna, sepse lëvizjet e tij janë më të shumta se një njeri i rritur. Kështu, agjërimi bën që fëmija të humbë më shumë sheqerna, duke shkaktuar ndjesinë e lodhjes dhe këputjes.

Vihet re edhe diçka tjetër. Fëmija nuk arrin t'i konceptojë të gjitha urtësitë që lidhen me agjërimin, siç është përlllogaritja e kohës së agjëritimit dhe marrja e ushqimeve të nevojshme për trupin. Njeriu i pjekur ushqehet me gjithçka ka nevojë trupi, ndërsa fëmija ha më pak seç i nevojitet, mungesë e cila shkaktën lodhjen e tij, por nëse ekziston kontrolli nga familja dhe vëzhgimi për llojet e ushqimeve që do të konsumojë, fëmija i ka të gjitha mundësitë që të vazhdojë agjërimin pa asnjë shqetësim apo komplikacion. Nëse fëmija ndjek me rigorozitet të gjitha këshillat mjekësore në lidhje me agjërimin dhe konsumon aq ushqim sa i nevojitet, ai do të përfitojë nga agjërimi ashtu si të rriturit në aspektin e përballimit të vështirësive dhe durimit.

Mjeku Abdullah shton se ka fëmijë që vuajnë nga sëmundje të ndryshme dhe kjo kategori nuk duhet t'i futet një prove agjërimi në mënyrë absolute, sepse ndikimi i agjëritimit mbi ta do të jetë realisht i rrezikshëm. Një kategori e tillë janë ata fëmijë që vuajnë nga funksionet e veshkave apo nga anemia e dukshme. Këtyre nëse i mungojnë lëngjet në trupin e tyre do të ekspozohen ndaj një sulmi dhembjesh në nyjat e kockave. Po kështu edhe fëmijët që vuajnë nga diabeti.

Udhëzime mjekësore

Nëse fëmija arrin ta kalojë një provë me shëndet të plotë, që i jep mundësinë të vazhdojë agjërimin, duhet që familja ta inkurajojë dhe ta kontrollojë ushqimin e tij, sidomos vaktin e syfyrit, i cili duhet të përmbajë sasi të mjaftueshme sheqernash, të cilat e furnizojnë trupin me energji të mjaftueshme për aktivitetin e tij arsimor gjatë ditës, në mënyrë që të mos ndjejë lodhje. Nëse fëmija merr sasinë e nevojshme të ushqimit, të shplodhjes dhe bie të flejë herët, i ka të gjitha mundësitë që ta vazhdojë agjërimin pa u ballafaquar me asnjë problem shëndetësor.

Mosha e përshtatshme për agjërimin e fëmijës

Dijetari Abdul Aziz bin Baz – Allahu e mëshiroftë –rreth agjërit të fëmijës thotë: “Djemtë dhe vajzat, nëse mbushin moshën shtatë vjeçare urdhërohen që të agjërojnë, me qëllim që të mësohen dhe lind si detyrë e prindërve të tyre që t’i urdhërojnë për këtë ashtu siç i urdhërojnë për faljen e namazit dhe nëse arrijnë moshën e pubertetit, agjërimi është i detyrueshëm për ta.” Ndërsa mjekja Fatime El-Xharullah, profesoreshe asistente në Fakultetin e Sheriatit në Universitetin Islamik të Imam Muhamed b. Saudit bën me dije se mbushja e moshës së pubertetit është domosdoshme për detyrimin e agjërit. Si rrjedhojë, agjërimi sipas mendimit më të saktë, nuk është i detyrueshëm për fëmijët, me argument fjalën e Profetit salallahu alejhi ue selem që thotë: *“Lapsi nuk shkruan për tri grupe: Për të fjeturin derisa të zgjohet, për fëmijën derisa të piquet dhe për të çmendurin derisa të arsyetojë”*, edhe pse ai është një adhurim trupor dhe nuk është


i detyrueshëm për fëmijën, ashtu si Haxhillëku.

Përcillet nga Abdurrahman b. Ebi Lejla në një hadith mursal, se i Dërguari i Allahut salallahu alejhi ue selem ka thënë: *“Nëse fëmija përballon agjërimin e tri ditëve, e ka për detyrë të agjërojë muajin e Ramazanit.”*

Është detyrë e prindërve (ose kujdestarëve) të fëmijës që ta urdhërojnë atë të agjërojë, nëse arrin ta përballojë dhe ta godasin që të mësohet, ashtu si namazi. Kjo ishte metodologjia e sahabeve –Allahu qoftë i kënaqur me ta, siç përcillet në Sahihun e Muslimit 2/1136, faqja 799, nga Halid b. Dhukrani, i cili thotë: “Pyeta Rabian, vajzën e Muauedhit rreth agjërit të ashurasë dhe tha: “I Dërguari i Allahut çoi të dërguarit e tij nëpër fshatrat e Ensarëve...” dhe pasi përmendi hadithin tha: “Fëmijëve u punonim lojëra prej leshi dhe shkonim, e nëse na kërkonin ushqim, u jepnim lojën që t’i hutonte derisa të plotësonin agjërimin e tyre.”

Kështu, prova e agjërit të fëmijës mund të vazhdojë me sukses pa lënë gjurmë negative për të, në rast se sigurohet kujdesi i mjaftueshëm nga familja për fëmijën, për ruajtjen, nxitjen dhe ndjekjen e detyrave të tij me metoda mjekësore, të cilat i japin mundësi të shplodhet dhe të flejë mjaftueshëm, derisa të arrijë të ndjekë nxënien me efikasitet dhe të përballojë vështirësitë njëkohësisht, duke u shndërruar në një njeri të durueshëm dhe të fortë. ■

Përktheu: Genc PLUMBI



VLERA E NAMAZIT TË NATËS

Besimtarit në muajin e Ramazanit i mbliiden dy xhihade të trupit: e para: xhihadi gjatë ditës me agjërim, e dyta: xhihadi natën me namaz nate — teravi, tek ai njeri që mbliiden këto dy xhihade do të ketë shpërblim që nuk mund të llogaritet.

PËRGATITI: BASHKIM BAJRAMI

Falënderimi i takon Allahut që e bëri namazin pushim për besimtarët, përshëndetjet qofshin mbi të dërguarin, mësuesin e njerëzimit, Muhamedin salaAllahu alejhi ue selem.

Allahu i Madhërishëm e zbriti mesazhin hyjnor si lidhjen e vetme tokë-qiell për të gjithë njerëzimin, ndërsa namazin e natës e bëri lumturi të vazhdueshme të njerëzve të mirë, tregti të besimtarëve të devotshëm, të cilët natën vetmohen me Zotin e tyre, i drejtohen krijuesit të tyre, i paraqesin ankesat dhe kërkojnë prej mirësisë së Tij, shpirtrat (trupat) e tyre qëndrojnë para Krijuesit të gjithësisë, kërkojnë mëshirën e Tij dhe shpëtimin nga zjarri i xhehenemit. Allahu i Lartmadhëruar thotë në librin e Tij

fisnik: *“Ata ishin të cilët flinin pak natën. Dhe ne syfyr (nga mbarimi i natës) ata kërkonin falje për mëkatet.”* Dharijat 17-18.

Hasan Basriu thotë: Janë për qëllim ata që qëndrojnë natën dhe e zgjasin namazin deri në syfyr, pastaj ulen bëjnë dua dhe kërkojnë falje. Të njëjtin mendim e mbështet edhe Taberiu.

Muhamed b. Nasr el-Merueziu Allahu e mëshiroftë na përcjell e ky nga Enesi, se ky ajet ka zbritur për ata që janë falur mes akshamit dhe jacisë. Sahabët që falnin namaz mes akshamit dhe jacisë ishin: Ibën Mesudi, Ibën Amri, Selman Farisiu, Ibën Omeri etj.

Ndërsa Ibën Xheriri thotë: Allahu i ka lavdëruar dhe e ka cilësuar punën e tyre të palodhshme, duke mos fjetur dhe duke u afruar tek Allahu dhe që ishte i kënaqur me veprën e tyre. Katadja dhe Muxhahidi e komentojnë këtë ajet, duke thënë se kjo do të

thotë se gjatë gjithë natës deri në agim nuk flinin, por e kalonin në ibadet.

Ibën Abasi në lidhje me këtë ka thënë: “U kalonte gjithë nata, duke mos i mbyllur sytë fare”.

Imam Buhariu në kapitullin “Mbi veçoritë e namazit të natës” thekson zinxhirin e transmetuesve të hadithit, në fund të cilit ndodhet Abdullah b. Omeri, e ku thuhet: *“Gjatë kohës së Pejgamberit salallahu alejhi ue selem ishte një njeri, i cili sa herë që shikonte një ëndërr, ia tregonte Pejgamberit të Allahut, ndaj dhe unë kisha dëshirë që të shihja ëndrra dhe t’ia tregoja Pejgamberit të Allahut. Një herë në kohën e Pejgamberit kur isha fëmijë m’u shfaqën në ëndërr dy engjëj, të cilët më dërguan afër zjarrit, i cili m’u duk sikur ishte i murosur si një pus dhe se kishte dy shtylla. Në të pashtë disa njerëz që i njihja më para, ndaj në moment fillova të them: ‘I mbështetem Allahut nga zjarri’, ndërsa një engjëll më tha “Mos u trishto”. Ëndrrën ia tregova Hafses, kurse Hafsa ia tregoi Pejgamberit, salallahu alejhi ue selem, që i tha: ‘Sa njeri i mirë është Abdullahu, vetëm sikur të ngrihet natën e të falet’. Pas këtyre fjalëve ai flinte vetëm një pjesë të shkurtër të natës.*

Ebu Hurejra radiaAllahu anhu na përcjell, se i Dërguari i Allahut ka thënë: *“Agjërimi më i vlefshëm pas Ramazanit është agjërimi i muajit të Allahut, Muharrem, ndërsa namazi më i vlefshëm pas farzeve është namazi i natës”.* Muslimi

Namazi i natës tek gjeneratat e para

Një njeri i ka thënë Ibrahim Ed’hemit se nuk kam mundësi të fal namaz nate, më trego ilačin që të kem mundësi të falem. Ai iu përgjigj: Mos bëj gjynah ditën, që të kesh mundësi të ngrihesh natën, sepse namazi i natës ka vlerë tek Allahu e Allahu nuk ia jep këtë vlerë mëkatarit.

Një nga njerëzit e devotshëm, Hasan b.

“Shumë gjatë, o baba, kur pushon?” Ai iu përgjigj kësh-tu: e ngriti dorën lart pastaj e vendosi në kofshë e tha: “Kur të hyjë kjo në xhenet, atëherë do të pushoj” ...”

Salih e shiti robëreshën e tij tek një person. Kur erdhi nata ajo i thërriti anëtarët e familjes të zotërisë së ri: “namazi i natës, namazi i natës”, por asnjë nuk u zgjua deri në namazin e sabahut. Të nesërmen ajo shkoi tek zotëria i parë, Hasani e i tha: Më ke shitur tek një familje e keqe, se ata falin vetëm farzet, kthemë prapë tek ti, dhe ai e ktheu robëreshën.

Shtrohet pyetja sikur të ishte gjallë kjo robëreshë e të shikonte gjendjen e muslimanëve sot, sigurisht që nuk do të kishte thirrur për namaz nate, por do të mjaftonte për të vetëm falja e namazit të sabahut në kohën e vet?!

Abdullahu, i biri i Ahmed b. Hanbelit i tha babait të vet, kur e pa duke falur namaz nate: “Shumë gjatë, o baba, kur pushon?” Ai iu përgjigj kështu: e ngriti dorën lart pastaj e vendosi në kofshë e tha: “Kur të hyjë kjo në xhenet, atëherë do të pushoj.”

Namazi i teravive

Muaji i Ramazanit karakterizohet me një adhurim të veçantë dhe ai është namazi i teravive, që falet pas namazit të jacisë. Dijetari Ibën Rexhepi thotë: Besimtarit në muajin e Ramazanit i mblidhen dy xhihade të trupit: e para: xhihadi gjatë ditës me agjërim, e dyta: xhihadi natën me namaz nate – teravi, tek ai njeri që mblidhen këto dy xhihade do të

ketë shpërblim që nuk mund të llogaritet.

Nga Ebu Hurejra përcillet se Pejgamberi salaAllahu alejhi ue selem ka thënë: *“Kush i kalon netët e Ramazanit duke bërë ibadet me besim të plotë dhe duke shpresuar në shpërblimin e tij, do t’i falen të gjitha mëkatet e tij të mëparshme”*. Buhariu, Muslimi.

Imam Neveviu thotë: Me fjalët *netët e ramazanit* ka si qëllim namazin e teravive.

Muhamed b. Uthejmini thotë: Nga ky hadith kuptojmë: namazi i natës në Ramazan përfshin namazin në fillim të natës si dhe në mbarim, nga kjo del në pah se namazi i teravive është namaz nate dhe ne duhet të kujdesemi ndaj këtij namazi, duke shpresuar shpërblim tek Allahu, se janë ditë të caktuara dhe besimtari i çiltër e shfrytëzon këtë adhurim para se t’i kalojë.

Nga Aishja, radijallahu anha, përcillet se *njerëzit faleshin në xhaminë e Pejgamberit në netët e ramazanit veçan. Ai që dinte diçka nga Kurani faleshin mbrapa tij pesë apo gjashtë vetë, më pak apo më shumë. Një natë mbasi e fali jacinë Pejgamberi, salallahu alejhi ue selem, doli në xhami dhe ua fali namazin e teravive më gjatë dhe të nesërmen po bisedojnë njerëzit për namazin e Pejgamberit, salallahu alejhi ue selem, dhe ja të nesërmen u mbush xhamia përsëri si dhe natën e parë. Në natën e katërt u mblodh një xhema më i madh dhe po prisnin Pejgamberin salaAllahu alejhi ue selem, ky e pyeti Aishen, se pse janë mbledhur? Ajo iu përgjigj: O i Dërguar i Allahut, kanë biseduar njerëzit për namazin tënd, që ua ke falur; atë natë ai nuk doli në xhami, por e fali namazin në shtëpinë e vet. Të nesërmen iu tha shokëve të vet: O ju njerëz, vallahi nuk kam fjetur, por unë nuk kam qenë i pakujdesshëm edhe për pozitën tuaj tek unë, por u frikësova, se mos po iu bëhet farz namazi i natës e nuk keni mundësi t’i përmbaheni”*. Buhariu, Muslimi.

Imam Zuhriu thotë: Vazhduan njerëzit në këtë gjendje duke u falur grupe-grupe derisa

ndërroi jetë i Dërguari i Allahut, po edhe në kohën e Ebu Bekrit dhe në fillim të kohës së Omerit, i cili pastaj i bashkoi me një imam, Ubej b. Ka’bin.

Albani thotë: Ky hadith është i qartë në argumentimin e ligjshëm, se namazi i teravive është falur me xhemat, siç veproi i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, tri net radhazi, dhe kjo nuk mund të kundërshtohet me faktin se ai, salallahu alejhi ue selem, nuk e fali me xhemat në natën e katërt, sepse arsyeja ishte e qartë: *“u frikësova se mos po ju bëhet farz”*, nuk ka dyshim se kjo frikë u eliminua më vonë dhe për këtë arsye Omeri b. Hatabi e ngjalli këtë sunet, ky është edhe mendimi i shumicës së dijetarëve.

Pejgamberi salaAllahu alejhi ue selem thotë: *“Njeriu –namazliu, i cili falet me imam deri në fund i shkruhet sikur të jetë falur tërë natën”*.

Muhamed b. Uthejmini thotë: Nuk duhet të largohet nga namazi derisa ta përfundojë imami namazin e teravive, si dhe vitrin, që ta arrijë vlerën apo shpërblimin e namazit të natës.

Gjithashtu thotë: lejohet prania e femrave – grave në namazin e teravive në xhami, nëse nuk ka fitne – provokime të ndryshme, mirëpo duhet të mbulohen e mos të vijnë në xhami gjysmë lakuriq, apo të zbukuruara, apo të parfumuara, si dhe mos t’i ngrisin zërat, duhet të dalin prej xhamisë menjëherë pas selamit e mos të përzihen me burra, ashtu siç bëhej në kohën e Pejgamberit, salallahu alejhi ue selem, siç na tregon Umu Seleme që mbasi ka dhënë selam i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, *‘ne gratë jemi ngritur menjëherë, ndërsa ai vonohej pak’*. Allahu e di më së miri, por mund të themi se vonimi i Pejgamberit, salallahu alejhi ue selem, bëhej me qëllim që grave t’u jepte mundësi të dalin dhe të mos përzihen burra e gra. ■

PROFETI, SALALLAHU ALEJHI UE SELEM, DHE RAMAZANI

SHKRUAN: LULZIM SUSURI

Hadithi është i saktë dhe përmendet në disa libra bazë të kësaj shkence. Ndër dijetarët më të shquar që e kanë shënuar nëpër librat e tyre janë këta:

- Imam Buhari e shënon në pesë vende në **Sahihun** e tij me nr. 6, 1902, 3220, 3554, dhe 4997. Po ashtu në librin Edebul Mufred, nr. 224.

- Imam Muslimi në Sahihun e tij, nr. 5964, 5965.

- Imam Ahmedi në Musnedin e tij, 5/143, 5/180

- Imam Tirmidhiu në librin e tij; Shemail Muhamedije, nr. 303.

- Imam Nesaiu në Sunenin e tij, nr. 2094.

- Imam Ibën Maxhe, nr. 1610, 2254.

Rëndësia e hadithit.

Hadithi tregon për gjendjen dhe cilësitë e Profetit, salallahu alejhi ue selem, në përgjithësi, por veçon gjendjen e tij në muajin e shenjtë të Ramazanit. Kjo gjendje është shumë e ngritur dhe përmes saj vërehet qartë ngritja e tij shpirtërore dhe rëndësia që ai i jepte muajit të shenjtë, duke i shtuar adhurimet gjatë tij, si dhe duke mësuar Kuranin librin e Zotit, libër që edhe pse i zbriste këtij njeriu, ai

Na përcillet se Abdullah b. Abasi, radijallahu anhu, ka thënë:

“I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, ishte njeriu më bujar e i shtojed edhe më shumë bujaria në muajin Ramazan kur e takonte Xhibrilin. Ai me të në këtë muaj takojed çdo natë dhe para tij mësonde Kuranin. Prandaj i Dërguari, salallahu alejhi ve selem, ishte më bujar se era e dërguar me mirësi të shumta”.



prapë nuk mjaftojë me aq, por vazhdon të mëson me mësuesin e tij Xhibrilin, alejhi salam.

Komentimi i hadithit:

Fjala e Pejgamberit, salallahu alejhi ve selem: ***“I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, ishte njeriu më bujar”***

Nuk ka dyshim se i Dërguari, salallahu alejhi ve selem, ishte një njeri i tillë dhe kishte cilësi të tilla, kur dihet se Allahu i Lartësuar e zgjodhi atë njeriun më të mirë në faqen e tokës për t'i shpallur mesazhin hyjnor e edhe më tepër se kjo, Zoti me Mëshirën e Tij ia plotësoi edukatën e mirë dhe ia kompletoi të gjitha cilësitë e mira, të cilat duhet t'i zotëronte një i dashur i Tij. Si mos të ishte njeri bujar, kur këtë cilësi e kishte edhe Zoti i tij, si dhe Ai dëshironte ta kenë edhe robërit e Tij. Tirmidhiu na përcjell nga Sadi, radijallahu anhu, se i Dërguari, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: ***“Allahu është Bujar dhe e do bujarinë”***. Gjithashtu përcillet të ketë thënë: ***“Unë jam njeriu më bujar”***. Një gjë të tillë e tregojnë për të edhe shokët e tij, kur e tregon edhe Enesi, radijallahu anhu, siç e shënon Buhariu, se: ***“i Dërguari, salallahu alejhi ve selem, ishte njeriu më trim si dhe më bujari”***.

“I shtojë edhe më shumë bujaria në muajin Ramazan kur e takonte Xhibrilin”

Më lart përmendëm se i Dërguari, salallahu alejhi ve selem, ishte shumë bujar, e në këtë pjesë të hadithit tregohet qartë se ai e shtonte këtë veti të tij edhe më tepër në këtë muaj. Kjo për shkak se muaji i Ramazanit është muaji i mirësisë, i zbritjes së mëshirës së Zotit më shumë se çdo herë tjetër, mëshirë kjo e cila i përfshin njerëzit dhe i shtyn drejt devotshmërisë, e cila e shtyn edhe Profetin, salallahu alejhi ve selem, drejt veprave më të mira. Gjithashtu për arsye se pasi Allahu në këtë muaj i shton mirësitë e Tij, edhe i Dërguari i Tij, salallahu alejhi ve selem, dëshironte ta pasonte rrugën e Zotit të tij

duke i shtuar vetitë e tij të mira këtë muaj, ndër të cilat ishte edhe bujaria.

Nuk ka dyshim se ndikim të madh tek ai për shtimin e kësaj vetie të mirë kishte takimi me mësuesin e tij, Xhibrilin, alejhi salam, nga i cili mëson dhe edukohej. Kjo gjë bëhej shkak që të shtojë bujaria e tij ndaj të tjerëve, si falënderim ndaj Allahut, që t'ia shtojë mirësitë e Tij edhe më shumë. I Dërguari, salallahu alejhi ve selem, ndikohej shumë nga mësimet e mësuesit të tij Xhibrilin, siç ndikohet çdo nxënës i mirë nga dersi i mësuesit të mirë e pastaj ai dersi e shtyn t'i shtojë veprat e mira. Përveç kësaj, ndikim të madh kishte edhe shpeshimi i leximit të Kuranit, i cili kur kryhet ndikon pa masë në ngritjen morale dhe fetare të njeriut dhe pas kësaj pasojnë punët e mira në të cilat nxit ai.

“Ai takojë çdo natë me të (Xhibrilin) në këtë muaj dhe para tij mëson Kuranin”

Xhibrili, alejhi salam, nuk zbriste tek i Dërguari, salallahu alejhi ve selem, vetëm për t'i sjellë shpalljen hyjnore, por edhe për shumë gjëra të tjera, ndër të cilat ishte edhe përsëritja dhe mësimi i asaj që kishin mësuar më herët. Në këtë transmetim përmendet se i Dërguari, salallahu alejhi ve selem, mëson Kuran para Xhibrilin, kurse në disa të tjera përmendet se e lexonte Kuranin para tij. Që të dy transmetimet janë të sakta, si dhe kanë të njëjtin kuptim, por edhe mund të themi se i Dërguari disa vite mësoi Kuranin dhe shkencat e tij para Xhibrilin, e pastaj kur i përfunduan ato, atëherë vetëm e përsëriste atë para mësuesit të vet, që mos ta harrojë, edhe pse Allahu e di më së miri.

Pra, Xhibrili, alejhi salam, që kur u bë detyrim agjërimi i Ramazanit, çdo vit zbriste tek Profeti, salallahu alejhi ve selem, dhe i mëson Kuranin, pra, atë pjesë që i kishte zbritur atë vit ia mëson, si dhe i përsëriste pjesët që i kishin zbritur para tij që mos t'i harronte.

Në një transmetim qëndron se Xhibrili,

alejhi salam, vitin e fundit e dëgjoi të Dërguarin, salallahu alejhi ue selem, ta përsëriste Kuranin dy herë gjatë një Ramazani. Kjo është e saktë sipas transmetimeve të haditheve nëpër librat burimore të dijetarëve të hadithit. Ata e komentojnë këtë ngjarje, se Xhibrili herën e parë e mësoi si çdo vit që vepronte me të, kurse herën e dytë i bëri një përmbledhje të përgjithshme të mësimave kuranore dhe gjithashtu përsëritjen e asaj që mbante mend i Dërguari, salallahu alejhi ue selem. Kjo ishte edhe përgatitje nga ana e mësuesit të vet, që kur ta gjejë vdekja të jetë sa më i freskët me mësimet e Kuranit dhe shkencave të tij. Por kjo nuk do të thotë, se Profeti apo Xhibrili e dinin se atë vit i Dërguari, salallahu alejhi ue selem, do të vdiste. Ata e përsëritën Kuranin dy herë atë vit me urdhër të Atij, që i di fshehtësitë e qiejve dhe të tokës, pra, me urdhër të Allahut.

“Prandaj i Dërguari, salallahu alejhi ue selem, ishte më bujar se era e dërguar me mirësi të shumta”.

Në pjesën e fundit të këtij hadithi Ibën Abasi, radijallahu anhu, i kthehet asaj që tha në fillim, pra, për të treguar bujarinë e Profetit, salallahu alejhi ue selem, bën një krahasim me erën. Me këtë erë nënkuptohet era, e cila sjell me vete retë me shi të bollshëm e pastaj ai shi bie mbi tokën e vdekur nga thatësira dhe e ngjall atë, por edhe mbi tokën e njomë. Pra, kjo erë nuk bën dallim për asnjë lloj toke, por përfshin me mirësitë e saj çdo gjë që gjen para vetes, dhe ngase nuk sjell furtuna e as breshër është e mirëpritur nga çdo njeri dhe çdolloj toke. E i Dërguari i Allahut, Muhamedi salallahu alejhi ue selem, ishte jo vetëm si kjo erë me bujarinë dhe mirësitë e tij të shumta, por Ibën Abasi thotë se ishte edhe më bujar se kjo erë e pritur për një kohë të gjatë. Dhe ai me të vërtetë ishte i tillë, bujaria e tij kaploi çdo gjë: njerëzit dhe kafshët, insektet dhe bimët... Tek ai gjenin

mirësi secili dhe për çdokënd kishte diçka nga e cila ai person do të përfitonte. E gjëja më e madhe nga e cila të tjerët përfitonin ishte thirrja e tij në Islam dhe garantimi i xhenetit atij që do t'i përgjigjej kërkesave të tij.

Në këtë pjesë të hadithit përmendet se Pejgamberi, salallahu alejhi ue selem, ishte po kaq bujar në jetën e tij në përgjithësi e jo vetëm në muajin e mëshirës, në atë të Ramazanit. Lind pyetja: a thua si ishte ai në këtë muaj, meqë ngrihej shumë më tepër në devotshmëri dhe cilësi të mira. Ibën Abasi, radijallahu anhu, pasi nuk kishte me çfarë ta krahasonte bujarinë e tij në këtë muaj, sepse nuk kishte diçka me të cilën mund të krahasohej Profeti, salallahu alejhi ue selem, atëherë e krahasoi me këtë erë gjatë gjendjes së tij jashtë këtij muaji, e sa i përket muajit Ramazan s'ke me çfarë ta krahasosh bujarinë e tij, salallahu alejhi ue selem.

Nga dobithë e hadithit:

1- Bujaria është cilësi e Allahut, të cilën Ai e dëshiron tek robërit e Vet.

2- Profeti, salallahu alejhi ue selem, ishte njeriu më bujar, e i shtojte kjo veti në muajin e shenjtë të Ramazanit, kur takohej me mësuesin e tij, Xhibrilin, alejhi salam.

3- Hadithi tregon se besimtari në këtë muaj duhet të mundohet t'i shtojë punët e tij të mira, siç janë: bujaria, devotshmëria, namazi etj. Pra, çdo cilësi dhe adhurim që e do Allahu dhe shpërblen për të.

4- Kuptojmë se Pejgamberi, salallahu alejhi ue selem, takohej me Xhibrilin, alejhi salam, në Ramazan dhe jashtë tij, e shihnin njëri-tjetrin dhe bisedonin ndërmjet tyre.

5- Xhibrili, alejhi salam, zbriste çdo natë të Ramazanit për t'i mësuar Kuranin, pra, atë pjesë që pat zbritur ai atë vit dhe pjesët e zbritura më herët që mos t'i harronte.

6- Muaji i Ramazanit përveç se është muaj i adhurimeve, ai është edhe muaj i leximit të Kuranit dhe i studimit të tij, prandaj çdo

besimtar duhet ta ketë këtë parasysh.

7- I Dërguari, salallahu alejhi ue selem, ishte më bujar se era, që tregon se me të nuk krahasohej askush dhe asgjë nga krijesat e Allahut, kur janë në pyetje vetitë pozitive dhe ato të mirat për të cilat robi shpërblehet.

8- Njeriu duhet të mësojë fenë e tij, edhe nëse ka kaluar nga jeta e tij disa vite. Sepse besimtari duhet të ketë gjithmonë si qëllim të tij ngritjen psikike dhe fetare deri në vdekje. Një fjalë e urtë thotë: “Kërkoje diturinë nga djepi deri në varr”.

9- Pas Profetit, salallahu alejhi ue selem, askush nuk duhet të ngurrojë të ketë mësues të vetin, duke pretenduar se mjafton për të vetëm leximi i librave dhe nuk ka nevojë për mësues. Nëse i Dërguari i Allahut, mësonte nga krijesat atë që Allahu ia pat zbritur, atëherë a ka kush pas tij që nuk do të ketë nevojë për mësues.

10- Kurani ka nevojë për përsëritje e nëse jo, atëherë ikën sikurse të mos kishte ekzistuar fare. Kjo për arsye së nxënia e tij përmendësh dhe mos-harrimi janë adhurime, të cilat Zoti nuk ia jep atyre që i ikin këtij adhurimi pasi kanë qenë një kohë të gjatë me të.

11- Hadithi tregon se besimtari duhet të ndikohet nga derset e hoxhës tek i cili merr pjesë në ligjërata, një gjë të tillë e vëren njeriu atëherë kur sheh tek vetja se është duke u ndikuar pozitivisht nga ato ligjërata, siç ndikohet Profeti, salallahu alejhi ue selem.

Në fund themi se ky ishte Profeti jonë, salallahu alejhi ue selem, në këtë muaj, prandaj pasojeni atë, o besimtarë të sinqertë, nëse jeni vërtetë të tillë! ■

PREZANTIM I LIBRIT:

“RRUGËT E NJERËZVE TË DEVOTSHËM”

Autori me një mjeshtëri të rrallë, me një mprehtësi mendore e gjuhësore arrin që lexuesit t'i ndihmojë të depërtojë thellë në përmbajtjen e librit, që hapet me të kuptuarit, me bukuritë dhe me dobitë që i sjell sureja Fatiha

SHKRUAN: AGIM AVDIU

U bënë më se katër muaj që kur doli në shitje libri i klasikut dhe i tradicionalistit islam Ibën Kajjim El-Xheuzije, me titull në gjuhën shqipe “Rrugët e njerëzve të devotshëm” e cila për arabë folësit njihet me titull “Medarixhus-salikin”. Tashmë hoxhallarët tanë e dinë se për çfarë veprë bëhet fjalë, mirëpo me botimin e saj në gjuhën shqipe nga shtëpia botuese “Dëshmia” nga Shkupi, edhe lexuesit e rëndomtë të të gjitha rrjedhave shkencore e kulturore, do të njoftohen me përmbajtjen e këtij libri të Ibën Kajjimit që për disa studiues të veprave të tij, konsiderohet si kryevepra e këtij kolosi të penës islame.


Autori me një mjeshtëri të rrallë, me një mprehtësi mendore e gjuhësore arrin që lexuesit t'i ndihmojë të depërtojë thellë në përmbajtjen e librit, që hapet me të kuptuarit, me bukuritë dhe me dobitë që i sjell sureja Fatiha, sure kjo që përsëritet, për të shkruar më

Autor: Ibën Kajjim elXheuzije • Boton: Sh. B. "Dëshmia"

tej në shpjegime frymore e spirituale të udhëzimit, si një hidajet i dhënë nga Allahu deri tek besimtarët. Lexuesi në këtë libër mund ta gjejë sqarimin e asaj se si t'i afrohem Allahut, cilat janë mënyrat e drejta dhe cilat ato të gabueshme, pastaj me bukurinë dhe me stilin e të shkruarit të qartë, të lehtë e të kuptueshëm, autori i tregon të gjitha shkallët e udhëzimit, si të jemi robër të denjë të Allahut, si ta kërkojmë ndihmën e Tij, parimet e adhurimit, çka

është zemra e zgjuar, cilat janë shkallët e të menduarit, si të llogarisim vetveten etj.

Me bukuri të veçantë dhe me një ekskluzivitet prej dijetari, Ibën Kajjimi një pjesë të madhe të librit ia ka kushtuar pendimit, kësaj dere të hapur për të gjithë ata që e kërkojnë shpëtimin, dispozitave të teubes, të kuptuarit të mëkatit dhe të mëkatarit, llojeve të mëkatimit për të depërtuar më vonë edhe në sqarimin e disa meseleve nga ana e fraksioneve si: xhebrijtë, kaderijtë etj. Se sa bukur dhe sa mirë e njeh natyrën e vrullshme, të ngutshme, por shumë herë subtile, të ndjeshme, të bukur, të qartë, të ëmbël, të dashur të njeriut, Ibën Kajjimi të gjitha këto i sqaron nëpër kapitujt të cilët zakonisht i ka emërtuar si shkallë, si rrugë, si udhëtime deri te njohja e njëmendtë e tyre, të cilat të gjitha janë analizuar në mënyrë të thuktë me argumente si nga Kur'ani, ashtu edhe nga Sunneti i dashur i të Dërguarit Muhammed salallahu alejhi ue selem, por duke mos harruar as mendimet e dijetarëve




të ndryshëm gjatë historisë islame deri atëherë kur jetoi Ibën Kajjimi. Duhet ta përmendim edhe atë se, çdo argument i sjellë në libër, shumë lehtë mund të gjendet për shkak të referencave të mrekullueshme të vendosura në fusnota të librit.

Sa bukur tingëllojnë këta tituj: Shkalla e kthimit te Krijuesi (El-Inabe), shkalla e përkujtimit, shkallët e strehimit nën mbrojtjen e Allahut, shkalla e ngutjes drejt Allahut të Lartësuar, shkalla e dëgjimit etj. që janë bukuri në vete në këtë

libër. Vetëm ai që zhytet në leximin e tyre, do ta kuptojë ëmbëlsinë e fjalëve, mjeshtërinë e të sqaruarit dhe aftësinë që bashkë me autorin e këtij libri, të futet në kuptimin e atyre që e ndjejnë veten 'arif – njohës të vërtetë të Allahut. Dijetari i madh Ibën Kajjimi, aq bukur e ka thurur këtë libër, me ç'rast lexuesit shumë qartë do ta kuptojnë se libri në tërësi është një zinxhir i tërë, sepse çdo kaptinë është hallkë përbërëse e këtij zinxhiri, kështu që, edhe pse voluminoz për nga përmbajtja, libri prapë nuk do t'ju le rehat derisa nuk e lexoni të tërin.

Mbetet që lexuesi shqiptar këtë libër ta ketë në raftin e bibliotekës së tij, jo vetëm si nevojë për ndonjë fragment të duhur për të sqaruar diçka, por edhe si libër që lexohet e rilexohet shpesh, sepse ne kemi nevojë shumë për diturinë e dijetarëve të këtij kalibri, siç është Ibën Kajjim El-Xheuzije, një klasik, një tradicionalist, një njohës i mirë i rrugëtimit të njerëzve të devotshëm drejt ëmbëlsisë së islamit në këtë botë. ■

ARABIA SAUDITE



Pas zbulimit të burimeve të rëndësishme natyrore si nafta e gazi, Arabia Saudite mori përsipër që të zgjatë dorën e saj të ndihmës për vëllezërit e tyre muslimanë anekënd botës, si dhe duke marrë pjesë në projektet e ndryshme e sidomos ato edukative arsimore.



Të dhënat tabelore:

Emri i plotë: Mbretëria e Arabisë Saudite.

Kryeqyteti: Rijadi.

Sipërfaqja:

2.248,000 km².

Banorët deri më 2007 :
27.601.038.

Përqindja vjetore e rritjes së banorëve (2000 - 2005): 2.5 %

Përqindja e muslimanëve: 100 %.

Gjuha: Arabe.

Monedha: Rijali Saudit.

Pavarësia: 1932

Anëtar i Kombeve të

Bashkuara: 24/10/1945

Anëtar i Konferencës Islamike: 1969

Mbretëria e Arabisë Saudite gjendet në jug-perëndim të kontinentit të Azisë. Ajo kufizohet në perëndim me Detin e Kuq, në lindje me Gjirin Arabik, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Katarin, në veri me Kuvajtin, Irakun dhe Jordaninë dhe në Jug me Jemenin e Sulltanatin e Omanit.

Arabia Saudite konsiderohet djepi i Islamit. Aty në Meken e Ndershme, në shpellën Hira, para më se katërmëdhjetë shekujve, zbriti shpallja besnike mbi zemrën e të Dërguarit të zgjedhur -paqja dhe shpëtimi qoftë mbi të - me fjalën **'Lexo'**, dhe në Medinën e shndritshme u ngrit bërthama e shtetit Islam, e cila arriti - më pas - prej Kashgarit në Lindje deri në Endelus në perëndim dhe buzë brigeve të Vollgës në veri.

Prej një vendi të banuar me beduinë (nomadë), të cilët garonin në zbatimin e zakoneve, dhe dokeve që përfaqësonin nivelin më të ulët të vetëdijes në atë kohë, dhe mbi të gjitha prej një idhujtarie ekstreme, e cila i bënte të varur nga idhujt e ndërtuar me dorën e tyre, dhe i privonte nga çiltërsia e besimit, se i vetmi Zoti e meriton adhurimin, këta njerëz me anë të Islamit u bënë mbartës me dinjitet të Fjalës së Zotit te popujt e tjerë anekënd botës. Ata dhanë shembujt më të mirë gjatë historisë njerëzore, duke pasqyruar kështu para të gjithë botës vlerat e larta të Islamit dhe forcën e tij ndryshuese.

E gjitha kjo vazhdoi me shekuj dhe Arabia Saudite ka vendin e merituar në Botën Islame e sidomos kur aty gjendet krahina e Hixhazit (Meka dhe Medina). Por me fillimin e viteve të dekadencës së Halifatit Islam të Osmanllive, i cili pos aspektit shtetëror ishte edhe më i theksuar edhe në shkencat fetare, Arabia Saudite mori prapë rolin saj të ripërtëritjes së Islamit burimor dhe shkencave fetare.

Në shekullin e shtatëmbëdhjetë, dijetari

i nderuar, Muhammed b. AbdulVehhab pasi udhëtoi nëpër disa qendra islame të asaj kohe dhe u pajis me dije burimore islame u kthye në vendlindjen e tij në Nexhd (krahinë në Arabinë Saudite) dhe filloi thirrjen e tij për Islamin burimor. Ai nuk erdhi me diçka të re, por vetëm se ringjalli te njerëzit fjalët dhe besimin e **gjeneratave të para të arta**, të cilat përfaqësoheshin në besimin e pastër, pasimin e drejtë të medhhebeve dhe flakjen e fanatizmit, duke e shoqëruar thirrjen e tij me përkujtimin e njerëzve për pozitën që meritonin libri i Allahut dhe fjala e Pejgamberit, paqja dhe mëshira e Allahu qoftë mbi të.

Kjo thirrje e tij gjeti pranim te një pjesë e madhe e botës islame, e cila tek ai shihte shpëtimin dhe krenarinë, që kishin humbur me kohë dhe që të përkujtonte lavdinë e **gjeneratave të para të muslimanëve** dhe së bashku me thirrje të ngjashme në tërë botën islame u bë themel i një shoqërie islame të pastër dhe i një ripërtëritjeje të shkencave islame, të cilat janë dritë dhe mirësi për njerëzimin.

Tërë këtë mesazh Arabia Saudite e mbarti në vazhdimësi, duke e bërë atë edhe simbol të ekzistencës së saj. Sauditët ndërtuan shtetin tyre mbi baza islame, duke bërë që të udhëhiqej nga ligjet islame e me këtë edhe të japin shembull për qeverisjen e mirë të ligjit Islam dhe përshtatshmërisë së tij për çdo kohë dhe vend.

Të njëjtën gjë e pohoi edhe Mbreti AbdulAziz b. Saud, ai arriti t'i bashkonte krahinat e ndara dhe të shpallte bashkimin e mbretërisë së tij në vitin 1932.

Pas zbulimit të burimeve të rëndësishme natyrore si nafta e gazi, Arabia Saudite mori përsipër që të zgjatë dorën e saj të ndihmës për vëllezërit e tyre muslimanë anekënd botës, si dhe duke marrë pjesë në projektet e ndryshme e

sidomos ato edukative arsimore. Arabia Saudite është donatori më i madh në Botën Islame. Gjithashtu, ajo mori përsipër ndërtimin dhe financimin e qendrave të ndryshme islame prej lindjes e deri në perëndim, të cilat ndihmuan në përhapjen e shkencave islame dhe njohjen e njerëzve në përgjithësi me vlerat islame.

Muslimanët e Ballkanit i janë mirënjohës Arabisë Saudite për ndihmën e ofruar në kohët më të vështira, për mbështetjen financiare dhe ndërkombëtare të kauzave të tyre, e cila u mishërua përveç të tjerave së fundmi edhe në konferencën e donatorëve për Kosovën dhe u shoqërua me premtimin për donacione të tjera dhe njohje të pavarësisë së saj.

Kur flasim për Arabinë Saudite është vështirë të mos përmendim edhe atë se me prezencën e Mekës dhe Medinës, Arabia Saudite zë një vend të posaçëm në zemrat e muslimanëve të mbarë globit. Muslimanët për çdo vit me miliona e vizitojnë këtë vend për të kryer Umren - vizita dhe rituale, të cilat bëhen në këto vende të shenjta dhe Haxhillëkun - shtyllën e pestë të Islamit. Për këtë Arabia Saudite, duke e kuptuar mirë këtë privilegj dhe duke e ndier veten të detyruar, ia ka nënshtruar potencialin e saj intelektual dhe financiar përmirësimit të kushteve për haxhilerët, si në aspektin e infrastrukturës, ashtu edhe në aspektin organizativ. Çdokush që viziton Vendet e Shenjta e ndien tërë këtë mund, i cili bëhet për rehatinë e haxhilerëve, po kjo mund të dëshmohej edhe nga pamjet e Vendeve të Shenjta, të cilat flasin vetvetiu për këtë përkujdesje të veçantë.

Po ashtu ky nivel i shërbimit dhe i

mikpritjes është edhe gjatë muajit të Ramazanit, ku Arabia Saudite pret me miliona njerëz, që vijnë për të bërë Umren në Ramazan. Mu për këtë dhe pasi jemi në prag të Ramazanit kemi përgatitur një artikull, i cili flet për mikpritjen dhe atmosferën që mbretëron në këtë vend dhe kohë dhe përshtypjet e vizitorëve të tij gjatë Muajit të madhërishtëm të Ramazanit.

Më 1938 Arabia Saudite filloi eksportimin e naftës dhe ajo zotëron një të katërtën e rezervave të naftës botërore. Pasuria e shtetit mbështetet në gaz natyror dhe naftë. Të ardhurat e saj sigurohen kryesisht nga nxjerrja e naftës, ku rezervat e saj vlerësohen deri në 35.6 miliard ton, si dhe nga prodhimi i gazit natyror, ku rezervat e tij vlerësohen deri në 5250 miliard m³.¹ Arabia Saudite është vendi i parë në prodhimin e naftës në nivel botëror dhe rezervat e tij, e pesta për sa i përket rezervave të gazit natyror dhe e dhjeta për sa i përket prodhimit të tij.

Arabia Saudite është njëri nga shtetet me zhvillim më të shpejtë në botë, duke pasur parasysh rezervat e mëdha të naftës dhe çmimin e saj të lartë ndërkombëtar gjatë viteve të fundit. Ajo ka investuar shumë në infrastrukturë, edukim dhe industri, sidomos në industrinë e naftës. Duke pasur si qëllim rritjen e ekonomisë Arabia Saudite ka filluar ndërtimin e gjashtë qyteteve ekonomike, të cilat do të ndikojnë drejtpërsëdrejti në rritjen dhe zhvillimin e ekonomisë së këtij vendi.

Arabia Saudite prodhon: hurma, grurë², elb etj., gjithashtu zotëron një pasuri të madhe në bagëti, duke përfshirë delet, dhitë, devetë, lopët dhe kjo lloj pasurie është në rritje e sipër vazhdimisht. ■

¹ Këto shifra janë marrë nga faqja e Ministrisë së Punëve të Jashtme

² Pjesa më e madhe e tij eksportohet në vende të ndryshme, ndërsa një pjesë i jepet shteteve arabe.

SHTOJCË EKSKLUZIVE PËR RAMAZAN:


PËRJETIMI I MOMENTIT TË IFTARIT NË MEDINË

NGA: JUSUF BELUSHI DHE MAHMUD AHMED

Çelja e iftarit në oborr të Xhamisë së Shenjtë të Medinës është një përvojë që duhet rrëfyer. Qytetarët e Medinës dhe shumë vizitorë e ndërpresin agjërimin e tyre në oborr të Xhamisë dhe për ta, Iftari është një përvojë e veçantë, sidomos në Ramazan. Njerëzit e përshkruajnë tubimin brenda dhe në oborr të Xhamisë si një takim vëllazëror. Njerëzit i buzëqeshin njëri tjetrit, përshëndeten me duar me të huajt prej vendeve dhe kulturave të ndryshme dhe që flasin gjuhë të ndryshme. Ata të gjithë kanë ardhur që të bëjnë së bashku Iftar. Ujë

zemzemi, hurma dhe ëmbëlsira shpërndahen ndërmjet tyre.

Ndërsa dielli lëshon rrezet e tij të fundit ndriçuese mbi Xhaminë e Shenjtë, njerëzit presin thirrjen për namaz me plot shpresë, se iu është pranuar agjërimi i tyre. Vizitorët e Xhamisë së Shenjtë nuk do ta harrojnë rastin që iu dha për të bërë iftar në vendin që njerëzit e thërrasin 'vendlindje' edhe pse është shumë larg nga ata. Janë dhjetëra mijëra njerëz, që janë të ulur brenda dhe në oborr të Xhamisë së Shenjtë, duke pritur Iftarin. Pak minuta para perëndimit të Diellit njerëzit fillojnë të shpërndajnë ushqimin, që kanë sjellë me vete. Nuk është me rëndësi nëse ndokush ka ardhur deri te Xhamia pa ushqim. Të gjithë kujdesen që të tjerët të



kenë ushqim të mjaftueshëm.

Varietetet e kulturave dhe nacionaliteteve të ndryshme përfaqësohen edhe në llojllojshmërinë e ushqimit që paraqitet në racion. Kur dëgjohej zëri që thërret njerëzit për namaz njerëzit fillojnë me ngrënien e hurmave dhe pirjen e ujit. Secili ndan ushqimin e tij me atë që ka pranë. Njerëzit jo gjithmonë hanë ushqimin e sjellë nga shtëpia, sepse kanë dëshirë që sa më shumë njerëz të hanë ushqimin e tyre e që do të thotë edhe shpërblim nga Zoti.

Pakistanezi AbdulAziz Xhuma thotë: Unë nuk e kam humbur iftarin në Xhaminë e Shenjtë për shtatë vjet. Për çdo ditë marr atë që është e nevojshme për iftar, rezervoj vendin tim dhe thërras shumë njerëz të ulen pranë meje. Unë i marr vëllezërit dhe fëmijët e mi që të më ndihmojnë. Unë vij këtu një orë para iftarit dhe nuk mundem ta përshkruaj sa i gëzuar që jam në këtë vend me mijëra vëllezër të mi. Ndonjëherë pyes veten pse njerëzit bëjnë iftar në shtëpitë e tyre në vend që të vijnë në xhami.

Hasan Beshiri, vizitor nga Sudani thotë: Unë kam dëshirë të sigurohem që për çdo ditë të vij te Xhamia e Shenjtë për ta falur namazin e ikindisë. Pas faljes ia përkushtoj kohën time leximit të Kuranit apo dëgjimit të ndonjë ligjërate nga hoxhallarët deri afër perëndimit të Diellit. Të bësh iftar në oborr të Xhamisë së Shenjtë është diçka unike. Unë nuk mund ta përshkruaj, sepse ju duhet ta shijoni këtë vetë. Vetëm se ndjenjat nuk mund të përshkruhen. Me dhjetëra mijëra njerëz rreth e rrotull teje bëjnë iftar. Ne e ndajmë të njëjtin ushqim. Të gjithë kërkojnë falje nga Zoti dhe lutën që t'ua pranojë agjërimin e tyre. Atë që do ta veçoja për iftarin këtu është se unë kam zhvilluar miqësi me njerëz me të cilët jam takuar këtu

për herë të parë. Për çdo ditë unë njihem me njerëz që e ndajnë ushqimin me mua në sofrat plastike, Gjatë dhe pas Iftarit ne bisedojmë për problemet tona dhe krizat që ballafaqohet me to Bota Islame. Kam krijuar një fond të gjerë kujtese, kur të kthehem në Sudan. Ramazani në Medinë e sidomos në Harem është Ramazani që e kam kaluar më së miri.


Muselem Seidi, banor vendas thotë: Edhe pse kam shumë ftesa prej familjes apo kushërinjve që t'ju bashkohem për iftar me ata, unë ju them atyre se jam i zënë, ose më kanë ftuar disa shokë. E shokët e mi janë njerëzit e mbledhur për të bërë iftar në Xhaminë e Shenjtë. Është nder për mua të sjell ushqim të përgatitur nga familja ime deri te Xhamia e Shenjtë dhe t'i shërbej me këtë ushqim vizitorët dhe ata që kanë ardhur për Umre. Ne kemi një fjalë të urtë në arabisht: *“Zotëri i njerëzve është ai që iu shërben atyre”*.¹ Kur kryhet thirrja për namaz, unë jam i sigurt se njerëzit që janë ulur pranë meje kanë diçka për të ngrënë dhe për të pirë. Zemra ime fluturon kur i shoh të bëjnë iftar dhe përshëndeten me duar për të arritur kënaqësinë e Zotit.

Menjëherë pasi mbaron iftari pamja e zgjatur e sofrave prej plastike humbet në më pak se dy minuta në një mënyrë të organizuar para se të fillojë namazi i Akshamit. Sistemi është i thjeshtë. Në çdo sofër ushqimi gjenden dy persona përgjegjës për mbledhjen e sofrës së gjatë të plastikës, së bashku me mbeturinat e ushqimit dhe e vendosin në qese speciale të bëra për këtë qëllim e pastaj e hedhin nëpër kontejnerë. Rregullimi i mijëra sofrave plastike në një vend të gatshëm për t'u falur në më pak se tre minuta është diçka e pabesueshme.² ■

Përktheu: Driton LEKAJ

¹ Kjo fjalë është hadith, por që Sehabi dhe Albani e cilësojnë si të dobët, shih: El-Mekasid El- Hasene: 293 dhe Daiful Xhamië: 3323.

² Ky artikull është marrë nga gazeta 'ArabNews'



RRETH ÇËSHTJEVE MJEKËSORE TË RAMAZANIT

NGA DIJETARI I MIRËNJOHUR: SHEJH SALIH EL
FEUZAN

Pyetje: Dhurimi vullnetar i gjakut, a e prish agjërimin apo jo? Nëse i sëmuri ka nevojë për gjak, a i lejohet agjëruarit që t'i dhurojë gjak?

Përgjigja: Po, nxjerrja e gjakut me shumicë për t'ia dhënë të sëmurit në rast emergjence, ose dhurimi gjak për raste të nevojshme e prish agjërimin pa dyshim, ngase hixhamja (kjo është një lloj nxjerrje gjaku nga trupi i njeriut, që bëhet vetëm nën lëkurë.) e prish agjërimin, sikurse ka ardhur në hadithin e saktë: *“E prish (agjërimin) hixhamebërësi dhe atij që i*

bëhet hixhamja”, ngase nxjerrja e gjakut nga trupi i njeriut konsiderohet si ushqim dhe forca e tij dhe se nxjerrja e gjakut dhe agjërimi nuk mund të bashkohen, sepse kjo është e dëmshme. Nxjerrja e gjakut me shumicë, qoftë nëpërmjet hixhames apo me mjete mjekësore e prish agjërimin. Po nëse kjo gjë duhet bërë patjetër, sikurse në rastin kur ka nevojë i sëmuri dhe nevojitet gjak dhe mosdhënia e gjakut rrezikon jetën e tij i bëhet detyrim kujt ka mundësi t'i dhurojë gjak, sepse këtu është në pyetje jeta e një myslimani. Kjo gjë është njësoj si shpëtimi i dikujt nga fundosja apo zjarri, ai detyrohet në këtë rast t'i lejojë që t'i marrin gjakun dhe ai do ta kompensojë këtë ditë, sepse ai e ka prishur këtë ditë

Në këtë rubrikë mirëpresim të gjitha pyetjet e juaja, ndërsa ato më interesante do të botohen.
Pyetjet mund t'i dërgoni në revista@albislam.com

agjërimi me arsye dhe se ai do të shpërblehet për këtë veprim, sepse kjo gjë llogaritet prej mirësisë.

Pyetje: Pikat e gjakut që merren për analizat e gjakut, a e prishin agjërimin? Po nëse kjo përsëritet më shumë se një herë në ditë?

Përgjigja: Gjaku i paktë që nxirret për analiza nuk i përngjan hixhames, e cila është bazë në këtë çështje. (d.m.th.: nuk e prish agjërimin).

Pyetje: Nëse ndodh që i sëmuri ka gjakderdhje duke qenë agjërueshëm, a e prish agjërimin në këtë rast, pa marrë parasysh se sa i shumtë apo i paktë është ky gjak?

Përgjigja: Gjakderdhja pa dashje shumë apo pak nuk ndikon tek agjëruesi (që t'ia prishë agjërimin) pasi kjo ndodh pa qëllimin e agjëruesit. Kjo është njësoj sikur të lëndohet diku apo pas nxjerrjes së dhëmbit ka gjakderdhje dhe është njësoj, se është bërë pa dashjen e tij. Agjërimi prishet kur bëhet nxjerrja e gjakut me vetëdashje, si p.sh.: hixhamja apo dhurimi i gjakut.

Pyetje: Disa injeksione kanë në përmbajtje përbërje vitaminash, të cilat i japin fuqi sistemit nervor, por nuk ndikojnë në fuqizimin e trupit. Cila është përgjigja juaj?

Përgjigja: Injeksionet që përmbajnë vitamina konsiderohen ushqyese dhe kjo ndikon tek agjëruesi. Ai nuk lejohet që t'i përdorë duke qenë agjërueshëm, përveç nëse ka nevojë për injeksionet, i përdor ato dhe e kompenson atë ditë (sepse këto injeksione e prishin agjërimin).

Pyetje: Disa injeksione intravenoze (që futen në vena) apo intramuskulare (në muskuj), të cilat i japin të sëmurit një lloj fuqizimi në trup, a llogariten se janë ushqyese dhe a prishet agjërimi?

Përgjigja: Për injeksionet që i jepen

agjëruesit është folur mjaft rreth tyre dhe është konstatuar se injeksioni, i cili është ushqyes e prish agjërimin, pa kurrfarë diskutimi, pasi ai e zëvendëson ushqimin dhe pijen, prandaj për këtë gjë edhe e prish agjërimin.

Ndërsa injeksionet intravenoze, por që nuk janë ushqyese, të cilat merren nëpërmjet venave, kjo është çështje diskutimi ndërmjet dietarëve bashkëkohorë. Disa thonë se e prish agjërimin, ngase përzihet me gjak dhe ecën nëpër trup dhe i jep fuqi trupit. Ndërsa të tjerët thonë nuk e prish agjërimin, sepse nuk është ushqyese dhe meqë nuk është ushqyese, ajo nuk ndikon në prishjen e agjërit.

Ndërsa injeksioni intramuskular që jepet në muskuj dhe që nuk është ushqyes nuk ka problem, sepse nuk ndikon tek agjëruesi, pasi nuk depërton në gjak apo në brendësi të trupit, por është vetëm nën lëkurë. Injeksionet intramuskulare që jepen në muskuj (nën lëkurë) nuk e prishin agjërimin.

Pyetje: Disa barëra e kanë kohën e caktuar të përdorimit, sepse nëse përdoren jashtë kësaj kohe ato e humbin efektin e tyre ndikues tek i sëmuri, a lejohen të përdoren kur sëmundja, e cila për shkak të saj merret ilaçi mund të jetë sëmundje e rëndomtë e jo diçka e rrezikshme?

Përgjigja: Po, lejohen të përdoren duke qenë agjërueshëm (duke e ndërprerë agjërimin), nëse barërat kanë kohën e vet të caktuar të përdorimit, sepse nëse nuk përdoren në kohën e caktuar, humb efekti i tyre. P.sh.: gjatë ditës së Ramazanit, nëse nuk i përdor humb efektin e saj dhe i sëmuri ka nevojë për të, kjo sikurse thotë Allahu aze ue xhel: *“Ndërsa kush është i sëmurë ose në udhëtim, le të agjërojë atë ditë nga ditët e mëvonshme.”* Një person i tillë e përdor ilaçin dhe e kompenson atë

ditë pas Ramazanit, pasi ai është i sëmurë dhe hyn në fjalën e Allahut kur thotë: **“Ndërsa kush është i sëmurë ose në udhëtim, le të agjërojë aq ditë nga ditët e mëvonshme.”** Edhe nëse sëmundja nuk është shumë e rëndë ose e rrezikshme Allahu aze ue xhel e ka lejuar ilačin dhe e ka lejuar për të sëmurin që të hajë, nëse agjërimi shkakton dobësimin, ose ndikon tek ai. Ndërsa sëmundja e rëndomtë sikurse dhimbja e kokës, dhëmbit, kjo nuk përbën arsye që mos të agjërohet dhe nuk i lejohet që ta prishë agjërimin.

Pyetje: Disa të sëmurë kanë nevojë për operacione të lehta, që nuk i bëjnë dëm të sëmurit që ta shtyjë pas muajit Ramazan, por disa nga të sëmurët e refuzojnë një gjë të tillë. Si është puna me këtë gjendje, kur ata e refuzojnë një gjë të tillë, sepse ne mjekët jemi të sigurt se ky vonim nuk i bën dëm të sëmurit?

Përgjigja: Kjo është më mirë të vonohet (të shtyhet) pas Ramazanit, meqë një vonim i tillë nuk i sjellë të sëmurit ndonjë dëm. Çështja është njësoj në Ramazan apo jashtë Ramazanit, kjo është më e mirë dhe më e dobishme, që ta vonojnë deri pas Ramazanit.

Pyetje: Nëse operacioni nuk është emergjent dhe mund të vonohet deri pas Ramazanit, a i ndalohet mjekut që ta kryejë një operacion të tillë gjatë ditëve të Ramazanit?

Përgjigja: Kjo është siç e përmendëm më parë. Është më mirë dhe më e dobishme të vonohet deri pas Ramazanit, porse nëse i sëmuri e kërkon një gjë të tillë mjeku e kryen duke iu përgjigjur dëshirës së të sëmurit. Ndërsa për sa i përket mjekut nuk ka ndonjë gjë për të, porse duhet që ta këshillojë të sëmurin dhe ta lajmërojë se kryerja e saj në Ramazan nuk është e domosdoshme.

Pyetje: Disa nga të sëmurët në rast se ia

lejon ta prishin agjërimin -Allahu na ruajt-përdorin duhan, ç’thoni ju për këtë?

Përgjigja: Duhani është i ndaluar (haram), nuk lejohet, as për të sëmurin, as për të shëndoshin, qoftë gjatë ramazanit apo jashtë tij. Një gjë të tillë e dinë edhe mjekët, si dhe rrezikun që sjell ai. Ky person duhet të këshillohet, që mos ta sëmurë veten edhe me një sëmundje tjetër përveç asaj që ka. Të këshillohet, t’i bëhet i qartë rreziku nga ai, dhe të kenë frikën Allahun, dhe të mjaftohet me atë që Allahu e ka lejuar.

Pyetje: A e prishin agjërimin pikat që hidhen në sy?

Përgjigja: Është pyetje diskutimi në mes dijetarëve, duke u bazuar tek syri, a është syri grykë qarkullimi, i cili përcjell për në brendësi të trupit apo nuk është grykë qarkullimi? Prej tyre ka që e lejojnë dhe thonë se syri nuk është grykë qarkullimi dhe prej tyre ka që thonë, se syri është grykë qarkullimi përcjellëse, me argumentin që nëse e vendos një pikë në sy e gjen shijen e saj në fyt. Ky është argumenti i tyre, që syri është grykë qarkullimi dhe duke u bazuar në këtë thonë se e prish. Çështja është në dilemë mes dijetarëve dhe në këto çështje muslimani detyrohet t’i largohet asaj që ka dilemë dhe të dalë nga kjo duke marrë rezervat, nëse pikat nuk janë të detyrueshme, por nëse janë të detyrueshme patjetër gjatë ditës së Ramazanit e merr duke pasur kujdes, që mos t’i shkojë në brendësi të trupit, nëse e ndjen shijen e saj të mundohet që ta kthejë dhe ta ndërpresë kalimin e saj në fyt. Kjo nëse e ka të domosdoshme, e nëse jo, e vonon përdorimin e saj deri në mbrëmje.

Pyetje: Pastrimi i veshkave për agjëruesin, i sëmurë, i cili është i varur nga pastrimi i veshkave (dializa) dhe është gjithmonë i lidhur me terapinë për pastrimin e veshkave, dhe mundet që i

sëmuri të jetë agjërueshëm: a e prish agjërimin?

Përgjigja: Pastrimin e veshkave e shoqëron uji, i cili depërton në brendësi të trupit dhe tërheq materiale, e kjo e prish agjërimin. Për këtë ka dalë edhe fetva nga Komisioni i Përhershëm i Fetvave në Arabinë Saudite, në Riad, se pastrimi i veshkave e prish agjërimin, pasi e shoqëron uji dhe materiale, të cilat futen në fyt të agjëruetit dhe nxirren.

Pyetje: A lejohet ai që ka nevojë për barëra të mos i përdorë, duke parë se mund të bëjë durim, a është mëkatar në këtë rast?

Përgjigja: Përdorimi i barërave është i lejuar (mubah) e jo i detyruar (vaxhib) e as i pëlqyeshëm (mustehab) dhe ai nëse nuk e përdor atë (ilaçin) ka lënë një gjë që është e lejueshme, e nuk ka lënë diçka që është vaxhib (për këtë ai nuk është mëkatar).

Pyetje: Nëse ndonjë mjet mjekësor nuk futet nëpërmjet fytit, por nga ana e zorrës së trashë, apo nga ana e organit, a vlen e njëjta dispozitë?

Përgjigja: Po, të gjitha metodat (e përdorimit) janë njësoj, pa marrë parasysh anën se nga futen ato, e prishin agjërimin, pasi lëndët që përmbajnë ato depërtojnë në brendësi, në damarë dhe zorrë dhe kryhet nëpërmjet tyre prishja e agjërit.

Pyetje: Nëse orari i punës së mjekut është natën në muajin e Ramazanit, për sa i përket namazit të natës: a është më mirë për të të kërkojë leje dhe të dalë që të falet me xhemat në namazin e teravive, kur dihet se qëndrimi i tij nuk është i domosdoshëm në vendin e punës, apo të falet vetëm nëse i mundësohet kjo?

Përgjigja: Nuk duhet që ta lerë punën e tij, puna e tij është vaxhib (e detyrueshme), ndërsa shkuarja në taravi është sunet, e nuk lihet vaxhibi për sunetin, por duhet të qëndrojë në vendin e punës së tij e nëse i mundësohet që të falet natën në fillim, në

mes ose në fund të saj, le të falet.

Pyetje: Nëse personi e puth apo e ledhaton gruan e vet gjatë ditës së Ramazanit dhe i rrjedh nga organi medhij (Medhij: Lëngu që del prej organit kur ai ndien kënaqësi gjatë puthjes apo ledhatimit, duke mos arritur orgazmën, pra, është lëngu që i paraprin spermës.): a e prish kjo agjërimin?

Përgjigja: Kjo çështje ka mospajtim mes dijetarëve, nëse i rrjedh organi për shkak të ledhatimit, apo të folurit. Grupi i parë thonë se një gjë e tillë e prish. E grupi tjetër thonë se kjo është gabim dhe ka bërë mëkat, por nuk e ka prishur agjërimin e duhet të pendohet dhe ky është mendimi më i saktë, inshallah. Por duhet t'i largohet një gjëje të tillë, sepse Allahu thotë për agjërimin, se agjërueti e ka lënë epshin, ushqimin, pijen për Mua dhe se lënia e epshit është përmendur para ushqimit dhe pijes. Për këtë njeriu duhet t'i largohet epshit deri sa të bëjë iftar e pastaj t'i afrohet gruas së tij natën, siç na thotë Allahu i Lartësuar: *“Natën e agjërit u është lejuar afrimi te gratë tuaja...”*. Ajeti kuranor aludon se ditën gjatë agjërit nuk lejohet afrimi te gratë tuaja (marrëdhënie intime).

Pyetje: Disa femra përdorin barëra për ndalimin e menstruacioneve, me qëllim që ta agjërojnë muajin e Ramazanit të gjithë. A lejohet një gjë e tillë?

Përgjigja: Mjekët tani janë të pranishëm, nëse thonë se një gjë e tillë nuk e dëmton shëndetin, nuk ka problem të përdoren, për shkak të agjërit të Ramazanit pa ndërprerje. ■

Marrë nga libri: “Fetva të fikhut rreth çështjeve mjekësore të Ramazanit” nga dijetari i mirënjohur Shejh Salih Feuzan

Përktheu: Rashid ZULFIU

NË RAMAZAN NGJAU...

ABDULKAJJUM SUHEJBANI

Në këtë shkrim do të përmend disa ndodhi nga e kaluara e muslimanëve, të cilat kanë ngjarë në muajin e bekuar të Ramazanit. Në fakt bëhet fjalë për raste joshëse që në vetvete përmbajnë

kuriozitete e që janë grumbulluar nga libra të ndryshëm të hadithit, të historisë, biografive e të tjerë.

Ky shkrim synon të arrijë në thellësitë e veprave voluminoze që kanë përpiluar dijetarët e islamit me qëllim që të përfitojmë e të mësojmë nga ndodhitë, që i kanë përmendur ata. Nga ana tjetër është



një metodë e re e shkrimeve që kanë të bëjnë me Ramazanin dhe ndryshe nga ato prezantime klasike që hedhin drite mbi këtë muaj të bekuar.

1. Zuhejr b. Muhamed:

Ai ishte një njeri i devotshëm dhe asket. Për të është thënë: Nuk kemi parë më të mirë se ai pas Ahmed b. Hanbelit. Ishte guximtar i madh. Qëndroi gjatë në pikën luftarake të Tarsusit. Në çdo Ramazan, Zuhejri i përkushtohej shumë leximit të Kuranit. Ai bënte edhe nga nëntëdhjetë hatme gjatë këtij muaji të bekuar. Vdiq në vitin 258 sipas Hixhretit.

2. Amër b. Numan b. Mukrin:

Ky është një prej shokëve të Muhamedit, salallahu alejhi ue selem, ose sipas të tjerëve i përket brezit të dytë të muslimanëve dhe është njëri nga zotërinjtë e tabiinëve.

Ibën Hibbani shënon në librin e tij "Thikat", se Muavije b. Kurre ka thënë: Unë shkova mysafir tek Amër b. Numan b. Mukrini. Meqë erdhi muaji i Ramazanit, Musab b. Umejri kishte dërguar një njeri tek Amri për t'i dhuruar dy mijë dërhem. I dërguari i emirit i tha Amrit: Emiri të bën selam dhe të njofton se çdo lexuesi të nderuar i kemi dhënë këtë dhuratë, prandaj përdore këtë pasuri gjatë këtij muaji. Amri iu drejtua dhe i tha: Bëji selam emirit dhe thuaji: Kuranin nuk e lexojmë për të përfituar ndonjë të mirë të kësaj bote, -dhe ia ktheu pasurinë.

3. Ibën Haxheri lutet:

Sehaviu, njëri nga nxënësit më të afërt të Ibën Haxherit tregon se disa herë kishte dëgjuar mësuesin e tij duke rrëfyer: "Mes

“...Njerëzit detyrohen të synojnë shpëtimin në këtë botë dhe tjetrën, të marrin dijen nga ata që janë kompetentë ...”

meje dhe një ithtari të Ibën Arabiut i quajtur Ibën Emin shpërtheu një polemikë e ashpër rreth çështjes së Ibën Arabiut. M'u kërcënuan se do të më fajësonin përpara Sulltanit, mirëpo unë iu thashë se Sulltani s'ka të bëjë asgjë me këtë punë, prandaj ne do të lutemi tek Allahu që të shkatërrojë atë që është në gabim, sepse ka pak mundësi të ndodhë, që dy vetë të luten për t'u shkatërruar gabimtari e të mos e nxjerri Allahu në pah të vërtetën. Kundërshtari e pranoi propozimin tim. Unë i thashë: do të lutesh kështu: O Allah, nëse Ibën Arabiu është i devijuar, më mallko mua, o Zot! Ai e bëri. Pastaj unë u luta: O Allah, nëse Ibën Arabiu është në rrugë të drejtë, më mallko mua, o Zot! Më pas u ndamë. Kundërshtari im jetonte në Reuda. Atë e ftoi një njeri i pashëm për darkë. Pas darke, posa kishte filluar nata të mbulojë gjithçka, ai doli për t'u kthyer në shtëpinë e vet. Gjatë rrugës disa dashamirë e shoqëruan deri në vendin Shehtur. Duke ecur i tha shokëve të vet: Një gjë e butë më kaloj nëpër këmbë, shikoni se ç'është! Ata nuk vërejtën asgjë. Derisa arriti në shtëpi e humbi shikimin dhe mbeti i verbër e në mëngjes gdhui i vdekur. Këtë lutje e bëra në Ramazan në vitin 797 sipas Hixhretit.

Kur bëme lutjen iu thashë të pranishmëve, se nuk mbushet viti e të mos e gjejë e keqja atë që është në gabim."

Ibën Arabiu ka jetuar në Damask. Shejhul islam Ibën Tejmije, rahimehullah, ka thënë për të: Ky njeri, autor i librave “Futuhat Mekkiye” dhe “Fususul hikem” është një kundërshtar i peygamberëve. Ai lavdëron popullin e Nuhit, Hudit, Faraonit dhe i përçmon peygamberët, si Nuhun, Ibrahimin, Musain, Harunin. Ai i qorton dijetarët e muslimanëve, si Xhunejd b. Muhamedin, Sehël b. Abdullah Tusteriun dhe nga ana tjetër lavdëron të degjeneruarit, si Hallaxhin e të ngjashmit me të. Këtë e ka përmendur kur flet për fantazmat e tij satanike.

Imam Dhehebiu për librin e tij “Fususul hikem” thotë: Nëse aty s’ka kufër, atëherë kufri nuk ekziston në këtë botë.

Nga kjo që u përmend më lartë kuptojmë se njerëzit duhet të kenë kujdes të madh se prej cilit e marrin fenë. Rreziku është i madh. Shumë herë ka ndodhur që dikush të devijojë, sepse e ka marrë prej çdonjërit, pa u vërtetuar se kush është dhe çka është. Njerëzit detyrohen të synojnë shpëtimin në këtë botë dhe tjetrën, të marrin dijen nga ata që janë kompetentë, nga ata për të cilët Allahu ka thënë: **“Vërtet Allahu nga robërit e Tij i frikësohen vetëm dijetarët.”** (Fatir: 28) Falë Allahut ata janë të shumtë dhe janë të gjallë, prandaj duhet pyetur për çdo dyshim, në mënyrë që të shpëtojmë nga devijimet.

4. Tevekuli (mbështetja tek Allahu) i Ibrahim Ed’hemit

Ibrahim Ed-hem Ebu Is’hak Ixhliu është imam i njohur, zotëri i asketëve dhe ka banuar në Sham. Ai mori dituri nga dijetarë të dalluar si: Ebu Is’hak Sebiu, Mensur b. Mutemiri, Malik b. Dinari, Sulejman Ameshe e të tjerë. Prej tij mori dituri Sufjan Theuriu, Shekik Belhi dhe

shumë të tjerë.

Ibrahim Ed’hemi ishte njeri shumë i devotshëm dhe me mbështetje të fortë tek Allahu i Madhëruar. Shokët e tij tregojnë një rast që ju kishte ndodhur më të në muajin e Ramazanit. Ata tregojnë: Ne ishim tek Ibrahim Ed’hemi në një prej ditëve të Ramazanit dhe ndërkohë erdhi dikush tek shtëpia e tij e i dhuroi një shportë me fiq. Ibrahim i mori shportën dhe ua shpërndau të tërën të mjerëve e fqinjëve, pa pasur dhe pa lënë gjë për veten e vet. Ne i thamë: A nuk le gjë për ne? Ai na u drejtua: A nuk jeni agjiërueshëm? Ne i thamë: Si jo. Tha: A nuk keni turp e frikë prej Allahut? A nuk i frikësoheni dënimit të Allahut? Ju shpresoni të jetoni deri në mbrëmje dhe nuk keni mendim të mirë për Allahun! Pastaj ju tha: Kini besim tek Allahu dhe mendoni mirë për Të, sepse ai ka thënë: **“Ajo që është në duart tuaja harxhohet, kurse ajo që është tek Allahu është e amshueshme.”** (Nahël – 96)

Për udhëzimin dhe pendimin e Ibrahim Ed’hemit përmenden gjëra të mahnitshme. Thuhet për të se rridhte prej një familjeje aristokratike e të pasur. Një ditë prej ditëve, kur ishte në gjueti, hipur mbi at, kali i tij filloi të trembet dhe dëgjoi një zë që vinte nga qielli e thoshte: O Ibrahim, ç’janë këto punë të kota që bën **“A menduat se ne ju krijuam për kot.”** (Muminun 115), ki frikë Allahun dhe përgatitu për ditën kur do të dalësh përpara Tij. Ibrahim i zbriti nga kali dhe që atë ditë u bë asket.

Një rast tjetër me Ibrahim Ed’hemin e tregojnë shokët e tij: Ishim me Ibrahimin duke lundruar në det. Filluan të tërbohen erërat dhe me të edhe anija jonë. Njerëzit u frikësuan dhe qanin. Ne i thamë Ibrahimit: o Ebu Is’hak, ç’mendon ti, si t’ia bëjmë? Ai filloi të lutet: O Ti që je i gjallë

edhe atëherë kur nuk ka asnjë të gjallë. O Ti që je i Gjallë para se të ketë ndonjë të gjallë, o Ti që je i Gjallë pasi të mbarojë çdo i gjallë, o Ti i Gjallë që na mbikëqyr, o Mirëbërës, na e tregove fuqinë Tënde, tani na trego faljen! Në atë moment u qetësua gjithçka. Ibrahim Ed'hemi vdiq në vitin 162 sipas hixhretit.

5. Imam Shafiu bënte gjashtëdhjetë hatme në namaz

Ai quhet Muhamed b. Idriz. Stërgjyshi i tij quhet Hashim dhe ishte axha i Pejgamberit, salallahu alejhi ue selem. U lind në Gaza vitin 150 sipas hixhretit, kurse do të rritej në Meke. Babai i vdes në moshë të re, prandaj ai rritet jetim nën përkujdesjen e nënës së vet. Ishte shumë i zgjuar dhe çdo pune që i hynte bëhej më i miri në mesin e shokëve. Kur ishte fëmijë mësoi të qëllojë me shigjeta dhe u bë më i dalluari në këtë drejtim. Më pas iu dha shkencave të gjuhës dhe arriti një gradë të lartë në këtë dituri. Më pas u dashurua me **Fikhun** dhe u bë zotëria i kohës së vet në këtë lëmi. Ishte i pashëm dhe bujar. Nxënësi i tij Muzeniu thotë: Nuk kam parë më fytyrëbukur se imam Shafiu. Dijetarët kanë thënë shumë fjalë miradije për te. Abdullahu, djali i imam Ahmedit e pyeti një herë babanë e vet: Kush ishte imam Shafiu, se po të dëgjoj që lutesh shumë për te? Ai i tha të birit: Ai ishte si Dielli për dynjanë dhe si shëndeti për njerëzit, o biri im, a ka zëvendësim për ta?

Ibën Asakiri në librin e tij “Tarih Dimeshk” ka shënuar se imam Shafiu për çdo natë ka bërë nga një hatme e kur vinte muaji i Ramazanit bënte nga dy hatme, një natën dhe një ditën dhe kështu për çdo Ramazan bënte gjashtëdhjetë hatme, duke i lexuar në namaz. Husejn b. Ali Kerabisiu tregon: “Unë kam bujtur më shumë se një herë tek imam Shafiu. Ai e kalonte një të

tretën e natës në namaz. Rrallë herë shtonte më shumë se pesëdhjetë ajete dhe arrinte deri në njëqind. Çdoherë që lexonte ndonjë ajet ku përmendej mëshira e Allahut, lutej për veten dhe për të gjithë besimtarët. Kur lexonte ndonjë ajet për ndëshkimin, kërkonte shpëtimin e Allahut për veten dhe për të gjithë besimtarët. Sikur edhe shpresa edhe frika ishin tubuar plotësisht në shpirtin e tij.”

Përkushtimi ndaj Kuranit duke e lexuar me vëmendje dhe duke vepruar sipas tij ka qenë tradita e **të parëve tanë të mirë**. Nga ata ka qenë edhe imam Shafiu.

Disa fjalë të urta të imam Shafiut:

Atë që nuk e ngushëllon devotshmëria e tij, nuk ka ngushëllim për të.

Mirësia qëndron në pesë gjëra: pasuria shpirtërore, të heqësh dorë nga dëmtimi i të tjerëve, fitimi hallall, devotshmëria dhe besimi tek Allahu.

Nuk e ke vëlla atë që duhet t'i bësh lajka.

Organizimi i njerëzve është më i rëndë se organizimi i kafshëve.

Largimi prej mëkateve dhe lënia e gjërave që s'kanë të bëjnë me ty ta ndriçojnë zemrën. Ndaje një pjesë të kohës me veten, pakësoje hajen dhe ruaju nga nderja me mendjelehtët dhe ata që s'janë të drejtë me ty. Nëse flet gjëra që s'kanë të bëjnë me ty, të ka në dorë fjala e jo ti fjalën.

Njeriu më me nam të mirë është ai që s'e sheh namin e tij, njeriu më i respektuar është ai që s'e sheh këtë tek vetvetja. ■

Marrë nga libri:
Ahbar ue havadith fi Ramadan,
Shqipëroi: Agim BEKIRI